

STUDIME PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEZA:

„ Dënimet e shqiptuara për veprën penale Prodhim i paautorizuar dhe lëshimi në përdorim i substancave narkotike,psikotropike dhe prekuzorëve (215 KPM) në rajonin e Gostivarit për periudhën 2012 – 2017“

KANDIDATI:

Liridon Iseini

MENTORI:

Prof. Dr.Besa Arifi

Tetovë, 2021

Falënderime

Falënderoj mentoren time prof. D-r Besa Arifi e cila shprehu vullnetin që të jetë mentore e kësaj teme, duke dhënë kontributin e saj, nëpërmjet këshillimit dhe udhëzimit gjatë punimit të temës së magjistraturës, që të jemë sa më i suksesshëm në këtë hulumtim.

Falënderoj komisionin për vlersimin e punimit tim dhe poashtu UEJL-n që më dha mundësinë të jemë student në të.

Falënderime për familjen time, e cila më përkrahu dhe mbështeti në rrugëtimin tim të dijës si moralisht ashtu edhe financiarisht.

PËRMBAJTJA

Përmbajtja	II
Qëllimi i punimit.....	6
Lënda e hulumtit.....	6
Metodat e hulumtimit.....	7
Organizimi i punimit.....	8
Hyrje.....	9

KAPITULLI I

1. VEPRA PENALE PRODHIM I PAAUTORIZUAR DHE LËSHIMI NË PËRDORIM I SUBSTANCAVE NARKOTIKE, PSIKOTROPIKE DHE PREKUZORËVE (215) SIPAS KODIT PENAL TË RMV.....11
 - 1.1.Organizimi, shitja, prodhimi, përpunimi i substancave narkotike do të dënohet me burg prej tre deri dhjetë vite.....14
 - 1.2. Kryerja e veprës penale në mënyrë të pautorizuar , furnizimi, ndërmjetësimi material ose substanca narkotike do të dënohet nga 1 deri 5 vite burgim.....18
 - 1.3. Rastet e veçanta nëse kryerja e veprës bëhet nga personi juridik, do të dënohet me gjobë.....20
 - 1.4.Konfiskimi materialeve dhe substancave narkotike, psikotropike dhe prekurzorëve pas kryerjes së veprës penale.21

KAPITULLI II

2.	SISTEMI I DËNIMEVE.....	27
2.1.	Nocion Dhe Figura E Dënimit.....	30
2.2.	Elementet themelore të dënimit.....	31
2.3.	Evolucioni i ideve për dënimin dhe ndëshkimin.....	34
2.3.1.	<i>Kuptimi filozofik – juridik për dënimin</i>	36
2.3.2.	<i>Kuptimi sociologjik për dënimin</i>	39
2.4.	Sistemi i dënimeve në R.M.V.....	40
2.5.	Nocioni dhe evolucioni i sistemit të dënimve në R.M.V.....	42
2.6.	Sistemi i dënimve në KPM.....	44
2.7.	Llojet e dënimve në R.M.V.....	47
2.7.1.	<i>Dënimet me burg</i>	49
2.7.2.	<i>Anët e mira dhe të këqija të dënimit me burg</i>	51
2.7.3.	<i>Burgim i përjetshëm</i>	52
2.7.4.	<i>Dënimi me të holla</i>	54
2.7.4.1.	<i>Anët e mira dhe të këqija të dënimit me të holla</i>	57
2.7.4.2.	<i>Regjimi i dënimit me të holla</i>	57

KAPITULLI III

3.	Dënimet e parapara në kodin penal për veprën penale Prodhim i paautorizuar dhe lëshimi në përdorim i substancave narkotike, psikotropike dhe prekuzorëve 215(KPM) 215.....	59
3.1.	Shqiptimi i dënimit për veprën penale Prodhim i paautorizuar dhe lëshimi në përdorim i substancave narkotike, psikotropike dhe prekuzorëve 215(KPM) në rastet me sasi të vogla të mjeteve narkotike.....	62

3.2. Shqiptimi i dënimit për veprën penale Prodhim i paautorizuar dhe lëshimi në përdorim i substancave narkotike, psikotropike dhe prekuzorëve 215(KPM) në rastet me sasi të mëdha të mjeteve narkotike.....	66
3.3. Dallimi në shqiptimin e dënimeve për veprën penale Prodhim i paautorizuar dhe lëshimi në përdorim i substancave narkotike, psikotropike dhe prekuzorëve 215(KPM) në rastet kur objekt i veprës është kokaina.	67
3.3.1. <i>Dallimi në shqiptimin e dënimeve për veprën penale Prodhim i paautorizuar dhe lëshimi në përdorim i substancave narkotike, psikotropike dhe prekuzorëve 215(KPM) në rastet kur objekt i veprës është heroina.....</i>	68
3.3.2. <i>Dallimi në shqiptimin e dënimeve për veprën penale Prodhim i paautorizuar dhe lëshimi në përdorim i substancave narkotike, psikotropike dhe prekuzorëve 215(KPM) në rastet kur objekt i veprës është kanabisi.....</i>	70
3.4. Zbutja e dënimit në raste të caktuara.....	71
3.5. Lirimi nga dënimi në rast të zbulimit të grupit dhe parandalimit të kryerjes së veprës penale.....	74
3.6. Hulumtim Shkencorë Empirik Në Këndvështrimin Hulumtues Të Veprave Penale Në Gjykatën Themelore Të Gostivarit Prodhim i paautorizuar dhe lëshimi në përdorim i substancave narkotike, psikotropike dhe prekuzorëve (215 KPM) në Rajonin E Gostivarit Për Periudhën 2012 – 2017.....	75

KAPITULLI IV

4. Anketa për ndikimin e substancave narkotike, psikotropike dhe prekuzorëve në shoqëri.....	78
--	----

PËRFUNDIMI.....	85
------------------------	-----------

BIBLIOGRAFIA.....	87
--------------------------	-----------

Qëllimi i punimit

Çdo hulumtim që bëhet ka për qëllim të venë pah disa çështje që më parë nuk kanë qenë aq të qarta për opinionin e gjerë. Andaj hulumtimet e mija lidhur me këtë punim shkencor do të përfshijnë një horizont bukur të gjerë drejtë shkaqëve që ndikojnë në Dënimet e shqiptuara për veprën penale Prodhim i paautorizuar dhe lëshimi në përdorim i substancave narkotike, psikotropike dhe prekuzorëve (215)KPM në rajonin e Gostivarit për periudhën 2012-2017 përfshirë rajonin e Gostivarit. Qëllimet e përgjithshme apo gjenerale të këtij punimi shkencor të masterit me titull: Dënimet e shqiptuara për veprën penale Prodhim i paautorizuar dhe lëshimi në përdorim i substancave narkotike, psikotropike dhe prekuzorëve (215 KPM)¹ në rajonin e Gostivarit për periudhën 2012 – 2017 ka për qëllim që të hulumtojë gjendjen faktike të veprave penale në Regjionin e Gostivarit me rrethinën që nga periudha kohore 2012 deri në ²periudhën kohore të viti 2017-të. Në bazë të aktgjykimeve të gjykuara në Gjykatën Themelore të Gostivarit si për nga përmbatja ashtu edhe për nga volumi i tyre në periudhën e lartpërmendur kohore.

Lënda e hulumtit

Në këtë temë të masterit do të mbështetemi edhe në lëndën e të drejtën penale dhe atë të sanksioneve penale në përgjithësi, sepse po në këto lëndë studimore burojnë edhe të gjitha këndvështrimet e të drejtës penale që nga kohërat më të lashta dhe deri në ditët e sotme, apo atë të shoqërisë bashkëkohore në përgjithësi që pikërisht ka ndikuar e drejta penale dhe sanksionet penale që kanë prevenuar në rritjen e këtyre veprave penale me karakter shoqëror që edhe sot e

¹ Kodit penal i Republikës së Maqednisë së Veriut

² Të dhëna statistikore nga Gjykata themelore në Gostivar

kësaj dite po e përdorin sistemet më të³ mëdha të së drejtës penale ndërkombëtare apo bashkëkohore.

Prandaj, ky punim shkencor i masterit do të ketë pikërisht qëllimin kryesor se cilat janë këto faktorë që ndikojnë në kryerjen e veprave penale, që janë të drejtuara kundrejtë njeriut dhe vlerave të jera materiale apo të mirave shpirtërore apo autoriale⁴ të njeriut në përgjithësi.

Metodat e hulumtimit

Për të arritur rezultatin e dëshiruar në punim do të përdoren disa metoda.

Metoda historike –na mundëson që kriminaliteti me substanca narkotike, qoftë prodhim, përpunim, trafikim dhe konsumim, në teritorin e shtetit tonë është një dukuri që ka ekzistuar në dhe është mjaftë prezente dhe në përmasa të mëdha, në jetën dinamike të adoleshentëve. Faktor që kanë ndikuar dhe kanë sjellur pasoja te adoleshentët për prodhim të pautorizuar, përpunim dhe përdorim janë ekonomik, politik, shoqëror, etj.

Metoda juridike- me këtë metodë do të përcaktoj në mënyrë koncize dhe të qartë, duke analizuar ligjin penal të shtetit tonë, në pjesën për veprat penale me substanca narkotike si dhe llojet e dënimeve që janë përcaktuar në këtë ligj, me qëllim⁵ të njohjes së brendisë së normës.

Metoda statistikore- nga të dhënat statistikore të cilat janë siguruar nga institucionet përkatëse, do të paraqitet vëllimshmëria e akteve të ngritura dhe sa çështje ka zgjidhur gjykata ndaj delikuentëve të mitur në perudhën e hulumtimit 2012-2017. Kjo do të na ndihmoj të kuptojmë zbatimin e ligjit në Maqedoninë e Veriut, duke përpunuar dhe interpretuar të dhënat e siguruar do të nxjerrim edhe rezultate përfundimtare.

Metoda e anketës dhe analizës- nëpërmjet pyetsorit të hartuar për substancat narkotike, arrita të anketoj 100 gjymnazist të qytetit të Gostivarit, të cilat do të na shërbejnë për ta kuptuar se a konsumojnë adoleshentët drogën, sa është prezente te kjo dukuri te brezat e ri dhe cilat mekanizma do të ishin adekuate për ta luftuar atë. Me anë të metodës së analizës përveç

³ Kodit penal i Republikës së Maqednisë së Veriut

⁴ Ndikimi I faktorëve të jashtëm në kryerjen e veprave penale

⁵ Bazuar në Kodit penal i Republikës së Maqednisë së Veriut

analizimit të teksteve të autorëve të ndryshëm dhe të ligjeve pozitive poashtu, do të analizohen tabelat dhe grafikonet të cilat e kemi siguruar në këtë punim të magjistraturës, për veprat penale për prodhim të paautorizuar, lëshimit në përdorim të substancave narkotike, psikotropike dhe prekurzorëve, si dhe dënimet dhe llojet dënimit që i zbatohen në Maqedonin⁶ e Veriut.

Organizimi i punimit

Punimi është organizuar në katër kapituj, në të kapitullin e parë janë përcaktuar këto pika: si bëhet organizimi, shitja, përpunimi i substancave narkotike; kryerja e veprës në mënyrë të paautorizuar, furnizimi, si bëhet konfiskimi i materialeve; sanksionimi për veprimet e tilla dhe si sanksionohet personi juridik kur është kryerës.

Në kapitullin e dytë shtjellohen nocioni, elementet dhe sistemi i dënimeve dhe llojet e dënimeve në Maqedonin e Veriut.

Në kapitullin e tretë është përcaktuar shqiptimi i dënimeve për prodhim të paautorizuar dhe lëshimi në përdorim i substancave narkotike, psikotropike dhe prekurzorëve sipas nenit 215 të (KPM), pastaj dallimet kur bëhet fjalë për sasi të vogla- të mëdha, në rastet kur objekt i veprës është heroina – kokaina si dhe hulumtimi empirik për këtë punim në rajonin e Gostivarit për periudhën hulumtuese 2012-2017.

Në kapitullin e katërt anketa dhe analiza e të dhënave të siguruara në bazë të anketës së gjimanzistëve në qytetin e Gostivarit.

Në fund të punimit jepen përfundimet dhe rekomandimet si dhe bibliografia e shfrytëzuar për këtë punim.

⁶ Të dhëna statistikore nga Gjykata themelore në Gostivar

HYRJJE

Bota bashkëkohore si dhe Maqedonia e Veriut, në deceniet e fundit po përballlet me shumë rreziqe që vijnë si pasojë e krimit të organizuar, një dukuri e tillë shqetësuese në shoqëri është prezenca e substancave narkotike dhe psikotropike të cilat prodhohen në mënyrë ilegale (të pa kontrolluara).

Pas viteve të 80-ta, me lëvizjen e lirë të qytetarëve, prej shteti në shtet, me qarkullimin e lirë të mallrave dhe shërbimeve, në tregun e vendit tonë u fut⁷ në mënyrë ilegale edhe një mallë i pa njohur deri atëherë substancat narkotike- droga.

Trafikimi me substanca narkotike në rrugë ilegale është mjaftë fitimprurës, kështu që ka ndikuar që vendi jonë, përveç shitjes dhe si vend tranzit, të bëhet edhe vent prodhimi. Nga viti në vit shifrat e prodhimit të paautorizuar dhe përdorimi është në rritje, ndërsa mosha më aktive në konsumim janë moshat e reja. Të rinjtë janë mjaftë ekspozuar sepse trafikantët janë të pranishëm kudo, pa përjashtuar afërsit e gjymnazeve.

Ne këtë situatë e cila po degradonte nga dita në ditë shtete të ndryshme filluan të merrnin, masa ligjore duke parashikuar në ligj si vepra penale të gjitha veprimet që kishin të bënin me kultivimin, prodhimin, transportimin, shitjen, përdorimin e drogave të ndryshme. Por përsëri kjo nuk çoi në parandalimin e këtij fenomeni megjithëse parashikoheshin në legjislacionet përkatëse vepra të ndryshme penale⁸ në fushën e drogës. Në vitet 1960-1970 organizmat ndërkombëtare⁹ nënshkruan marrëveshje ndërkombëtare në fushën e kontrollit dhe luftës kundër drogave pasi problematikat në këtë sektor u bënë mjaft shqetësuese.

Kështu Organizata e Kombeve të Bashkuara që nga data 26 qershor 1988 e ka cilësuar këtë datë si Ditën Nderkombetare të luftës kundër përdorimit dhe shpërndarjes së drogës. Në një takim special të OKB në shkurt të vitit 1990 dekada e fundit e këtij shekulli u shpall “Dekada e Luftës kundër Drogës”¹⁰.

⁷ Instituti i shëndetit Publik, Drogat dhe pasojat e përdorimit të saj të të rinjtë, 2011, broshurë_droga. Pdf

⁸ H. Bano “Ekzekutimi i Vendimeve Penale me Burgim” Tribune Juridike, 2004, nr. 46, fq.58.

⁹ S. Nushi “Mbrotjtja me Avokat e Personit gjatë Kohës së Shoqërimin, Ndalimit ose Arrestimit në Flagrancë”, Tribunë Juridike, 2004, nr. 46, fq.51.

¹⁰ Dita ndërkombëtare e luftës kundër përdorimit dhe shpërndarjes së drogës, e caktuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara (1988)

Duke u nisur nga kjo që e përmendëm më lartë, është e nevojshme që me një punim shkencor të pasqyrohet gjendja, të identifikohen problemet në retrospektiv ashtu që të bëhet e mundur vlerësimi i ndikimit të tyre në zhvillimet demokratike të mëtutjeshme duke tentuar që të zhduket ose të paktën të ulen shifrat e mëdha prodhimit, shitjes dhe përdorimit ilegal të substancave narkotike dhe psikotropike.

Në mbledhjen e të dhënave statistikore, vlerësimin e tyre shkencor, përpunimin dhe sjelljen e përfundimeve, objekt kryesor i këtij hulumtimi do të jenë faktorët që ndikojnë në prodhimin e paautorizuar, shitjen dhe konsumimin e substancave narkotike dhe sanksionimin e këtij fenomeni në shoqërinë tonë.

Përfundimet që do të dalin nga syzheu i punimit do të jenë vargu i ngjarjeve lidhur me kërkesat për mbrojtjen e shoqërisë, sanksionimet e kryerësit të veprës penale me substancat narkotike, qoftë prodhim apo trafikim, duke qënë si masë preventive dhe represive në luftimin e veprave penale të prodhimit të paautorizuar, shitjes dhe konsumit të substancave narkotike dhe prekuzorëve.

Pasi në shoqërinë tonë droga është prezente si në prodhim, në shitje ashtu edhe në konsumim, për ta luftuar si fenomen duhet të zbatohet dhe respektohen Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ligjet dhe dokumentat ndërkombëtar të ratifikuar, në aspektin juridik, ekonomik, mjekësor dhe shoqëror.

KAPITULLI I

1. VEPRA PENALE PRODHIM I PAAUTORIZUAR DHE LËSHIMI NË PËRDORIM I SUBSTANCAVE NARKOTIKE, PSIKOTROPIKE DHE PREKUZORËVE (215) SIPAS KODIT PENAL TË RMV

Republika e Maqedonisë së Veriut për shkak të pozitës së saj gjeografike është e përshtatshme për tranzitimin e substancave narkotike, duke mundësuar kështu që substancat narkotike, psikotropike dhe prekuzorëve, nga vendi i origjinës të arrin në vendin e destinuar.

Mirëpo, për shkak të informimit me shumë të qytetarëve në lidhje me përfitimit e saj, për fat të keq Maqedonia tani është edhe vend i prodhimit në mënyrë ilegale.

Pavarësisht nga përmasat që ka marrë përdorimi dhe prodhimi i substancave narkotike, psikotropike dhe prekuzorëve në kohën tonë, ato janë përdorur që në lashtësi. Pra, që në parahistori droga është përdorur në të gjithë botën.

Fillimisht duhet të përkufizojmë se çfarë kuptojmë me drogë. OBSH-ja, cilëson si drogë çfarëdo substancë që duke u futur në një organizëm të gjallë modifikon një ose më shumë funksione të tij. Ndërsa me drogë abuzive kuptojmë çfarëdo substancë, e marrë në cilëndo formë të mundshme turbullon humorin, nivelin e perceptimit dhe funksionin cerebral.¹¹ Sipas këtij përkufizimi merren parasysh drogat e ligjshme, si duhani apo alkooli, si dhe ato të paligjshmet: hashishi, heroina, kokaina, ¹²drogat sintetike, etj.

Droga mund të jetë e ngurtë (krak),e lëngshme (alkooli),ose e gaztë (inhalante).

Klasifikimi i drogës bëhet në: depresantët, simulantët dhe halucinogjenët.

Depresantët -janë droga që ngadalësojnë funksionin e trupit duke përfshirë edhe mesazhet për dhe nga truri. Ato ndikojnë në përqëndrimin dhe koordinimin dhe ngadalësojnë aftësinë për

¹¹ Nocioni i përcaktuar nga OBSH, shih për më shumë në Instituti i shëndetit Publik, Drogat dhe pasojate e përdorimit të saj te të rinjtë, 2011, broshure_droga. pdf

¹² Instituti i shëndetit Publik, Drogat dhe pasojate e përdorimit të saj te të rinjtë, 2011, broshure_droga. pdf

tju përgjigjur situatave të papritura. Në sasi të mëdha mund të shkaktojnë humbje të vetëdijes, të vjella e deri në vdekje.¹³ Llojet kryesore të depresantëve janë: alkooli, marihuana, valiumi, barbitudet, opijatet, inhalatet, etj.

Simulantët-drogat stimuluese shpejtojnë funksionet e organizmit. Si rrjedhim personi që merr stimulantin ndjehet më i gjallë, i vëmendshëm dhe i sigurt tek vetja. Ato rritin rrahjet e zemrës, temperaturën e trupit dhe tensionin e gjakut. Stimulantët pakësojnë oreksin, zmadhojnë pupilat e syrit, sjellin pagjumësi dhe e bejnë përdoruesin që të flasë pa pushim apo të jetë pak nervoz. Marrja e sasive të mëdha të stimulatëve shkakton ankth, panik, kriza, dhimbje koke, dhimbje në stomak, agresivitet dhe paranojë. Stimulantët e fortë mund të maskojnë disa nga efektet e depresantëve si për shëmbull alkooli. *Stimulantë të lehtë* janë: nikotina (duhani), kafeina (çaj ,kafe dhe pije kola) dhe efedrina (përdoret për mjekime të asmës dhe alergjisë). *Stimulantë të fortë* janë: amfitemina, kokaina, ekstazi dhe tabletat dobësuese.¹⁴

Halucinogjenët- drogat halucinogjene shndërrojnë mënyrën se si një person sheh ose imagjimon atë që e rrethon.¹⁵ Personat që marrin halucinogjene mund të shohin apo dëgjojnë gjëra që nuk egzistojnë, ose mund të shohin gjëra të tjetërsuara. Efekte të tjera të halucinogjenëve janë zmadhim i pilulave të syrit, ikja e oreksit, rritja e lëvizjeve, të folura dhe të qeshura të tepruara, eufori emocionale dhe psikologjike, shtrëngim të nofullave, panik, djersitje, paranojë, humbje¹⁶ të kontaktit me realitetin, sjellje të çuditshme dhe të paarsyeshme, dhimbje në stomak dhe përzierje. Meqenëse efektet e halucinogjenëve janë të ndryshme është e pamundur që të parashikohet se si ata mund të ndikojnë tek njeri apo tek tjetri në një kohë të caktuar. Llojet kryesore të halucinogjenëve janë: kërpudhat magjike, maruhana, ekstazi, meskalina, LCD, et.¹⁷

Para erës sonë, Hipokrati që konsiderohet edhe babai mjeksisë, parapëlqente pirjen e hashashit në rastet e pagjumësisë dhe sëmundjeve të ndryshme kronike. Në Amerikën Jugore, popujt që në lashtësi përtypnin gjethet e bimës *Erytrocion Coca*, që i ndihmonte për të përballuar mundime të mëdha fizike, urinë, etjen dhe përgjithësisht për të përballuar vështirësitë e jetës. Në Greqi konsumohej opiumi, në Kinë marihuana ndërsa në Lindje e Afërme ashashi.

¹³ Instituti i shëndetit Publik, Drogat dhe pasojate e përdorimit të saj te të rinjtë, 2011, broshure_droga. pdf

¹⁴ Instituti i shëndetit Publik, Drogat dhe pasojate e përdorimit të saj te të rinjtë, 2011, broshure_droga. pdf

¹⁵ <https://www.iph.mk/sq/26-qershori-dita-boterore-kunder-perdorimit-dhe-tregtise-ilegale-te-drogave/>

¹⁶ Instituti i shëndetit Publik, Drogat dhe pasojate e përdorimit të saj te të rinjtë, 2011, broshure_droga. Pdf

¹⁷ Instituti i shëndetit Publik, Drogat dhe pasojate e përdorimit të saj te të rinjtë, 2011, broshure_droga. pdf

Konsumimi më i hershëm i lëndëve narkotike është i lidhur me ritet fetare, por më pas u përdor nga shtresa elitare, nga filozofët, aristokratët, mandej për të përballuar mundimet e mëdha fizike si urinë dhe vështirësitë e jetesës, duke evluar në shoqërinë bashkëkohore tek adoleshentët fillimi i përdorimit është¹⁸ mode apo trendi i kohës.

Hashashi dhe opiumin në Evropë është sjellur në shekullin e XIII, nga ushtarët e kryqëzatave pasi u kthyen nga Lindja e Largët. Në perëndim deri në shekullin XIX dominonte alkooli dhe duhani, substancat narkotike nuk kishin përhapje të gjerë por vetëm për rrethet intelektuale. Gjë që na le të kuptojmë se trafikimi i drogës dhe substancave narkotike ishte legal, nuk kishte asnjë kufizim ligjor.

Pas Luftës së Parë Botërore, sëmundja e varësisë, e përdorimit të narkotikëve, u përhapë me të madhe. Në Francë, në vitin 1920, kishte 80-mijë njerëz të varur nga morfiumi e kokaina, që do të thotë se tregtia ilegale e këtyre narkotikëve u zgjerua dhe u përhap¹⁹ me të madhe. Në vitin 1949, në Kinë me dhjetëra e miliona njerëz vuanin nga sëmundja e varësisë (narkomania) si pasojë e konsumimit të pijeve të ndryshme narkotike në forma të ndryshme²⁰ e të pa kontrolluar.

Në fillim të shekullit XX filloi një përhapje më e madhe e drogës. Në SH.B.A nga një testim i bërë në vitin 1913 rezultonte se kishte një çerek milioni narkomanë. Edhe vendet e tjera filluan të prekeshin nga kjo dukuri. Kjo i detyroi shtetet të nxirrnin ligje për ndalimin²¹ e tregëtisë së narkotikëve. Për këtë arsye trafiku i drogës u bë i fshehtë dhe grupet kriminale morën rrugën për të shkuar në vendet furnizuese.²² Në vazhdim të shekullit të XX, sidomos pas Luftës së Dytë Botërore trafiku dhe konsumimi i drogës mori përmasa të mëdha, vecanërisht në vendet e zhvilluara perëndimore. Sipas të dhënave të Kombeve të Bashkuara të dhjetë-vjeçarit të kaluar²³ numri i atyre që konsumonin drogë ishte njëqind e tetëdhjetë milion persona.

¹⁸ Shëndeti si cilësi e jetës. Qendra për aksion krize dhe psikosocial, Shkup, 2013:89

¹⁹ K.Luli "Mbrojtja e Dëshmitarëve dhe e Bashkëpunëtorit të Drejtësisë", Tribunë Juridike, viti 2005, nr.55, fq. 42

²⁰ K.Luli "Mbrojtja e Dëshmitarëve dhe e Bashkëpunëtorit të Drejtësisë", Tribunë Juridike, viti 2005, nr.55, fq. 42

²¹ Elezi, Alketa. " Droga, një sfidë intelegjence, aspekte penalo-juridike dhe krahasuese të saj", punim për gradën Doktor Shkence, Universiteti Tiranës, Tiranë, 2012, fq. 15

²² <http://www.unodc.org/drugs/june-26/>

²³ Elezi, Alketa. " Droga, një sfidë intelegjence, aspekte penalo-juridike dhe krahasuese të saj", punim për gradën Doktor Shkence, Universiteti Tiranës, Tiranë, 2012, fq. 15

Të interesuar për shëndetin dhe mirëqënien e njerëzimit, të shqetësuar për problemin madhor e shoqëror që lindi si pasojë e shpërdorimit të pijeve narkotike apo drogave Fondi i Kombeve të Bashkuara për Kontrollin e Keqpërdorimit të Drogave UNFDAC (United Nations Fund for Drug Abuse Control UN) Organizata Botërore e Shëndetësisë, Komisioni i Këshillit për narkotikët si organ ndërkombëtar, nxorri Konventën mbi substancat narkotike të Vjenës, më 21 shkurt 1971, Konventën mbi substancat psikotrope²⁴ dhe caktoi listën e substancave psikotropike dhe listën e narkotikeve.

Përdorimi i drejtë për qëllime mjekësore i substancave narkotike është ilaç, por kur konsumi i tyre bëhet vet nga personat që e kanë siguruar në rrugë ilegale, pa rekomandime mjekësore, shkakton sëmundjen e varësisë.

1.1.Organizimi, shitja, prodhimi, përpunimi i substancave narkotike do të dënohet me burg prej tre deri dhjetë vite

Organizimi, drejtimi, financimi, i organizatave kriminale për prodhimin, përpunimin e shitjen e bërë në mënyrë të kundërligjshme substancave narkotike, sipas dispozitave të kodit penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut, dënohet me burgim.

Para se të flasim për dënimet e përcaktuara në kodin penal për substancat narkotike, në radh të parë do të sqarojmë termet juridike që hasen në literatura dhe në ligjet pozitive në shtetin tonë.

Në nenin 3, të Ligjit për kontrollin e drogave narkotike dhe substancave psikotropike, janë përcaktuar këto nocione:

- ***Drogë narkotike*** është secila substancë me prejardhje natyrore ose artificiale që është e radhitur në listën e drogave dehëse, në pajtim me konventat ndërkombëtare për kontrollin e drogave dehëse, ose në bazë të vendimit të organit kompetent. Droga narkotike përfshin

²⁴ Elezi, Alketa. “ Droga, një sfidë intelegjence, aspekte penalo-juridike dhe krahasuese të saj”, punim për gradën Doktor Shkence, Universiteti Tiranës, Tiranë, 2012, fq. 15

edhe substanca psikotropike, që janë të radhitura në listën e substancave psikotropike, nëse nuk janë përmendur në menyrë të veçantë²⁵.

- **"Kultivim i bimëve"** është mbjellja, mbeltimi, kultivimi ose korrja e bimëve, ose në mënyre tjetër marrja e pjesëve të bimëve, prej të cilave mund të fitohet droga dehëse²⁶.
- **"Konfiskim"** është marrja e përhershme e pronësisë me urdhëresë të gjyqit, ose të organit tjetër kompetent.
- **"Substancë psikotropike"** është secila substancë me prejardhje natyrore ose artificiale që është e radhitur në listën e substancave psikotropike, në pajtim me konventat ndërkombëtare për kontrollin e drogave dehëse dhe/ose në bazë të vendimit të organit²⁷ kompetent.
- **"Prekurzor"** është secila substancë natyrore ose artificiale që mund të përdoret në prodhimin e drogave dehëse dhe që është e radhitur në listën e prekurzorëve, në pajtim me konventat ndërkombëtare për kontrollin e drogave dehëse dhe/ose në bazë të vendimit të organit kompetent në Republikën²⁸ e Maqedonisë.
- **"Prodhim"** është përgatitja, përpunimi, përzjerja, pastrimi, prodhimi dhe secili aktivitet tjetër, me të cilin fitohet ose me të cilën kontribuohet për fitimin e drogës dehëse, substancës psikotropike ose të preparatit të tyre.
- **"Qarkullim"** është secila mënyrë e lëshimit në qarkullim të drogës dehëse, substancës psikotropike, bimës, pjesës së bimës, siç janë importi, eksporti, transitimi, furnizimi, blerja, shitja, ndërrimi, bartja, magazinimi, lëshimi i recetës e ngjashëm.
- **"Posedim"** është pronësia e drogës dehëse, substancës psikotropike ose bimës.
- **"Konsumues i herëpasëhershëm i drogës dehëse"** është personi i cili në mënyrë të njehershme ose herë pas here merrë droga dehëse, dhe te i cili ende nuk është zhvilluar gjendja e varësisë²⁹.

²⁵ Ligji për kontrollin e drogave narkotike dhe substancave psikotropike, Gz. Zyrtare e R.M. 103/08;2010;ndryshaur dhe plotësuar në vitin. 2013;2015;2016;2017

²⁶ Po aty, neni 3

²⁷ Po aty, neni 3

²⁸ Ligji për kontrollin e drogave narkotike dhe substancave psikotropike, Gz. Zyrtare e R.M. 103/08;2010;ndryshaur dhe plotësuar në vitin. 2013;2015;2016;2017

²⁹ Ligji për kontrollin e drogave narkotike dhe substancave psikotropike, Gz. Zyrtare e R.M. 103/08;2010;ndryshaur dhe plotësuar në vitin. 2013;2015;2016;2017

- **"Ndhimë të varurve dhe konsumuesve të herë pas herëshëm të drogës dehëse"** është ndihma e marrjes së masave mjekësore dhe masave të ndihmës sociale, siç janë rehabilitimi psiko social, këshillimi dhe risocializimi i të varurve nga drogat³⁰ dehëse.
- **"Konfiskim i përkohshëm"** është ndalimi i përkohshëm i transferit, konvertimit, disponimit ose bartjes së pronësisë, ose mbikëqyrjes së përkohshme ose kontrollit të pronësisë, në bazë të urdhëresës së lëshuar nga gjyqi ose nga organi tjetër kompetent.
- **"Bimë nga të cilat mund të fitohet droga dehëse"** (në tekstin e metejme: "bima") është secila bimë prej së cilës mund të fitohet droga dehëse, e që është e radhitur në listën e atyre bimëve, në pajtim me konventat ndërkombëtare për kontrollin e drogave dehëse, ose në bazë të vendimit të organit kompetent, si dhe pjesa e bimës së atillë që mund të perdoret për fitimin e drogës dehëse³¹.
- **"Rehabilitim"** janë aktivitetet qëllimi i të cilave, është që personi shërohet dhe pushon me keqpërdorimin e drogës ose substancës psikotropike, që ti kthehen aftësitë e tjera trupore dhe psikologjike³². Ka dy qëllime: ndryshimin e sjelljes dhe stilit të jetesës së personit që ka keqpërdorur drogë ose substancë psikotropike, dhe i dyti aftësimin për punë.
- **"Furnizim"** është dhënia dhe ndarja e drogave dehëse ose substancave psikotropike.
- **"Substanca"** janë drogat dehëse, substancat psikotropike dhe prekurzorët, të radhitur në listën e drogave dehëse, substancave psikotropike dhe prekurzorëve, e nën pajtim me konventat ndërkombëtare për kontrollin e drogave dehëse dhe/ose në bazë të vendimit të organit kompetent të Republikës së Maqedonisë³³.
- **"Mjet për prodhimin e drogës dehëse"** është aparati ose sendi tjetër, i cili është i dedikuar ose i përdorur për përfitimin e drogës dehëse ose substancës psikotropike³⁴.
- **"Varësi"** është gjendja e nevojës së papërbalueshme psikike ose fizike, për përdorimin e drogës dehëse.

³⁰ Ligji për kontrollin e drogave narkotike dhe substancave psikotropike, Gz. Zyrtare e R.M. 103/08;2010;ndryshaur dhe plotësuar në vitin. 2013;2015;2016;2017

³¹ Ligji për kontrollin e drogave narkotike dhe substancave psikotropike, Gz. Zyrtare e R.M. 103/08;2010;ndryshaur dhe plotësuar në vitin. 2013;2015;2016;2017

³² Ligji për kontrollin e drogave narkotike dhe substancave psikotropike, Gz. Zyrtare e R.M. 103/08;2010;ndryshaur dhe plotësuar në vitin. 2013;2015;2016;2017

³³ Ligji për kontrollin e drogave narkotike dhe substancave psikotropike, Gz. Zyrtare e R.M. 103/08;2010;ndryshaur dhe plotësuar në vitin. 2013;2015;2016;2017

³⁴ Po aty, neni 3

- *"I varur nga drogat dehëse"* është personi që me përdorimin e drogës dehëse, ka arritur në gjendje të varesisë³⁵.
- *"Keqpërdorim i drogave dehëse ose përdorim i palejueshëm i drogave dehëse"* është kultivimi i bimëve prej të cilave mund të përfitohet droga dehëse, posedimi i mjeteve për prodhimin e drogave dehëse, prodhimi, qarkullimi dhe posedimi i drogave dehëse, substancave psikotropike, bimëve ose pjesëve të bimëve prej të cilave mund të përfitohet droga dehëse në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, si dhe përdorimi i drogave dehëse jashtë indikatorëve terapeutike,³⁶ në doza jashtë mase ose gjatë kohës që nuk është e përfshirë me terapi.

Pavarësisht nga drogat e përdorura të gjitha janë të dëmshme dhe kanë efekte tek përdoruesit e më tej.³⁷ Përdorimi i drogës ndikon tek shëndeti, puna, jeta personale, në familje dhe në rrethin shoqëror.³⁸

Në parag. 1, neni 217, veprat e rënda kundër shëndetit të njerëzve, është klasifikuar se kryesi që në mënyrë të paautorizuar prodhon, përpunon, shet, ofron ose blen, lëshon në qarkullim drogat narkotike, me të cilat ndonjë personi i është lënduar rëndë apo shëndeti i është shkatëruar, kryesi do të dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet. Në parag. 2 po të nenit 217, është cituar: *nëse për shkak të veprës nga neni 215 paragrafi 1, dhe neni 216 paragrafi 1,2, është shkaktuar vdekja e një apo më shumë personave, kryerësi do të dënohet më së paku katër vjet burgim.*³⁹

Sipas **formës së fajit** nga e cila është kryer vepra penale, nga e cila ka dalur vepra më i rëndë, në përputhje me këtë kriter, në paragrafët 1, 2, mbështeten veprime më të⁴⁰ rënda (pasoja të rënda), veprime themelore të të cilave ishin e kryer me dashje. Në kuadër të përkufizimeve bazike, më tutje, në këto dy grupe themelore veprat janë sistemuar në bazë të peshës dhe llojit

³⁵ Po aty, neni 3

³⁶ Ligji për kontrollin e drogave narkotike dhe substancave psikotropike, Gz. Zyrtare e R.M. 103/08;2010;ndryshaur dhe plotësuar në vitin. 2013;2015;2016;2017

³⁷ Instituti i shëndetit Publik, Drogat dhe pasojate e përdorimit të saj te të rinjtë, broshure_droga. pdf

³⁸ Instituti i shëndetit Publik, Drogat dhe pasojate e përdorimit të saj te të rinjtë, broshure_droga. pdf

³⁹ Kodit penal i Republikës së Maqednisë së Veriut

⁴⁰ Проевски, Јован., „Кривичен Законик“, објаснувања, коментари, судска практика, Агенција Академик-Скопје, Скопје, 1998, ст. 509

të pasojave më të rënda: në parag.1 në veprën e rëndë (forma e klasifikimit) është kriminalizuar lëndimet e rënda trupore ose shkatrimi i rëndë i shëndetit që kanë ardhur si pasojë e veprimit fillestar vepra është kryer me paramendim; në parag.2, është përfshirë pasoja më e rëndë , e cila është me vdekjen e një personi apo disa personave, pasoja të cilat kanë ardhur prej veprimit fillestar, e kryer me paramendim.⁴¹

Pra, pasi ndarja e veprave penale, sipas së drejtës pozitive bëhet në vepra penale të kryera me dashje dhe nga pakujdesia, nga ajo që elaboruam më lartë në neni 217 vijmë në përfundim se vepra penale prodhimi i paautorizuar, shitja, lëshimi në qarkullim i substancave narkotike, psikotropike dhe prekuzorëve, kryhet me dashje dhe me paramendim. Dënimi i përcaktuar deri në dhjetë vjet është adekuat për kryesit përgjegjës së kësaj veprë penale pa marrë parasysh ka punuar si individ apo në bashkëpunim dhe me persona të tjerë.

Personi që ka kryer këtë krim duhet të jetë përgjegjës dhe ta ketë bërë me qëllim, që do të thotë se kryesi duhet të jetë i vetëdijshëm se është një substancë që shpallet ilaç. Ky krim dënohet me burgim nga 3 deri në 10 vjet. Ndryshimet e KP të vitit 2009 përcaktojnë një formë të re të privilegjuar në rast se droga është në sasi më të vogla, dhe një dënim prej gjashtë muaj deri në 3 vjet⁴² burg.

Në Kodin penal të Republikës së Shqipërisë në nenin 284 parashihet: *“Kultivimi i bimëve që shërbejnë apo dihet se do të shërbejnë për prodhimin dhe nxjerrjen e lëndëve narkotike e psikotrope pa leje dhe autorizim sipas ligjit, dënohet me burgim nga 3 deri 7 vjet. Po kjo veprë kur kryhet në bashkëpunim ose për më shumë se një herë dënohet me burgim nga 5 deri ne 10 vjet burg. Organizimi, drejtimi apo financimi i këtij aktiviteti dënohet me burgim nga 7 deri në⁴³ 15 vjet.”*

Sekuena e një numri të madh të detyrimeve ndërkombëtare që rrjedhin nga konventat (Konventa e 1971 për substancat psikotrope, 2000 Konventa për krimin e organizuar transnacional. dhe të ngjashme), si dhe përhapja e këtij fenomeni çoi në kriminalizimin e të

⁴¹ Проєвски, Јован., „Кривичен Законик“, објаснувања, коментари, судска практика, Агенција Академик-Скопје, Скопје, 1998, ст. 509

⁴² Kodit penal i Republikës së Maqednisë së Veriut

⁴³ Ligji Nr. 7975 “ Kodi Penal , I Republikës së Shqipërisë “ i datës 26.07.1995, azhuruar 2014.

njëjtës, d.m.th., në mbrojtjen juridike penale të saj.⁴⁴ Këto konventa përmbajnë gjithashtu, në ligjin tonë penal, nocionet përkatëse të drogës - një listë të substancave të konsideruara si ilaçe të opiumit (morfinë, opiumin, heroinën, kokainën, etj), si dhe substanca të tjera psikotrope (analgjzikë, etj).

1.2. Kryerja e veprës penale në mënyrë të pautorizuar , furnizimi, ndërmjetësimi material ose substanca narkotike do të dënohet nga 1 deri 5 vite burgim

Në nenin 4, parag. 1, të Ligjit për kontrollin e drogave narkotike dhe substancave psikotropike është përcaktuar: “ *ndalohet kultivimi i bimëve prej të cilave mund të fitohet droga dehëse, si dhe prodhimi, qarkullimi dhe posedimi i drogave dehëse, substancave psikotropike dhe bimëve prej të cilave mund të fitohet droga dehëse, përveç në kushte dhe me qëllim të përcaktuara me këtë ligj*”. Në parag.2, të po të njëjtit nenë është përcaktuar: *ndalohet posedimi i mjeteve për prodhimin e drogave dehëse, përveç në kushte dhe me qëllim që janë të përcaktuara me këtë ligj*⁴⁵. Pra, këtu ka kuptimin e prodhimit në mjeksi për ilaç, normalisht nga farmacistë dhe fabrika përkatëse të liçencuara për prodhim nga ana e shtetit.

Ndalohet përdorimi i drogave dhe substancave psikotropike, përveç në kushte të përcaktuara me këtë ligj dhe dispozitat nga sfera e shëndetësisë dhe veterinarisë⁴⁶.

Ndalohet reklamimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i prodhimit, qarkullimit, posedimit dhe përdorimit të drogave dehëse dhe substancave psikotropike, si dhe reklamimi i drogave dehëse dhe substancave psikotropike, në çfarëdo mënyre tjetër, përveç në publikimet shkencore dhe profesionale, të dedikuara për shkencëtarët ose personat profesional në sferën e shëndetësisë.⁴⁷

Një formë më e rëndë e kësaj veprë penale konsiderohet nëse krimi është kryer nga disa persona ose kryesi i kësaj veprë penale, ka organizuar një rrjet të shitësve ose ndërmjetësuesve, i

⁴⁴ Kanevçev, Metodija. “Pjesa Speciale e së Drejtës Penale”, f.266

⁴⁵ Ligji për kontrollin e drogave narkotike dhe substancave psikotropike, Gz. Zyrtare e R.M. 103/08;2010;ndryshaur dhe plotësuar në vitin. 2013;2015;2016;2017

⁴⁶ <https://www.pravdiko.mk/narkotichni-drogi-i-kaznite-za-nivno-neovlasteno-proizvodstvo-i-pushtan-e-vo-promet/>

⁴⁷ Ligji për kontrollin e drogave narkotike dhe substancave psikotropike, Gz. Zyrtare e R.M. 103/08;2010;ndryshaur dhe plotësuar në vitin. 2013;2015;2016;2017

cili kryesin e veprës penale do ta dënojë me burgim të ⁴⁸paktën pesë vjet. Mjafton të ketë të paktën dy ose më shumë persona dhe organizatori i rrjetit të shitësve ose ndërmjetësuesve dënohet më rëndë.⁴⁹

Një formë tjetër më e rëndë e kësaj vepre penale është kur dikush në mënyrë të paautorizuar prodhon, prokuron, ndërmjetëson ose jep në përdorim pajisje materiale ose substanca që ata e dinë se janë të destinuara për prodhimin e drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekuzorëve, për të do të dënohet me burg prej një deri në pesë⁵⁰ vjet.

Kryerësi, me përjashtim të organizatorit, i cili do të zbulojë krimin ose do të kontribuojë në zbulimin e tij, do të lirohet nga dënimi.⁵¹

Nga praktika gjyqësore në bazë të ligjit, në Maqedoninë e Veriut vihet re se në vitin 2003, Departamenti Kundër Krimin të Organizuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme ka referuar në Prokurorin Speciale 85 kallzime penale kundër 605 personave dhe numri më i madh i këtyre kallzimeve ka të bëjë me veprën penale nga neni 215 i Kodit Penal të⁵² Maqedonisë.

1.3.Rastet e veçanta nëse kryerja e veprës bëhet nga personi juridik, do të dënohet me gjobë

Në kapitullin e VI, të Kodit Penal të shtetit tonë, është përcaktuar se, nëse veprën penale e kryen personi juridik, do të dënohet⁵³ me gjobë. Ashtu që në paragrafin e parë, të nenit 96, germa “a”, për vepra penale të personave juridikë si dënim kryesor shqiptohet dënimi⁵⁴ me gjobë. Mirëpo, ligjvënësi shkon më tutje duke parashikuar po në të njëjtin nen në paragrafin e

⁴⁸ <https://www.pravdiko.mk/narkotichni-drogi-i-kaznite-za-nivno-neovlasteno-proizvodstvo-i-pushtan-e-vo-promet/>

⁴⁹ <https://www.pravdiko.mk/narkotichni-drogi-i-kaznite-za-nivno-neovlasteno-proizvodstvo-i-pushtan-e-vo-promet/>

⁵⁰ Проевски, Јован., „Кривичен Законик“, објаснувања, коментари, судска практика, Агенција Академик-Скопје, Скопје, 1998

⁵¹ <https://www.pravdiko.mk/narkotichni-drogi-i-kaznite-za-nivno-neovlasteno-proizvodstvo-i-pushtan-e-vo-promet/>

⁵² Raport nga Departamenti Kundër Krimin të Organizuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në Republikën e Maqedonisë së Veriut

⁵³ Kodit penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut

⁵⁴ Neni 96, Kodit penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut

dytë se: *dënimi me gjobë shqiptohet në shumë që nuk mund të jetë më e vogël se 10.000 denarë, e⁵⁵ as më e madhe se 30 milion denarë.*

Nëse gjatë kryerjes së veprimtarisë së personit juridik është kryer vepra penale për të cilën për personin juridik është e paraparë dënimi me gjobë ose dënimi me burgim deri në tre vjet, kurse nga mënyra e kryerjes së veprës penale del rreziku nga kryerja e sërishme e veprës së tillë, siç është prodhimi i paautorizuar, furnizimi apo ndërmjetësimi material me substanca narkotike, ose ndonjë veprim i ngjajshëm, gjyqi do të⁵⁶ shqiptojë ndalesë së përkohshme për kryerje të veprimtarisë së caktuar, për të cilën është i themeluar personi juridik, në zgjatje prej një deri në tre vjet bashkë me dënimin me gjobë.

Nëse është kryer vepra penale organizimi, shitja, prodhimi, përpunimi i substancave narkotike, për të cilën për personin fizik është paraparë dënim me burgim prej së paku tre vjet, nga mënyra e kryerjes së veprës del rreziku se mund ta kryej sërish apo diçka të ngjajshëm, gjykata do të⁵⁷ shqiptojë ndalesë të përhershme për kryerjen e veprimtarisë së caktuar nga veprimtaritë që i kryen personi juridik si dhe dënim me gjobë. Mirëpo, nëse është kryer veprë për të cilën për personin fizik është paraparë dënim prej së paku 5 vjet dhe rreziku se mund të kryhet sërish vepra e tillë penale, gjykata do të shqiptojë dënim pushimin e personit juridik si dhe dënim me gjobë.⁵⁸

Nëse nga personi juridik nuk mund të konfiskohet pasuria apo dobia pasurore për shkak të asaj se ka pushuar së ekzistuari para ekzekutimit të konfiskimit, trashëgimtari përkatësisht trashëgimtarët juridik, themeluesi apo themeluesit e personit juridik, gjegjësisht aksionerët dhe shoqëruesit në raste të caktuara me ligj në mënyrë solidare do të detyrohen të paguajnë shumën e të hollave që i përgjigjet dobisë së fituar pasurore⁵⁹.

Në nenin 100 të Kodit Penal të shtetit tonë, është përcaktuar konfiskimi nga personi juridik, do të bëhet në qoftë se me veprën penale të kryesit është përfituar dobi pasurore për personin juridik.

⁵⁵ Parag.2. Neni 96, Kodit penal i Republikës së Maqednisë së Veriut

⁵⁶ Kodit penal i Republikës së Maqednisë së Veriut

⁵⁷ Po aty

⁵⁸ Neni 96-c, parag. 4,5 dhe 7, I Kodit penal i Republikës së Maqednisë së Veriut

⁵⁹ Neni 96-j, parag.2, i Kodit penal i Republikës së Maqednisë së Veriut

Ndjekja penale e personit juridik nuk mund të ndërmerret kur do të kalojnë:

- Tre vjet nga kryerja e veprës penale për të cilën është paraparë dënimi me gjobë ose dënimi me burgim deri në tre vjet,⁶⁰
- Pesë vjet nga kryerja e veprës penale për të cilën është paraparë dënimi⁶¹ me burgim mbi tre vjet,
- Dhjet vjet nga kryerja e veprës penale për të cilën është paraparë dënimi me burgim mbi pesë vjet.⁶²

1.4.Konfiskimi materialeve dhe substancave narkotike, psikotropike dhe prekuzorëve pas kryerjes së veprës penale.

Sipas parimeve të përgjithshme juridike, askush nuk mund të mbajë dobinë pasurore të cilën e ka fituar në mënyrë të kundërligjshme.⁶³ Përkatësisht, çdo fitim pasuror që është rezultat i ndonjë vepre penale nuk ka bazë juridike dhe për këtë shkak dobinë e kësaj askush nuk mund ta⁶⁴ mbajë. Në bazë të këtij parimi, rezulton se askush nuk mund të mbajë dobinë pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale.⁶⁵ Dobia pasurore e fituar me kryerjen e veprës penale mund të jetë me të holla apo gjësende të tjera të vlefshme.⁶⁶

Sipas dispozitës së kodit penal të R.së Maqedonisë së Veriut, në neni 97, parag.1, është përcaktuar: askush nuk mund të mbajë dobinë pasurore të fituar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me anë të kryerjes së veprës penale.⁶⁷ Pasuria e fituar me veprën penale, do të konfiskohet me vendim të gjykatës, kur është konstatuar se kryerja e veprës penale është bërë

⁶⁰ Osmani, Afrim. "Kodi penal i Republikës së Maqedonisë", Teksti integral, i përpunuar në gjuhën shqipe me udhëzime dhe sqarime, treguesi alfabetik, Furkan ISM, Shkup, 2010, fq.98

⁶¹ Osmani, Afrim. "Kodi penal i Republikës së Maqedonisë", Teksti integral, i përpunuar në gjuhën shqipe me udhëzime dhe sqarime, treguesi alfabetik, Furkan ISM, Shkup, 2010, fq.98

⁶² Osmani, Afrim. "Kodi penal i Republikës së Maqedonisë", Teksti integral, i përpunuar në gjuhën shqipe me udhëzime dhe sqarime, treguesi alfabetik, Furkan ISM, Shkup, 2010, fq.98

⁶³ https://www.emcdda.europa.eu/system/files/publications/847/National_Report_Kosovo_2014_Alb_485288.pdf

⁶⁴ https://www.emcdda.europa.eu/system/files/publications/847/National_Report_Kosovo_2014_Alb_485288.pdf

⁶⁵ Saliu, Ismet." E drejta penale –pjesa e përgjithshme ", Prishtinë, 2008, fq.548

⁶⁶ Saliu, Ismet." E drejta penale –pjesa e përgjithshme ", Prishtinë, 2008, fq.548

⁶⁷ Kodi penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut

në kushtet e parashikuara në këtë ligj.⁶⁸ Vendim për konfiskim gjykata do të sjell në procedurë të përcaktuar me ligj dhe kur në bazë të pengesave juridike dhe faktike nuk mund të zhvillohet procedurë penale kundër kryerësit të veprës penale.⁶⁹ Kjo masë shqiptohet në rastet kur kryerësi i veprës penale i shqiptohet dënimi kryesor, dënimi alternativ, vërejtja e gjykatës, kur i shqiptohet masa edukuese apo masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtjes në entin shëndetësor si dhe trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri.⁷⁰ Pra, ligji ka për qëllim që me anë të kësaj mase të bëhet i pamundshëm fitimi pasuror me anë të kryerjes së veprës penale dhe që të rivihet aso gjendje masa pasurore çfarë ka qenë para kryerjes së veprës penale⁷¹.

Para së gjithash dobia pasurore merret nga kryesi i veprës penale (nga kryesi, organizatori i bashkimit kriminal, nga shtytësi, ndihmësi apo ai i cili e ka fshehur veprën penale apo kryesin). Kjo masë shqiptohet gjithashtu edhe ndaj personit të cilit i është dhënë që ta ruajë pasurinë e fituar me veprën penale.⁷²

Nuk janë raste të rralla që kryesi, dobinë pasurore të cilën e ka fituar me veprën penale, ta bartë te persona të tjerë. Situata e parë është kur pasuria e fituar me veprën penale të bartet në persona të tjerë. Ndërsa situata e dytë është kur pasuria bartet në të afërmit e kryesit.⁷³

Nëse dobia pasurore është bartur në persona të tjerë, që mund të shqiptohet konfiskimi i dobisë pasurore, duhet që të përmbushen dy kushte, kushti objektiv dhe subjektiv. Kushti objektiv përmbushet në rastet kur pasuria është bartur pa kompenzim ose me kompenzim që nuk i përgjigjet vlerës reale⁷⁴. Ndërsa kushti subjektiv përmbushet në rastet kur personi në të cilin është bartur pasuria, e ka ditur apo ka mundur të dijë se pasuria⁷⁵ është fituar me veprën penale. Që të mund gjykata të shqiptojë këtë masë, duhet të përmbushen të dy kushtet në mënyrë komulative.⁷⁶

⁶⁸ Neni 97, pika 2, i Kodit penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut

⁶⁹ Neni 97, pika 3, i Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut

⁷⁰ Saliu, Ismet." E drejta penale –pjesa e përgjithsme ", Prishtinë, 2008, fq.548

⁷¹ Saliu, Ismet." E drejta penale –pjesa e përgjithsme ", Prishtinë, 2008, fq.548

⁷² Saliu, Ismet." E drejta penale –pjesa e përgjithsme ", Prishtinë, 2008, fq.549

⁷³ Po aty, fq. 549

⁷⁴ Kondili, Valentina." E drejta civile- pjesa e posaçme" GEER, 2008, fq 57

⁷⁵ Kondili, Valentina." E drejta civile- pjesa e posaçme" GEER, 2008, fq 57

⁷⁶ Saliu, Ismet." E drejta penale –pjesa e përgjithsme ", Prishtinë, 2008,fq.549

Në nenin 97, germa “a” është përcaktuar se : përveç dobisë së drejtpërdrejtë nga kryesi do të konfiskohet edhe dobia e tërthortë pasurore që përbëhet nga:

- 1) pasuria në të cilën është transformuar apo shndërruar dobia e fituar me vepër penale⁷⁷;
- 2) pasuria e fituar nga burimet ligjore, nëse dobia e fituar me veprën penale është përzier, në tërësi apo pjesërisht, me pasurinë e tillë, deri në vlerën e vlerësuar nga dobia e përzier e fituar me veprën penale dhe
- 3) të ardhurat apo dobia tjetër që del nga dobia e fituar me veprën penale, nga pasuria në të cilën dobia e fituar me veprën penale është transferuar apo shëndruar apo nga pasuria në të cilën është përzier dobia e fituar nga vepra penale deri në vlerën e vlerësuar të dobisë së përzier e fituar me vepër penale.⁷⁸

Mënyrat e konfiskimit- në nenin 98 ekzistojnë 6 paragrafe në të cilat është përcaktuar mënyra e konfiskimit .

Në parag.1 është përcaktuar: *nga kryesi do të konfiskohen dobia e drejtpërdrejtë dhe e tërthortë pasurore e fituar me veprën penale që përbëhet nga paratë, sendet me vlerë të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe çdo pronë tjetër, pasuri apo aktivë, të drejta materiale apo jomateriale, e nëse konfiskimi i tyre nuk⁷⁹ është i mundshëm, nga kryesi do të konfiskohet pasuri tjetër që i përgjigjet vlerës së pasurisë së fituar.*

Dobia pasurore sipas paragrafit të parë të kësaj dispozite kryesisht konfiskohet nga kryesi, por gjithashtu edhe nga çdo personi juridik tjetër ose shoqate e cila pasuri është arritur me kryerjen e veprës penale(n.100)⁸⁰

Dobia e drejtpërdrejtë dhe e tërthortë pasurore konfiskohet edhe nga personat e tretë për të cilët është realizuar me vepër penale (parg.2. n.98). Dobia pasurore konfiskohet edhe nga anëtarët e familjes së kryesit të cilëve u është bartur nëse është e dukshme se nuk ka dhënë

⁷⁷ Neni 97, germa “a”, Kodi Penal i Maqedonisë së Veriut

⁷⁸ Osmani, Afrim. “Kodi penal i Republikës së Maqedonisë”, Teksti integral, i përpunuar në gjuhën shqipe me udhëzime dhe sqarime, treguesi alfabetik, Furkan ISM, Shkup, 2010, fq.99-100

⁷⁹ Neni 98, Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut

⁸⁰ Проевски, Јован., Кривичен Законик“, објаснувања, коментари, судска практика, Агенција Академик-Скопје, Скопје, 1998, ст. 285

dëmshpëblim që përgjigjet me vlerën e dobisë së fituar pasurore apo nga personat e tretë nëse nuk dëshmojnë se për sendin apo pasurinë e kanë dhënë kundërkompensim që përgjigjet me vlerën e dobisë së fituar pasurore (parag.3). Sendet që janë shpallur trashëgimi kulturore dhe raritet natyror, si dhe ato për të cilat i dëmtuari është personalisht i lidhur, konfiskohen nga persona të tretë, pa marrë parasysh se të njëjtat kanë qenë të bartura me kompensim përkatës(parag.4). E konfiskuara i kthehet të dëmtuarit, por nëse nuk ka të dëmtuar, atëherë bëhet pronë e shtetit (parag.5).⁸¹

Dobia pasurore do të konfiskohet edhe personave që nuk janë kryes të veprës penale, pavarësisht e cila u është bartur me kompesim apo pa kompensim. Kusht është nëse nuk e kanë ditur të vërtetohet se ato persona mund ta kenë ditur ose kanë qenë të detyruar ta dijnë se dobia pasurore është fituar me vepër penale⁸². Po ashtu, në paragrafin tjetër është përcaktuar fati i sendeve të konfiskuara. Ato në radh të parë ju jepen personave të dëmtuar që janë pronar të sendit. Me këtë sigurohet baza për realizimin e dispozitave të këtij ligji. Mandej, nëse nuk ka person të dëmtuar ose është i pamundur identifikimi i tij ose ai nuk ka interes për të kthyer dobinë pasurore që i është marrë – atëherë ajo bëhet pronë shtetërore.⁸³ Kështu p.sh. trashëgimtarëve të cilëve u ka takuar pasuria e krijuar me tregëti droge, personat e tretë fizik ose juridikmbi të cilët pasuria është krijuar me vepër penale, është bartur me transaksione fiktive etj. Pasuria e tillë mund të jetë e konfiskuar nëse ngritet procedurë e përcaktuar me LPP (që akoma nuk ekziston) objekt i së cilës është përcaktimi i kryerjes së veprës penale, lloji dhe lartësia e dobisë pasurore të krijuar.⁸⁴

Nga kryesi do të konfiskohen materiet dhe substancat narkotike dhe prekursorë si dhe të gjitha sendet që kanë qenë të destinuara ose janë përdorur për këtë vepër penale, pa dallim se këto sende janë pronë e tij apo personit tjetër, kur një gjë të tillë e kërkon sigurimi shëndetësor publik⁸⁵ dhe shkaqet e moralit. Ato do të konfiskohen edhe në rastet kur dyshohet se këto

⁸¹ Osmani, Afrim. “Kodi penal i Republikës së Maqedonisë”, Teksti integral, i përpunuar në gjuhën shqipe me udhëzime dhe sqarime, treguesi alfabetik, Furkan ISM, Shkup, 2010, fq.100-101

⁸² Проевски, Јован., Кривичен Законик“, објаснувања, коментари, судска практика, Агенција Академик-Скопје, Скопје, 1998, ст. 285

⁸³ Проевски, Јован., Кривичен Законик“, објаснувања, коментари, судска практика, Агенција Академик-Скопје, Скопје, 1998, ст. 285

⁸⁴ Kambovski, Vllado. “ E drejta penale – pjesa e përgjithshme “,(përkthim) Përkthyen Ismail Zejneli, AfrimOsmani ; Shkup , 2010, fq 601

⁸⁵ Ligji për përmbarrimin e sanksioneve, nr. 2/06.

materiale do të përdoren sërisht në të ardhmen për prodhimin e substancave narkotike dhe prekursorëve.⁸⁶ Gjykata do sjellë vendim për konfiskim të substancave narkotike dhe të gjitha materialet dhe sendet e tjera në procedurë të caktuar me ligj, që janë materiale të krimit ose i kanë shërbyer kryesit gjatë kryerjes së veprës penale.

Ligji aspak nuk e specifikon vendimin e tillë si aktgjykim penal, por përkundrazi e përcakton si vendim për konfiskim gjyqi sipas detyrës zyrtare do të sjell në procedurë të përcaktuar me ligj dhe kur prej pengesave ligjore dhe faktike nuk është e mundur⁸⁷ të zhvillohet procedure penale kundër kryesit të veprës penale. Zgjidhja e këtillë është logjike sepse është pasojë e zgjerimit të zbatimit të kësaj mase edhe mbi peronat e tretë, por implikon më tej ndryshime në *dy situatë juridike*: kur është e mundur dhe kur nuk është e mundur zhvillimi I procedurës penale kundër kryesit konkret. Në rastin e *parë*, për konfiskimin e dobisë pasurore është e rëndësishme sjellja e vendimit me të cilin konsiderohet kryerja e veprës penale nga ana e kryesit, pa marrë parasysh llojin e vendimit; aktgjykimit penal, vendimit për shqiptim masë edukuese, vërejtjes gjyqësore apo vendimin për shqiptimin e masës së sigurisë personave të papërgjegjshëm (n. 490 LPP), edhe pse kjo saktësisht nuk është theksuar, duhet të merret se gjyqi sipas detyrës zyrtare do të vendos për konfiskimin e dobisë pasurore dhe kur do të vendos për ndërpreje të procedurës në rastet e përcaktuara me ligj (vdekje ose sëmundje e gjatë shpirtërore e të akuzuarit etj). Në këtë procedurë gjyqi mund të sjell vendim për konfiskim të dobisë pasurore prej personave të tretë (n. 487 LPP).⁸⁸

Për situatën e dytë – kur prej pengesave praktike ose juridike nuk është e mundur zhvillimi i procedurës penale kundër kryesit të veprës penale, në të drejtën tonë të procedurës penale ekziston zbrazëtirë që duhet të plotësohet urgjentisht me ndryshimet vijuese në LPP. ***Pengesat faktike*** janë ato të cilat e përjashtojnë zhvillimin e procedurës penale për atë që kryesi

⁸⁶ Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut, neni n100-a, në parag.2 dhe 3 ka përcaktuar taksativisht: *nga kryesi i veprës penale do të merren edhe sendet që kanë qenë të destinuara apo janë përdorur për kryerje të veprës penale pa marrë parasysh se a janë pronë e tij apo e personit të tretë nëse atë e kërkojnë interesat e sigurisë publike , shëndeti i njerëzve apo shkaqet e moralit. Sendet që janë përdorur ose kanë qenë të destinuara për kryerje të veprës penale mund të merren nëse ekziston rrezik se sërisht do të përdoren për kryerje të veprës penale. Nuk do të merren sendet që janë pronë e personave të tretë, nëse ai ka ditur ose ka qenë i obliguar të dijë se janë përdorur ose kanë qenë të destinuara për kryerje të veprës penale.*

Shih nenin 355, 356 të Ligjit për përmbarrimin e sanksioneve, nr. 2/06.

⁸⁷ Kambovski ,Vllado. “ E drejta penale – pjesa e përgjithshme “,(përkthim) Përkthyen Ismail Zejneli, AfrimOsmani ; Shkup , 2010, fq .600

⁸⁸ Kambovski ,Vllado. “ E drejta penale – pjesa e përgjithshme “,(përkthim) Përkthyen Ismail Zejneli, AfrimOsmani ; Shkup , 2010, fq .600

i veprës penale është I pakapshëm(në arratisje), ose nuk ekziston (ka vdekur ose personi juridik është likuiduar etj). *Pengesat juridike* ekzistojnë kur kryesi është i njohur dhe i kapshëm, por kundër tij nuk mund të ngritet procedurë penale për shkak të moshës (fëmija nën moshën 14 vjeç), imuniteti që gëzon (imunitet sipas së drejtë ndërkombëtare ose imunitet procesor sipas së drejtës sonë), parashkrimi i veprës penale dhe pengesa të tjera juridike.⁸⁹

KAPITULLI II

2.SISTEMI I DËNIMEVE

Sanksionet penale janë preokupim kryesor i së drejtës penale nga fakti se në të gjitha rastet kur personi i caktuar kryen veprë të rrezikshme, e cila është e kundërligjshme dhe e përcaktuar në ligj si veprë penale, është e domosdoshme që shoqëria ndaj kryesit të veprës së tillë të ndërmarrë ndonjë masë, e cila e ka për qëllim pengimin e kryerjes së veprës penale në të⁹⁰ ardhmen. Në të drejtën penale masat të cilat zbatohen ndaj kryesve të veprave penale quhen sanksione penale. Marrë nëpërgjithësi, masat të cilat janë të parapara në të drejtën penale dhe ndërmerren nga jurisprudence penale ndaj kryesit të veprës penale, duhet të kenë të vetmin

⁸⁹ Kambovski ,Vllado. “ E drejta penale – pjesa e përgjithshme “,(përkthim) Përkthyen Ismail Zejneli, AfrimOsmani ; Shkup , 2010, fq .601

⁹⁰ Po aty, fq. 423

qëllim- mbrojtjen e çdo individi dhe të shoqërisë në përgjithësi nga kriminaliteti si dukuri e rrezikshme dhe e dëmshme.⁹¹

Lidhur me këtë, duhet theksuar se shteti që pretendon të jetë demokratik dhe human ndaj qytetarëve të vet, për parandalimin dhe çrënjosjen e kriminalitetit, krahas sanksioneve penale, duhet të disponojë dhe të ndërmarrë masa të ndryshme, siç janë ngritja e nivelit të arsimit, kulturës dhe të vetëdijes për respektimin e ligjit , të lirive dhe të drejtave, sigurisë dhe barazisë së qytetarëve në të gjitha fushat jetës dhe një varg masash të tjera për mirëqenien ekonomike dhe sociale të qytetarëve dhe të shoqërisë së atij vendi në tërësi.⁹²

Sanksionet penale janë ndër mjetet që i ndërmerrë shoqëria me qëllim të mbrojtjes nga kriminaliteti. Këto janë një lloj i reagimit të shoqërisë ndaj kryesrve të veprave penale⁹³ dhe ndërmerren me qëllim të mbrojtjes së shoqërisë dhe qytetarëve nga veprat e dëmshme. Sanksionet penale që parashihen në të drejtën penale janë masa shtrënguese që zbatohen me dhunë dhe paraqesin represion ndaj kryesit të veprave penale.⁹⁴

Sistemi i dënimeve i **përfshinë dispozitat ligjore për dënimet dhe kushtet për shqiptimin e tyre**. Ai është segment nga sistemi më i gjerë i drejtësisë penale në të cilin përveç legjislaturës hynë edhe institucionet që veprojnë në planin e represionit penalo-juridike: policia dhe aktivitetet e saj, prokuroria, gjyqi dhe entet penitensiare. Nga ana tjetër, sistemi i dënimeve përfshinë jo vetëm dispozitat ligjore për dënimet por, edhe dënimet e shqiptuara, kështu që pjesa komplementare e tij është sistemi i vuajtjes së dënimit që është lëndë e studimit të penologjisësi disiplinë e veçantë shkencore.⁹⁵

Teoria mbi arsyen pse ne dënojmë shkelësit janë thelbësore në kuptimin e së drejtës penale. Njohja pse i ndëshkojmë njerëzit mund të na vijë në ndihmë në njohjen se cilat duhet të

⁹¹ Saliu, Ismet. "E drejta penale –pjesa e përgjithsme ", Prishtinë, 2008, fq.423

⁹² Saliu, Ismet. "E drejta penale –pjesa e përgjithsme ", Prishtinë, 2008, fq.423

⁹³ Po aty, fq.424

⁹⁴ Po aty, fq.424

⁹⁵ Kambovski, Vllado. " E drejta penale – pjesa e përgjithsme ",(përkthim) Përkthyen Ismail Zejneli, AfrimOsmani ; Shkup , 2010, fq.487

klasifikohen si kriminale. Në fund të fundit është e kotë që të ngarkojmë me fajësi për vepra penale persona që ne nuk mendojmë se e meritojnë ndonjë lloj ndëshkimi.⁹⁶

Normative ligjore për llojet e dënimeve, kushtet për shqiptimin e saj, raporti i ndërsjellë i dënimeve dhe raporti i tyre me sanksionet,⁹⁷ është fushë ku është e shprehur në mënyrë më eksplicite ***koncepti kriminal-politik dhe penalo juridik i ligjvënësit!*** Përveç orientimit represiv dhe preventive, të rreptë ose human të ligjvënësit në definimin e qëllimeve të politikës kriminale ku duhet të jenë përshtatur llojet e dënimeve si mjet për relazimin e tyre. Profili i këtij sistemi është i determinuar edhe me faktorë të tjerë: traditën, mundësitë institucionale, materiale të shtetit për zbatimin e një lloji të dënimit, përkrahje ose mospranim i disa llojeve të dënimit nga ana e publikut. Prej këtu, për dallim nga institutet e përgjithshme të së drejtës penale ku është arritur shkalla më e lartë e *unifikimit dhe harmonizimit* mes sistemeve nacionale të sistemeve penale, ekzistojnë edhe sot diferenca të mëdha jo vetëm në sistemin e sanksioneve të caktuara si dënim ose sanksioneve tjera, por edhe brenda në *sistemin e dënimit*: ende janë prezente legjislatura që e parashohin dënimin me vdekje, dënimi me burg është përshkruar në kohëzgjatje të ndryshme, disa legjislatura nuk e njohin dënimin me burg të përjetshëm, sistemi I dënimeve në më shumë legjislatura parasheh edhe dënime plotësuese⁹⁸ që kanë të bëjnë me humbjen e disa të drejtave.

Në fakt nuk është e lehtë të⁹⁹ përkufizosh dënimin. Pse nuk e konsiderojmë pagimin e taksave si një dënim; është realisht aq ndryshim nga pagimi i një gjobe? A është ndalimi sipas “Mental health Act” (Ligji mbi Shëndetin Mendor) I ndryshëm nga burgimi? Nuk është për tu çuditur që nuk ka një marrëveshje mbi atë se çfarë është në të vërtetë dënimi. Përgjithësisht mendohet se përmban disa nga elementet e mëposhtme:

- 1) Duhet të jetë i pakëndshëm
- 2) Imponohet nga shteti
- 3) Imponohet ndaj atyre që kanë shkelur ligjin

⁹⁶ Herring, Jonathan. “E drejta penale – Teori, kazuse dhe materiale”, Botimi V/Volimi I, (shqipëroi: Spartak Ngjela, Alkeda Reçi, Edlira Stavre), Tiranë, 2013, fq. 61

⁹⁷ Petroviq, Borisllav. “E drejta penale”, Sarajevë/Prishtinë, 2006, fq. 87

⁹⁸ Kambovski, Vllado. “E drejta penale – pjesa e përgjithshme”, (përkthim) Përkthyen Ismail Zejneli, Afrim Osmani; Shkup, 2010, fq. 487

⁹⁹ <https://sq.wikipedia.org/wiki/Droga>

- 4) Qëllimi i tij nuk është kompensimi i viktimës
- 5) Përmban censurë mbi atë që bëri i pandehuri.¹⁰⁰

Pika e parë e argumentit ka të bëjë me faktin se dënimi është diçka që kërkon një justifikim të¹⁰¹ fortë. Që shteti ti provojë një qytetari lirinë e tij duke e ndaluar atë në burg, është një pushim i stërmadh i të drejtave themelore të qytetarit, dhe kërkon arsye më të mirë të mundshme.¹⁰²

Pra, përmes dënimit, realizohet drejtësia dhe pengohet kryesi që në të ardhmen të kryej vepra penale, të riedukohet ai dhe në anën tjetër, të ndikojë te qytetarët e tjerë që mos kryejnë vepra penale.

Teoritë mbi dënimin mund të klasifikohen në teori konsekuencialiste (pretendimi se ka pasoja të mira që rrjedhin nga dënimi dhe prandaj ai justifikohet) dhe në teori jokonsekuencialiste (pretendimi se ka arsye të tjera përveç pasojave që sjell, të cilat justifikojnë dënimin).¹⁰³

2.1.Nocion Dhe Figura E Dënimit

Dënimi është kthim i drejtësishëm për veprën e kryer, në fakt e keqe e paramenduar dhe e qëllimshme që i shkaktohet kryesisht për veprën e kryer dhe nga kornizat e fajsisë për veprën!

Së pari, dënimi është sanksion, pasojë juridike e veprës së kryer penale që e shqipton gjyqi në procedurë të paraparë me ligj. Ai është gjithmonë i përshkruar me ligj dhe ka karakter juridik- publik, me çka dallohet me format private të reaksionit! *Së dyti*, dënimi është e keqe që i shkaktohet kryesit dhe që përbëhet në marrjen ose kufizimin e disa lirive dhe të drejtave: liria

¹⁰⁰ Herring, Jonathan. "E drejta penale – Teori, kazuse dhe materiale", Botimi V/Volimi I, (shqipëroi:Spartak Ngjela, Alkeda Reçi, Edlira Stavre), Tiranë, 2013, fq. 61-62

¹⁰¹ Herring, Jonathan. "E drejta penale – Teori, kazuse dhe materiale", Botimi V/Volimi I, (shqipëroi:Spartak Ngjela, Alkeda Reçi, Edlira Stavre), Tiranë, 2013, fq. 61-62

¹⁰² Herring, Jonathan. "E drejta penale – Teori, kazuse dhe materiale", Botimi V/Volimi I, (shqipëroi:Spartak Ngjela, Alkeda Reçi, Edlira Stavre), Tiranë, 2013, fq. 62

¹⁰³ Herring, Jonathan. "E drejta penale – Teori, kazuse dhe materiale", Botimi V/Volimi I, (shqipëroi:Spartak Ngjela, Alkeda Reçi, Edlira Stavre), Tiranë, 2013, fq. 62

personale (burgu), e drejta e pronësisë (dënimi me të holla, etj).sipas definimit dënimi nuk është çfarëdo e keqe që kryesi i vuan si pasojë e veprës së bërë, por *e keqe e paramenduar*: burgu nuk ndalon të jetë dënim për homoseksualin i cili vazhdon¹⁰⁴ të ndihet mirë në të. *E treta, dënimi është e keqe e qëllimshme*, ajo nuk është hakmarrje ndaj hakmarrjes, represion ndaj represionit por retributivitet i llogaritur në realizimin e qëllimeve sociale të dobishme! *E katërta*, baza për shqiptimin e dënimit është *kryerja e veprës dhe fajësia për atë veprë* që është edhe kufiri i dënimit. Mund të dënohet vetëm kryesi që është shpallur fajtor, në kufijtë e fajsisë për veprën konkrete!¹⁰⁵

Me vetë atë që paraqet detyrim, çdo sanksion paraqet të keqe të padëshiruar për kryesin. Nga kjo pikëpamje, nuk ekziston asnjë diferencë mes dënimit me burg që i shqiptohet kryesit të llogaritur dhe fajtor dhe masës së sigurisë- dërgim në entin psikiatrik që i shqiptohet personit të pandërgjegjshëm.¹⁰⁶

Nëpërmjet dënimit ligji i trajton individët si qenie njerëzore që janë të aftë të bëjnë zgjedhje, dhe të marrin përsipër pasojat e këtyre zgjedhjeve. Për disa retributivistë dënimi lidhet me konceptin e shlyerjes së detyrimeve që ka autori ndaj shoqërisë. Mbas vuajtjes së dënimit, autori mund ti rikthehet shoqërisë si një anëtar me drejta të plota. Për të tjerë, një shkelës, duke thyer ligjin, ka fituar një avantazh të padrejtë mbi qytetarët që respektojnë ligjet dhe ku duhet hequr me anë të inponimit të barrës së dënimit. Kjo duket e evidente, por është domethënëse, në kuptim që një personi nuk duhet ti jepet një dënim më i gjatë nga ai i cili, do të merrte duke u bazuar mbi indenë se një dënim i tillë do të ishte për të mirën e tij, ose për të mirën¹⁰⁷ e shoqërisë. Prandaj, për shembull nuk duhet të imponojmë një dënim veçanërisht të lartë mbi njerëz që kanë vjedhur një telefon celular në mënyrë që të dekurajohen të tjerët për të mos e bërë këtë, apo të burgosim ajdutët e dyqaneve vetëm në mënyrë që¹⁰⁸ të sigurohet trajtimi i tyre kundër varësisë ndaj drogës. Në të dyja rastet do të impononim një dënim më të madh nga

¹⁰⁴ Kambovski, Vllado. "E drejta penale – pjesa e përgjithshme ",(përkthim) Përkthyer Ismail Zejneli, AfrimOsmani ; Shkup , 2010, fq. 461

¹⁰⁵ Kambovski, Vllado. "E drejta penale – pjesa e përgjithshme ",(përkthim) Përkthyer Ismail Zejneli, AfrimOsmani ; Shkup , 2010, fq. 461

¹⁰⁶ Petroviq, Borislav. " E drejta penale",Sarajevë/Prishtinë, 2006

¹⁰⁷ Petroviq, Borislav. " E drejta penale",Sarajevë/Prishtinë, 2006

¹⁰⁸ Herring, Jonathan. " E drejta penale – Teori, kazuse dhe materiale", Botimi V/Volimi I, (shqipëroi:Spartak Ngjela, Alkeda Reçi, Edlira Stavre), Tiranë, 2013, fq. 63

ai që meritojnë krimet e tyre. Ajo çfarë duhet të bëhet është dhënia e një dënimi që është në proporcion me gabimin që ata kanë bërë.¹⁰⁹

Dënimi është e keqe e paramenduar që kryesit i shkaktohet për **shkak të veprës së kryer:** ky është edhe funksioni primar i dënimit dhe efekti i llogaritur dhe që nuk mund të jetë në funksion edhe të¹¹⁰ qëllimeve të tjera. Te masat e sigurisë, e keqja paraqitet si komponent i pashmangshëm i detyrimit dhe i karakterit të detyrueshëm të vetë masës dhe e përcaktuar në qëllime të tjera *primare në interes* të kryesisit: pengimin e rrezikut, gjegjësisht preventiva kurse baza e zbatimit të saj është **nevoja për ndihmë dhe shërim**¹¹¹ të kryerësit.

2.2.Elementet themelore të dënimit

Elementet themelore të dënimit, sipas nocionit formal- material janë:

1. Dënimi duhet të paraqes vlersimin negative moralo-etik
2. Dënimi duhet të ketë qëllimin e caktuar I cili dëshirohet të arrihet me ekzekutimin e tij.
3. Dënimi duhet të jetë I përcaktuar me ligj.
4. Dënimi mund të shqiptohet vetëm ndaj kryesve të veprës penale që janë penalisht të përgjegjshëm¹¹².
5. Dënimi mund të shqiptohet vetëm gjyqi sipas procedurës së përcaktuar me ligj.¹¹³

Që të mund ti shqiptohet dënimi kryesit të veprës penale, duhet me patjetër ti posedojë të gjitha elementet e caktuara me sipër, në të kundërtën do të ishte shkelje e dispozitave ligjore.

¹⁰⁹ Herring, Jonathan. “E drejta penale – Teori, kazuse dhe materiale”, Botimi V/Volimi I, (shqipëroi:Spartak Ngjela, Alkeda Reçi, Edlira Stavre), Tiranë, 2013, fq. 63

¹¹⁰ Kambovski, Vllado. “E drejta penale – pjesa e përgjithshme “,(përkthim) Përkthyen Ismail Zejneli, AfrimOsmani ; Shkup , 2010, fq. 461

¹¹¹ Kambovski, Vllado. “E drejta penale – pjesa e përgjithshme “,(përkthim) Përkthyen Ismail Zejneli, AfrimOsmani ; Shkup , 2010, fq. 461

¹¹² <https://juristat.files.wordpress.com/2012/02/e-drejta-penale.pdf>

¹¹³ <https://juristat.files.wordpress.com/2012/02/e-drejta-penale.pdf>

Pra, vepra e kryer duhet të paraqesë një të keqe, që kufizon të mirat e caktuara juridike siç janë : liria, pasuria, ndalimi i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë, detyrës, etj. Për tu shqiptuar dënimi, veprimi i tillë duhet të jetë përcaktuar në radh të pare si vepër penale, sepse nëse nuk është përcaktuar si i tillë , do të vlente maksima latine ***nullum crime, nullum poena, sine lege.*** Po ashtu, kryesi i veprës penale duhet të jetë i përgjegjshëm dhe i fajshëm në kohën e kryerjes së veprës penale, pasi dënimin duhet ta kuptoj si një e keqe që e ka goditur si pasojë e veprës së dëmshme të kryer nga aid he në të ardhmen të mos kryej vepra penale¹¹⁴.

Nga e gjithë kjo që u tha më lartë, vijmë ne përfundim se qëllimi I dënimit është mbrojtja e shoqërisë dhe qytetarëve prej veprave të rrezikshme me të cilat dëmtohen dhe rrezikohen vlerat më të rëndësishme të individit dhe shoqërisë.

Duke u nisur nga elementet dhe funksioni që duhet të ushtrojë dënimi, në të drejtën positive parashihen edhe disa karakteristika që duhet të përmbushen që të mund të shqiptohet dhe zbatohet dënimi. Karakteristikat janë:

- a) Dënimi duhet të jetë personal, b) dënimi duhet të jetë human, c) dënimi duhet të jetë I ligjshëm, d) duhet ti godasë njësojë kryerësit e veprave penale, e) dënimi duhet të jetë i ndarë, f) duhet të jetë në proporcion me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së kryesit, g) dënimi duhet të jetë I përmirësueshëm dhe h) dënimi duhet të jetë i¹¹⁵ revokueshëm.

Dënimi duhet të jetë personal, që do të thotë të dënimi duhet ta godasë vetëm kryesin e veprës penale e jo edhe personat të tjerë që janë anëtarë të familjes së tij. Mirëpo, pasojat negative psikologjike dhe ato materiale, gjithësesi në një formë dhe masë i godasin edhe anëtarët e tjerë të familjes. Që dënimi duhet të jetë human, nënkupton garantimin dhe respektimin e personalitetit dhe dinjitetin e njeriut në procedure penale dhe gjatë fazës së ekzekutimit¹¹⁶ të dënimit.

Dënimi duhet ti godasë njësojë kryesit e veprave penale, pa marrë parasysh përkatësinë etnika, fetare, racore, politike apo sociale, sepse këtu konsiston respektimi i parimit të legalitetit që të

¹¹⁴ <https://www.linkedin.com/pulse/principles-legality-nullum-crimen-nulla-poena-sine>

¹¹⁵ Salihu, dr. Ismet E drejta penale 2005 Prishtine, faqe 433-434

¹¹⁶ Karakteristikë që na le të nënkuptojmë se dënimi duhet të godas vetëm kryerësin e veprës por personat e tjerë për shkak të raportit që mund të kenë me kryerësin

gjithë qytetarët janë të barabartë. Pra, qytetarët para ligjit dhe para gjyqit janë të barabartë dhe ka një politik ndëshkuese unike.

Për sa i përket proporcionalitetit, përpjestueshmëria dhe drejtësia e dënimit shprehet që përveç peshës së veprës penale dhe përgjegjësisë penale, të merren edhe rrethanat e tjera subjektive dhe objektive të kryesit. Në rastet kur për shkak të provave të rrejshme apo lajthimit të gjyqit dhe dënimi është shqiptuar në kundërshtim me ligjin, atëherë dënimi mund të¹¹⁷ revokohet.

¹¹⁷ Saliu, Ismet." E drejta penale –pjesa e përgjithsme “, Prishtinë, 2008

2.3.Evolucioni i ideve për dënimin dhe ndëshkimin

Periudha e bashkësisë së parë njerëzore, e cila karakterizohet si shoqëri pa klasa, shfaqet me formimin e njeriut dhe zgjatë deri në paraqitjen e shteteve të para. Meqë edhe në këtë periudhë ngjanin ekscese që i cenonin rregullat e jetës shoqërore të bazuara në të drejtën zakonore, është dashur që patjetër të reagohej ndaj personave që i kryen këto akscese. Për shkak se akoma nuk i është formuar shteti dhe e drejta, përkatësisht e drejta penale, këtë reagim e ushtron familja dhe fisi dhe kishte për qëllim që ta mbronte bashkësinë nga verpat e tilla të¹¹⁸ dëmshme. Për nga mënyra e saj, ky reagim ka pasur karakter të mbrojtjes shoqërore, sepse duke u mbrojtur nga eksceset është siguruar ekzistenca e bashkësisë si tërësi, pa marrë parasysh se a ka qënë rrezikshmëria e eksceseve reale apo e imagjinuar. Eksceset në bashkësinë e parë njerëzore ishin mjaft primitive dhe kryesisht kanë qënë vepra të drejtuara kundër jetës dhe trupit. Ndaj kryesve të eksceseve në këtë bashkësi më së shpeshti bëhej dëbimi nga bashkësia, hakmarrja, në veçanti gjakmarrja dhe kopozicioni.¹¹⁹

Duhet theksuar se gjakmarrja dhe hakmarrja u aplikua edhe pasparaqitjes së shtetit dhe së drejtës, mirëpo, duke shkuar në evolucion dhe kufizim gradual. Në të drejtën zakonore shqiptare sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit (i cili për fat të keq akoma praktikohet te shqiptarët edhe në ditët e sotme, akoma ka familje të ngjuara për shkak të hakmarrjes), të afërmit e kryesit të veprës¹²⁰ penale që jetonin të ndarë, janë detyruar të ruhen vetëm 24 orë pas kryerjes së vrasjes. Pas kalimit të këtij afati kanë mundur të lëvizin lirisht, sepse ndaj tyre nuk ka guxuar të merret gjaku. Në institucionin e talionit për gjakmarrjen vlente rregulla “ sy për sy, dhëmb për dhëmb”, pra, të shkaktohet e keqe e të njëjtit lloj, duke e ndaluar kështu që, për një njeri mos vriten më shumë se një, gjë që bën edhe zanafillën e proporcionalitetit midis së keqes së pësuar dhe dëmit që është shqiptuar.

Në pikat e më poshtme, për kuptimin filozofik dhe sociologjik të dënimit do të shtjellohen më gjërë e gjatë evoluimi i dënimit.

¹¹⁸ Saliu, Ismet.” E drejta penale –pjesa e përgjithsme “, Prishtinë, 2008, fq.70

¹¹⁹ Saliu, Ismet.” E drejta penale –pjesa e përgjithsme “, Prishtinë, 2008, fq.70

¹²⁰ Gjeçovi, Shtjefën. Kanuni i Leke Dukagjinit, ribotim 1989, sipas botimit të vitit 1933, Shkodër;

E drejta penale dhe “ Human Rights act 1998”, ky ligj është projektuar që të sigurojë mbrojtjen e të drejtave të individëve sipas Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), mund të ndikojë në përkufizimin e veprave penale në dy mënyra:

- 1) Një i pandehur mund të argumentojë se dënimi i tij për një vepër penale të caktuar do të shkelte të drejtat e tij të parashikuara në¹²¹ Konventë,
- 2) Një viktim ose një viktim potenciale, mund të argumentojë se shteti ka shkelur të drejtat e tij duke mos e mbrojtur atë sipas ligjit penal. Në çështjen *A v UK* fakti që njerku mund të rrihte thjeshtrinë e tij pa qenë përgjegjës për tu ndëshkuar sipas ligjit penal, shkelte të drejtat e thjeshtrit të tij. Kjo më pas çoi në gjykatën e Apelit në çështjen *H*, që të interpretonte sërisht rrethanat në të cilat një prind mund të mbështetet në mbrojtjen e ndëshkimit të arsyeshëm kur përballet në një akuzë për sulm.¹²²

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, në nenin 2, parag.1, ka përcaktuar të drejtën e jetës: *e drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Askujt nuk mund ti privohet jeta qëllimisht, me përshtim të rastit kur zbatohet një vendim gjykate pas dënimit për një krim për të cilin dënimi është parashkuar me ligj*¹²³.

Në parag. 2, privim nga jeta nuk konsiderohet të shkaktohet në kundërshtim me këtë nen në rastet kur ky privim vjen nga përdorimi i forces, që është jo më shumë se absolutisht I domosdoshëm¹²⁴:

- a) në mbrojtjen e çdo personi nga dhuna e pa ligjshme,
- b) për të kryer një arrestim të ligjshëm ose për të parandaluar arratisjen e një personi të ndaluar¹²⁵ ligjërisht,
- c) për të kundërshtuar, në përputhje me ligjin, një trazirë ose një kryengritje.¹²⁶

¹²¹ Herring, Jonathan. “ E drejta penale – Teori, kazuse dhe materiale”, Botimi V/Volimi I, (shqipëroi:Spartak Ngjela, Alkeda Reçi, Edlira Stavre), Tiranë, 2013, fq. 45

¹²² Herring, Jonathan. “ E drejta penale – Teori, kazuse dhe materiale”, Botimi V/Volimi I, (shqipëroi:Spartak Ngjela, Alkeda Reçi, Edlira Stavre), Tiranë, 2013, fq. 45

¹²³ Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore

¹²⁴ Parag.2, neni 2, i Konventës Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore

¹²⁵ Parag.2, neni 2, i Konventës Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore

¹²⁶ Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore

Askush nuk mund ti nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose degraduese (neni 3). Ndërsa, në nenin 5, po të kësaj Konvente është përcaktuar e drjeta e lirisë dhe sigurisë, në nenin 6, e drejta për një procedurë të rregullt¹²⁷.

Në nenin 7, thuhet se : askush nuk mund të dënohet për një veprim ose për një mosveprim, që në momentin kur është kryer nuk përbënte vepër penale, sipas së drejtës së brendshme ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin kur është kryer¹²⁸ verpa penale.

Ky nen nuk do të ndikojë mbi gjykimin dhe mbi dënimin e një personi për një veprim ose për një mosveprim, i cili në momentin kur është kryer, quhej vepër penale sips parimeve të përgjithshme të së drejtës, të njohura nga kombet e qytetëruara.¹²⁹

2.3.1.Kuptimi filozofik – juridik për dënimin

Natyrë, thelbi dhe në përgjithësi kuptimi i dënimit dhe qëllimi i tij janë preokupim kryesor i kuptimit filozofik- juridik në të kaluarën dhe të sotmen. Platoni e ka definuar retibutivitetin si fundament i dënimit me të bazohet padrejtësia e shkaktuar me veprën e kryer, por kjo nuk përjashton edhe përmirësimin kryerësit përkundër neutralizimit të dënimit me vdekje. Juristët romakë (*Ulpianusi, Paulusi, Papinianusi*), dënimin e sqaronin për afërsisht si hakmarrje e drejtë për veprën e bërë, por nuk e përjashtonin edhe funksionet e frikësimit dhe të përforcimit të disiplinës publike. Ideja për dënimin si hakmarrje dhe për dënimet e rënda dhe të padrejta si mjete për frikësim dhe neutralizim, do të dominojë me kuptimin penalo-juridik, me ligjet e rralla dhe me praktikën gjyqësore deri në paraqitjen e së drejtës penale bashkëkohore në fillim të shek XX.¹³⁰

¹²⁷ Neni 5,6, i Konventës Europiane e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore

¹²⁸ Neni 7, I Konventës Europiane e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore

¹²⁹ Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore

¹³⁰ Kambovski, Vllado. “E drejta penale – pjesa e përgjithshme”, (përkthim) Përkthyer Ismail Zejneli, Afrim Osmani ; Shkup, 2010, fq. 463

Idea e shkollës klasike – sipas mësimi filozofik të kësaj shkolle, inderterminizimi dhe botëkuptimi për vullnet të lirë, pas sjelljeve njerëzore, qëndron gjithmonë parimi hedonistic I kënaqësisë dhe dhimbjes: njeriu gjithmonë zgjedh aktivitetin që e ofron e para, që do të thotë mënjanon të dytën. Për atë edhe dënimi duhet të sjellë më shumë vuajtje sesa kënaqësi për veprën e bërë! *Filozofia themelore* e dënimit është ajo se me dënim paguhet- shpaguhet vepra e bërë.¹³¹

Juristi anglez Bentam përpunoi teorinë e dobishmërisë shoqërore të dënimit, të ashtuquajturën *teori utilaterale*. Në veprën e tij “Teoria e dënimit”, prezantoi idetë lidhur me qëllimin e dënimit në luftë kundër kriminalitetit¹³². Bentam kontribut të posaçëm ka dhënë në reformën e enteve ndëshkuese dhe legjislacionin mbi ekzekutimin e dënimeve, në drejtim të humanizmit të ekzekutimit të dënimeve me heqje të lirisë, duke u mbështetur me idetë e Xhon Huardit, i cili konsiderohet reformatori më i madh i enteve ndëshkuese gjatë gjysmës së dytë të shek.XVIII.¹³³

Themelues i shkollës antropologjike është italianii Cezaro Lombrozo, me profesion mjek, psikiatër dhe më vonë edhe profesor i mjeksisë gjyqësore¹³⁴. Në veprën e tij “Njeriu Kriminel”, theksonte se personat e lindur me anomali fizike dhe psikike janë kriminel të lindur.

Ai sipas karakteristikave dhe natyrës së kryerësve të veprave penale, i radhiti në pesë grupe, si: *fajtorët e lindur, fajtorët e sëmurë psikikisht, fajtorët e rastit, fajtorët nga pasioni dhe fajtorët nga shprehia*.

Pra sipas kësaj shkolle, dënimi nuk duhet të shfrytëzohet si mjet për hakmarrje por si instrument gjeneral dhe special i preventivës.

Pozitivizmi dhe ideali rehabilitues. Baza nisëse filozofike e shkollës antropologjike-pozitiviste është determinizimi: njeriu nuk vepron sipas dëshirës së tij por është i shtyer në kriminalitet nën ndikimin e forcave që janë jashtë kontrollit të tij. Mbi këtë bazë pozitivizmi

¹³¹ Kambovski, Vllado. “E drejta penale – pjesa e përgjithshme “,(përkthim) Përkthyer Ismail Zejnli, AfrimOsmani ; Shkup , 2010, fq. 463

¹³² Saliu, Ismet.” E drejta penale –pjesa e përgjithshme “, Prishtinë, 2008, fq.88

¹³³ Saliu, Ismet.” E drejta penale –pjesa e përgjithshme “, Prishtinë, 2008, fq.88

¹³⁴ Kambovski, Vllado. “E drejta penale – pjesa e përgjithshme “,(përkthim) Përkthyer Ismail Zejnli, AfrimOsmani ; Shkup , 2010, fq. 464

plotësisht e hodhi idenë për përgjegjësi dhe fajësi, e me të edhe dënimin duke mohuar idenë e retributivizmit si arsyetim për denim. Skeptik edhe në raport me frikën, pozitivizmi u pranon vetëm efektet reduktiviste-kufizuese të neutralizimit dhe përmirësimit. Pozitivizmi I preferon masat e sigurisë, gjatësia e së cilave varet nga vlersimi, i ekspertëve për nevojën e paritetit të rrezikshmërisë së autorit.¹³⁵

Në kohën e optimizimit rehabilitues, ishte fortë e besueshme se kriminologjia dhe shkencat tjera janë afër zbulimit për shkaqet e kriminalitetit. Në fushën e tyre u paraqit edhe teoria *bihevisoriste* për dënimin sipas së cilit koncepti ligjor i veprës penale, faj dhe dënimi si kategori morale, burimin e ka në vullnetin e lirë të njeriut janë paragjykime të thjeshta metafizike.¹³⁶

Ideja e drejtësisë, dënimi adekuat dhe procedura e drejtë, u paraqit në fillim të viteve të 70-ta, duke riafirmuar dy principe bazë të shkollës klasike në raport me dënimin, procedurë e zbatueshme dhe kufizime të autorizimeve arbitrare të gjyqit dhe proporcionalitet të dënimit me rëndësinë e veprës së kryer : secili sipas meritave.

Platform bashkëkohore filozofike e kuptimit të dënimit paraqet mësimin për të drejtat e njeriut, sipas së cilës çdo njeri është subjekt i së drejtave fundamentale mes të cilave edhe e drejta e lirisë¹³⁷ positive. Nëse ekziston e drejtë e tillë, atëherë dënimi është *prima facia* e keqe dhe kërkon arsyetim moral. Dënimi sipas definicionit është e keqe që përbëhet nga heqja dhe kufizimi i disa të drejtave të kryerësit për veprën e bërë. Prej këtu, të drejtat e njeriut janë premisë e domosdoshme logjike për ekzistimin e dënimit. Dënimi është paraqitur edhe kur në formën elementare njeriu u bë subjekt I të drejtave të përcaktuara. Ideja për denim ka sqarim vetëm në të drejtën e shkeljes së të drejtave të barabarta të të tjerëve, e kjo është e drejta e viktimës, në fakt viktimat e reja potenciale. Realizimi i veprave penale e ngushton larinë e tyre

¹³⁵ Kambovski, Vllado. "E drejta penale – pjesa e përgjithshme ",(përkthim) Përkthyen Ismail Zejneli, AfrimOsmani ; Shkup , 2010, fq. 464

¹³⁶ Vasilika, Hysi. "kriminologjia", Tiranë,2005, fq.145

¹³⁷ Kambovski, Vllado. "E drejta penale – pjesa e përgjithshme ",(përkthim) Përkthyen Ismail Zejneli, AfrimOsmani ; Shkup , 2010, fq.466

pozitive , kështu që arsyetimi gjeneral për dënimin duhet të jetë I drejtuar kahë përpara që të jetë domethënë konsekuente dhe reductive e bazuar në pritjen se ajo ndikon në uljen e krimit.¹³⁸

Nëse hymë në studim në thellësi të raportit të individit dhe shtetit dhe të drejtës për dënim, e drejta e dënimit akoma argumentohet si drejtë elementare ndaj autorit të veprës penale. Në shtetet bashkëkohore juridike, dënimi ka rol të vendosjes së kornizave të forta të reaksionit human dhe të drejtë të veprës së kryer.

2.3.2.Kuptimi sociologjik për dënimin

Shkolla sociologjike paraqitet në fund të shekullit të XIX. Sociologjia e dënimit i hulumton faktorët shoqëror për paraqitjen e dënimit dhe sistemit dënues si dhe paraqitjen e teorive të ndryshme për dënimin dhe qëllimet e tij.

Teoritë sociologjike për dënimin ndahen në dy grupe të mëdha: kualitative dhe kuantitative.*Teoritë kuantitative* e hulumtojnë teorinë e llojit të ndarë të dënimit nga fillimi deri në fund si dhe brenda çdo dënim, ndikimin e variablave sociale të ndara mbi ndërrimet e tij. *Toritë kualitative* e drejtojnë interesin e vet kah kuptimi, thelbi i dënimit si bërthamë e brendshme.

K. Marks e zhvilloi shpjegimin sociologjik të fenomeneve shoqërore mbi bazën e strukturës ekonomike, raportet prodhuese bazike dhe konfliktin klasor në mes dy klasave kundërshtuese: qeveria kapitaliste që i posedon mjetet e prodhimit dhe klasa punëtore që e shet të vetmen gjë që e posedon fuqin puntore. Kështu që, dënimi zbatohet nga ana e shtetit për shkak të thyerjes së ligjit , kurse vet shteti dhe ligji shprehin interes e klasës qeveritare . sipas kësaj, funksioni I dënimit vihet në instance përfundimtare të sigurimit të pozicionit të klasës sunduese.¹³⁹

¹³⁸ Kambovski, Vllado. "E drejta penale – pjesa e përgjithshme ",(përkthim) Përkthyen Ismail Zejneli, AfrimOsmani ; Shkup , 2010, fq.466

¹³⁹ Kambovski, Vllado. "E drejta penale – pjesa e përgjithshme ",(përkthim) Përkthyen Ismail Zejneli, AfrimOsmani ; Shkup , 2010, fq.467-468

Filozofi francez *Althusser* e zhvilloi mësimin e marksizmit strukturalist sipas të cilit, struktura e sistemit social dhe raportet mes rrafshëve të ndryshme ose instancave është pika qendrore e kuptimit të shoqërisë si tërësi komplekse nga rrafshëve të ndryshme ose instanca. Pozicionet determinues nga ekonomia por edhe instancat super strukturale të ideologjisë dhe politikës nuk janë reflekse të thjeshta, por posedojnë autonomi relative. Sistemi dënuet ka funksion të dyfishtë: ai përmban instrumente represive, dënim që shërben për frikësim, por nga ana tjetër realizon funksion ideologjik duke bartur edhe mesazhe morale të përcaktuara.¹⁴⁰

Sociologu gjerman Max Weber, në librin e tij *Ekonomia dhe Shoqëria*, përkufizon pushtetin si aftësia e një aktori social për të ushtruar (nganjëherë përmes përdorimit të forcës) kontroll mbi sjelljet e aktorëve të tjerë, edhe pa pëlqimin e këtyre të fundit, duke kushtëzuar vendimet e tyre. Weber e kupton pushtetin si pasuri, prestigj, status, forcë numerike dhe fizike, eficiencë organizative, gjithçka që ofron një¹⁴¹ avantazh. Sociologu ka zhvilluar një teori të artikuluar që ka patur një ndikim të madh. Weber dallon dy koncepte: konceptin Macht (fuqia) dhe Herrschaft (pushteti legjitim). Me termin fuqi ai nënkupton “çdo mundësi që të dominojë brenda një raporti social, edhe kundrejt një kundërshtimi, vullnetin e vet, cilado që të jetë baza e kësaj mundësie”; me termin pushtet legjitim nënkupton “mundësinë e gjetjes së bindjes tek disa persona, në një urdhër që ka një përmbajtje të caktuar”. Shprehja e parë i referohet një raporti social ku subjekti më i fortë mund të dominojë vullnetin e vet në çdo rast; shprehja e dytë i referohet raporteve ku subjekti i dobët pranon vendimet e tjetërkujt sepse i njeh të vlefshme dhe si rrjedhim legjitime¹⁴². Weber, duke u bazuar mbi këtë koncept të dytë, realizoi tipologjinë e tre formave të legjitimitetit të pushtetit: pushtetit tradicional, pushtetit karizmatik dhe pushtetit racional-legal.¹⁴³

Durkheim e vëzhgon evolucionin e shoqërisë në dy faza: shoqëri paraindustriale dhe në shoqëri të zhvilluara. Në këto shoqëri, solidariteti shoqëror ka forma të ndryshme, rol të posaçëm në krijimin dhe në mbajtjen e solidaritetit I cili është kush I domosdoshëm për rend social dhe ekzistim të shoqërisë e ka dënimin. Shoqëritë e vetme janë ndërtuar mbi solidaritetin mekanik dhe vetëdijes kolektive homogjene. Kriminliteti paraqet lëndimin e rëndë të vetëdijes kolektive

¹⁴⁰ Po aty, vepr. Cituar fq.468

¹⁴¹ <https://shtetiweb.org/2014/11/19/teorite-sociologjike-mbi-pushtetin-politik/>

¹⁴² <https://shtetiweb.org/2014/11/19/teorite-sociologjike-mbi-pushtetin-politik/>

¹⁴³ <https://shtetiweb.org/2014/11/19/teorite-sociologjike-mbi-pushtetin-politik/>

dhe tërheq përgjegjësi kolektive në lloj të dënimit, i cili shërben për vendosje kolektive të vetëdijes. Dënimi nuk ka efekt primar edukues dhe friksues,¹⁴⁴ por është produktuar nga emocionet kolektive retributive dhe ka efekt stigmatik.

2.4. Sistemi i dënimeve në R.M.V.

Përcaktimin e llojit dhe matjen e lartësisë së¹⁴⁵ sanksioneve penale ndaj personave fizik gjykatësi i kryen në bazë të kriterëve objektive në vijim: 1. kategorizimi objektiv i veprës penale dhe 2. jeta e mëparshme e kryerësit të veprës penale.

Në kategorizimin objektiv të veprës penale janë dhënë kufijtë minimal dhe maksimal të dënimeve të cilat do të mund t'i shqiptohen kryerësit të veprës penale në kategorizimin horizontal (dënimi në gjobë, gjobë ose me burgim në 3,6,9 muaj; gjobë ose me burgim 1, 2,3,4,5 deri në denim me gjobë ose me burgim deri në 10 vjet), varësisht nga ajo se në cilën kategori vertikale kryerësi do të klasifikohet, nëse gjykata jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm konstaton se kryerësi e ka kryer veprën penale, që i ngarkohet.¹⁴⁶ Në çdo kategori vertikale është përcaktuar vlera e mesme e lartësisë së dënimit (në muaj), nga e cila gjykata do të fillojë t'i llogaritë rrethanat lehtësuese dhe rënduese në bazë të së cilës do ta individualizojë lartësinë e dënimit për kryerës konkret. Pra, do të llogarisë shkallën e përgjegjësisë, motivet nga të cilat është bërë krimi, rrethanat, jeta e më parshme e kryerësit, kontributi i viktimës në kryerjen e krimit, etj.

Kriteri për jetën e mëparshme të kryerësit të veprës penale përcaktohet në bazë të kategorive vertikale në vijim siç parashihen në nenin 10:

- I. i padënuar
- II. . deri në dy aktgjykime të plotfuqishme për vepra penale për të cilat është paraparë dënim me para ose dënim me burg deri në 5¹⁴⁷ vjet
- III. deri në dy aktgjykime të plotfuqishme nga të cilat të paktën njëra është për vepër penale për të cilën është paraparë dënim me burg mbi 5 vjet¹⁴⁸

¹⁴⁴ Zanaj, Fatmir. " Sociologjia e së drejtës", Tiranë, 2009, fq, 239

¹⁴⁵ Gazeta zyrtare e R.Maqedonisë, Ligji për caktimin dhe matjen e lartësisë së dënimit, Shkup, 2014

¹⁴⁶ Gazeta zyrtare e R.Maqedonisë, Ligji për caktimin dhe matjen e lartësisë së dënimit, Shkup, 2014

¹⁴⁷ Gazeta zyrtare e R.Maqedonisë, Ligji për caktimin dhe matjen e lartësisë së dënimit, Shkup, 2014

¹⁴⁸ Po aty

- IV. tre aktgjykime të plotfuqishme ose dy aktgjykime me dënim të shqiptuar efektiv me burg mbi 6 muaj ose një aktgjykim me dënim të shqiptuar efektiv me burg prej së paku ¹⁴⁹3 vjet
- V. katër aktgjykime të plotfuqishme ose dy aktgjykime me dënim të shqiptuar me burg prej së paku dy vjet ose një aktgjykim me dënim të shqiptuar me burg prej së paku ¹⁵⁰5 vjet
- VI. pesë ose më shumë aktgjykime të plotfuqishme ose dy aktgjykime prej së paku 5 vjet burg ose një aktgjykim prej së paku 8 vjet¹⁵¹ burg. Në këtë kriter bëjnë pjesë edhe gjykimet të cilat janë parashkruar në fazë të përmbarimit. Në këtë kriter nuk bëjnë pjesë gjykimet e shlyera si dhe gjykimet me dënim me burg deri në tre vjet për të cilat në pajtim me ligj janë plotësuar kushtet për shlyerjen e tyre.¹⁵²

Në nenin 4, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, janë paraparë sanksionet penale dhe masa të trajtimit të detyrueshëm:

Sanksionet penale janë: 1) *dënimet kryesore*; 2) *dënimet alternative*; 3) *dënimet plotësuese*; dhe 4) *vërejtja gjyqësore*.

Masat e trajtimit të detyrueshëm, të cilat mund t'i shqiptohen kryesit që nuk është penalisht i¹⁵³

përgjegjshëm ose është i varur nga droga, ose nga alkooli, janë:

- a) trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor;
- b) trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri¹⁵⁴; dhe
- c) trajtimi me rehabilitim të detyrueshëm të personave të varur nga droga apo alkooli.¹⁵⁵

¹⁴⁹ Po aty

¹⁵⁰ Gazeta zyrtare e R.Maqedonisë, Ligji për caktimin dhe matjen e lartësisë së dënimit, Shkup, 2014

¹⁵¹ Gazeta zyrtare e R.Maqedonisë, Ligji për caktimin dhe matjen e lartësisë së dënimit, Shkup, 2014

¹⁵² Gazeta zyrtare e R.Maqedonisë, Ligji për caktimin dhe matjen e lartësisë së dënimit, Shkup, 2014, neni 10, fq.168

¹⁵³ KODI NR. 06/L-074 PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 2 / 14 JANAR 2019, PRISHTINË

¹⁵⁴ KODI NR. 06/L-074 PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 2 / 14 JANAR 2019, PRISHTINË

¹⁵⁵ KODI NR. 06/L-074 PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 2 / 14 JANAR 2019, PRISHTINË

2.5. Nocioni dhe evolucioni i sistemit të dënimeve në R.M.V.

Dënimi ka dy dimensione: **juridike shtetërore dhe individuale!** E para shprehë të drejtën shtetërore të dënimit (*ius puniendi*), kurse e dyta që kryerësi i veprës penale të lëndohet, të vuaj dënimin. Nënkuptohej se në këtë raport rol dominues ka shteti që i zgjedh qëllimet, përmbajtjet dhe metodat e dënimeve duke i vendosur në korniza juridike-institucionale! Një e drejtë shtetërore liberale dhe demokratike mund të mbijetojë jo vetëm mbi legalitetin, por edhe mbi ligjitimitetin e së drejtës penale të dënimit. Sepse pikërisht dënimi si forca më e theksuar e shtetit, mund të paraqes edhe aktin më të rrezikshëm të keqpërdorimit të qeverisjes represive të saj dhe mund të ndërpritet vetëm nëse shteti respekton kornizat dhe qëllimet e dënimit të përcaktuara me marrveshje me qytetarët e vet. Kriteret për mbajtjen dhe kufizimin e dënimit, shteti duhet ti kërkojë në parimet e humanitetit, *të liberalitetit dhe racionalitetit*: dënimi duhet të jetë human, të jetë i paraparë vetëm për sjellje që i cenojnë vlerat themelore të jetës sociale (*in dubio pro liberate*) dhe të¹⁵⁶ paraqes mjet të nevojshëm (*ultimatio ratio*) për realizimin e funksioneve mbrojtëse të së drejtës penale. Po ashtu, e drejta e dënimit duhet të ketë **bazë etike**, sikurse edhe format tjera të realizimit të pushtetit shtetëror duhet të jenë të drejtuara kah “ *e mira e përgjithshme*”.¹⁵⁷

Pra, nëse ska bazë sociale etike dënimi do të ishte represion bosh dhe akt i agresivitetit kolektiv ndaj kryerësit të veprës penale dhe do ishte m shumë me karakter të hakmarrjes dhe të frikësimit.

E drejta shtetërore për dënimin e sublimon balancën në mes të drejtave individuale për jetë dhe të drejtat e bashkësisë për stabilitet social dhe siguri dhe për të duhet të respektojmë parimin e detyrimit shtetëror si dhe parimin e humanitetit dhe proporcionalitetin e dënimit me rëndësinë e veprës (Moris –Howard, 153). Por pa dyshim është se definimi i dënimit si këthim i drejtë për

¹⁵⁶ Kambovski, Vllado. “E drejta penale – pjesa e përgjithshme “,(përkthim) Përkthyen Ismail Zejneli, AfrimOsmani ; Shkup , 2010, fq. 462

¹⁵⁷ Kambovski, Vllado. “E drejta penale – pjesa e përgjithshme “,(përkthim) Përkthyen Ismail Zejneli, AfrimOsmani ; Shkup , 2010, fq. 462

veprën e kryer e hap pyetjen për arsyetimin e saj si reaksion artificial i paramenduar, përmbajtja dhe qëllimi i sëcilës përcakton dhe e zbaton subjektin racional (ligjvënësi dhe gjyqi)!¹⁵⁸

Pluralizmi dhe pluralizmi radikal është mësiminterkasionist për të cilin nuk është e pranueshme as qëndrimi maksist për determinimin ekonomik të dënimit, por as pluralizmi konvencional i cili nisët nga qëndrimi për rolin e pavarur e neutral të shtetit dhe të institucioneve të tij. Përkundër sqarimit të thjeshtë të dënimit modern në dritën e faktorit ekonomik, karakterit të raporteve prodhuese, ky mësim e përfaqëson tezën për ndikim ndërmjet të atij faktori, sëbashku me faktorët e tjerë social mbi ambientin e moralit të përgjithshëm shoqëror dhe në definimin e qëndrimeve të shoqërisë në raport me krimin dhe dënimin. E padiskutueshme është se mbi variacionet e dënimit edhe paraqitja e dënimeve të përcaktuara (p.sh. tendimi që në disa shtete të kthehet dënimi me vdekje) ndikon edhe fenomeni i politikës morale që rrezulton edhe prej rrethanave të tilla siç është shprehja e disa veprave (vrasja, dhunimi). Sipas kësaj, dënimi dhe format e tij më shumë mund të vëzhgohen si fenomene kulturore nëpërmjet të cilave shprehet veprimi kryqëzues më shumë faktorëve sesa prodhim direkt i faktorëve ekonomik.

Qasja interaksioniste në respektimin e faktorëve ekonomik, social, politik, të religjionit, kulturor dhe ideologjik mbështetet në sintezën sociologjike të elementeve të cilat nuk janë në ndërsjellje kontradiktore. Krahas kësaj, pluralizmi radikal mund mund të konstruktohet mbi bazat e humanizmit me tezën se njeriue bënë historinë e vet personale në rrethana ku janë prezente faktor të ndryshëm ekonomik, politik, ideologjik.¹⁵⁹ Në të drejtën bashkëkohore për dënimin rëndësi kanë faktorët kulturor dhe antropologjik më shumë, ndërsa, faktorët ekonomik dhe social kanë më pak.

2.6. Sistemi i dënimeve në KPM

Në Kodin penal, të Maqedonisë së Veriut, në Kapitullin e III, janë përcaktuar qëllimi i ndëshkimit, llojet e dënimeve dhe kushtet për shqiptimin e tyre.

¹⁵⁸ Kambovski, Vllado. "E drejta penale – pjesa e përgjithshme ",(përkthim) Përkthyen Ismail Zejneli, AfrimOsmani ; Shkup , 2010, fq. 462

¹⁵⁹ Po aty, vep.cit. fq.470

Qëllimi i dënimeve nuk është hakmarrës, por është pengimi i kryesit të kryej veprë penale, riedukimi i tij, risocializimi dhe riintegrimi i tij në shoqëri nëse ka mbajtur dënimin. Po ashtu, në këtë formë mund të ndikojë në edukimin e të tjerëve që të mos kryejnë veprë penale.

Në evolucionin e vet dënimi ka kaluar në disa etapa historike: periudha e dënimit robërues në kohën e shoqërisë skllavopronare antike, periudha e dënimit me të holla në mesjetë, periudha e afirmimit e dënimeve trupore dhe të dënimeve me vdekje në mesjetën e mëvonshme, periudha e shtëpive përmisuese në erën merkantile dhe burgjet në fillim të shek. XX, periudha bashkëkohore ku përveç burgut, si sanksion primar futen dënimet me të holla dhe masat alternative. Evolucionin e këtyre hap pyetjen për shkaqet e ndryshimeve në llojet e dënimeve të dominuara në njërin apo në periudhën tjetër, që nënkupton edhe pyetje për perspektivat e dënimit. Këto pyetje janë edhe më shumë interesante, sepse vëzhgimet më të larta në historinë e dënimeve tregojnë se nuk ekziston ndonjë lëvizje drejtëvizore, psh. Zbutje të dënimit, por më shumë lëvizje ka aplituda e përcaktuar, kështu psh. Periudha e mesjetës është dalluar me dënime më të rrepta në krahasim me feudalizmin e hershëm. Kjo na drejton në hulumtime komplekse dhe pëlqimin (respektimin, konsideratën) e faktorëve ekonomik dhe strukturën sociale, por edhe të përgjithshmen si ato kulturore dhe ideologjike të shoqërisë dhe qëndrimet e saj për dënimin dhe dënueshmërinë.¹⁶⁰

Në periudhën bashkëkohore zhvillimit të së drejtës penale evoluimi i sistemit të dënimit në shikim të parë vërteton bindjen se dënimi lëviz nëpër trajektoren e zbutjes së vazhdueshme, kështu që dënimet e rënda zavendësohen me dënime më humane. Por nga ana tjetër, përkundër shpjegimit se bëhet fjalë për proces të *abolimit konstant të dënimit*, njëjtë apostrofohet edhe kriza e sistemit dënues. Më pas dallohen disa fusha të krizës: kriza e burgut, e sistemit të dënimit, e sistemit të së drejtës penale dhe shoqërisë nëpërgjithësi. Për karakteristika të përgjithshme të krizës dhe sistemit të dënimit llogariten: butësia e tepëruara ndaj kryerësit të së drejtës penale dhe forcimi i së drejtave të tyre duke përkundur të drejtat e viktimave, mosrespektimi dhe papërgjegjësia e institucioneve tjera, çmimi i lartë i krimit dhe i dënimit, kriminalizimi shumë i gjërë, shfrytëzimi shumë i madh i institucioneve (burgu), zbatimi diskriminues i dënimit etj. **Kriza e burgut** shpjegohet si krizë ideologjike e legjitimitetit të burgosjes e nxitur me shkatërimin

¹⁶⁰ Kambovski, Vllado. "E drejta penale – pjesa e përgjithshme", (përkthim) Përkthyer Ismail Zejnli, Afrim Osmani ; Shkup, 2010, fq.488

e idealit rehabilitues para viteve të 70-ta dhe si krizë materiale dhe e kushteve të vuajtjes së dënimit dhe resurseve penologjike e nxitur me numrin shumë të madh të popullatës në burg¹⁶¹ dhe problemet në burg dhe në trajtimin postpenal të të burgosurve të më hershëm.

Dënimet trupore kanë luajtur rol të caktuar në humanitetin e sistemit të dënimit sepse janë zbatuar më shpesh si zavendësim i dënimit me vdekje, kurse disa siç është njollosja, kanë qenë shumë praktike për ndalimin e recidivizmit si evidencë për të gjykuarin e më hershëm¹⁶². Në shek XIX pas dominimit të dënimit me burg dënimi- rrahje ishte dënim plotësues që i mundësoj të mbijetojë gjatë kohë. Rrahja me kamxhik u zbatua në Angli në pjesën e parë të shek.XX (në vitin 1920, parlamenti anglez e legalizoi përdorimin e kamgjikut për vjedhësit me dhunë *Barnes,57*); në Amerikë në shtetin Minesota më vitin 1925 u miratua ligji për kamxhikosje të detyrueshme me kombinim me burgun ose dënimi me të holla për dymbëthjetë vepra, nga vrasja deri te vozitja në gjendje të dehur; më gjatë deri në vitin 1973 ky dënim u mbajtë në shtetin amerikan Delaver (në këtë shtet në periudhën 1900- 1942 janë dënuar me kamxhikosje 7,302 persona nga i cili dënimi ka qenë i realizuar 22% ndaj të dënuarve, *Sutherland/ Cressey, 266*).

Në vitin 1978 në Revalpindi të Pakistanit një masë e madhe njerëzish kanë marrë pjesë në rrahje publike me kamxhikosje të një të riu 27 vjeçar i gjykuar për dhunim të një vajze 17 vjeçare.

Pasi dënimet trupore janë në kundërshtim me konceptin themelor të të drejtave të njeriut, por nuk është tejkuluar praktika e zbatimit ilegal të torturës dhe mundimeve trupore, të personave që janë në paraburgim ashtu edhe të burgosurve, në të drejtën penale bashkëkohore ligjvënësi e ka larguar dënimin trupor, duke garantuar kështu të drejtat themelore të qytetarëve. Ndalea e aplikimit të torturës është ngritur për mbrotje me standarde universale penale juridike.

Në deklaratën universale të të drejtave të njeriut, e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, në vitin 1948, në nenin 5, është bër ndalesa e torturës dhe dënimit të egër dhe jo¹⁶³

¹⁶¹ Kambovski, Vllado. "E drejta penale – pjesa e përgjithshme ",(përkthim) Përkthyen Ismail Zejneli, AfrimOsmani ; Shkup , 2010, fq.488-489

¹⁶² Kambovski, Vllado. "E drejta penale – pjesa e përgjithshme ",(përkthim) Përkthyen Ismail Zejneli, AfrimOsmani ; Shkup , 2010, fq.488-489

¹⁶³ Neni 5, I Deklaratës Universale e të Drejtave të Njeriut, e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, 1948

njerëzor. Ku edhe në rregullat standarde minimale për sjellje me të burgosurit, në rregulloren 31, parashohin se duhet të jetë plotësisht e ndaluar si dënim disiplinor: dënimi trupor, dënimi me vendosje në qeli të errët, nxjerrja në të ftohtë, etje, uria, etj.

Në nenin 142, mundimi dhe veprimet e tjera jonjerëzore dhe nënshtruese dhe dënime në Kodin Penalë të Maqedonisë së Veriut, është paraparë si vepër penale e posaçme kundër lirive dhe të drejtave të njeriut dhe¹⁶⁴ qytetarit.

Për sa i përket dënimit me vdekje, në legjislacionet bashkëkohore, të shteteve në tranzicion, ku bën pjesë edhe shteti jonë, dënimi me vdekje është hequr pasi është kushti elementar për praninë dhe për integrim në Bashkimin Evropian. Ndërsa, shumica e shteteve e kanë shfuqizuar ose e kanë të kufizuar dënimin me vdekje, disa shtete pas vitit 1900, e kanë hequr. Shtete të cilat akoma e kanë dënimin me vdekje janë Kina, India dhe 13 shtete në ShBA. Shtete abolicioniste janë Anglia, Australia Kanada dhe Evropa, po, ashtu ka shtete që de faktor janë abolicioniste dhe shtete që dënimin me vdekje e aplikojnë në raste të posaçme.

Në fund të shekullit XIX u themelua edhe lëvizja abolicioniste e cila edhe sot e kësaj dite angazhohet për heqjen e dënimit me vdekje. Kjo lëvizje ka arritur rezultate të konsiderueshme, ngase që përpos që u zvoglua numri i veprave penale, për të cilat mund të shqiptohet dënimi me vdekje gjer në fund të vitit 1970, arriti që në 40 shtete të botës të abrogohet dënimi me vdekje, nëse në dekadat e fundit numri ishte shteteve që e kanë abroguar dënimin me vdekje¹⁶⁵ është shumë më i madh. Tani ekzistojnë itharët e pro dënimit me vdekje dhe ato kundër dënimit me vdekje (abolicionistët).¹⁶⁶

2.7. Llojet e dënimeve në R.M.V

Në kodin Penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në nenin 33, parag. 1, për veprat penale të kryerësve që kanë përgjegjësi penale mund të shqiptohen këto dënime:

¹⁶⁴ Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut

¹⁶⁵ Sijeriçiq-Çoliq, Hajrija & Halilović, Haris. "E drejta e procedurës penale me vështrim të posaçëm në procedurën penale të Kosovës" Prishtinë, 2007

¹⁶⁶ Sijeriçiq-Çoliq, Hajrija & Halilović, Haris. "E drejta e procedurës penale me vështrim të posaçëm në procedurën penale të Kosovës" Prishtinë, 2007

- 1) dënimi me burgim, 2) dënimi me gjobë, 3) ndalimi për të kryer profesion, veprimtari apo detyrë, 4) ndalimi për të drejtuar automjetin, 5) dëbimi i të huajt nga vendi.

Në paragrafin e dytë të po këtij neni, është përcaktuar se dënimi me burgim mund të shqiptohet vetëm si dënim kryesor. Ndërsa, në paragrafin e 3, për dënimin me gjobë është theksohet se: dënimi me gjobë mund të shqiptohet si dënim kryesor dhe si dënim dytësor së bashku me dënimin me burgim ose me lirimin me kusht me të cilin është përcaktuar dënimi me burgim¹⁶⁷.

Në paragrafin 4, nëse për një vepër penale janë paraparë dënimi me burg dhe dënimi me burg hde dënimi me gjobë, atëherë si dënim kryesor mund të shqiptohet vetëm njëri prej tyre, përveç nëse me ligj¹⁶⁸ është paraparë se mund të shqiptohen që të dy dënimet.

Bashkë me dënimin kryesor mund të shqiptohet një apo më shumë dënime dytësore, nënkushtet për shqiptimin e tyre të paraparë me¹⁶⁹ ligj. Me ligj mund të parashihet edhe shqiptimi i domosdoshëm të dënimit sekondar(parag.5).

Në nenin 34, të Kodit penal të Maqedonisë së Veriut, në parag.1, është përcaktuar: *kryerësit të veprës penale i shqiptohet dënimi i caktuar për veprën e kryer penale, por ndëshkimi më i butë nga i caktuari mund të shqiptohet vetëm në kushte të parapara me¹⁷⁰ kod.* Ndërsa në paragrafin e 2, thuhet se për veprat penale të kryeranga leverdia personale mund të shqiptohet dënimi me të holla si dënim dytësor edhe kur nuk është caktuar me ligj ose kur është caktuar me ligj se kryesi do të dënohet me¹⁷¹ dënim me burgë ose me gjobë, kurse gjykata si dënim kryesor do ta shqiptojë dënimin me burgim.

Në nenin 29, të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë *si dënime kryesore* për kryesit e veprës penale, janë përcaktuar: 1. Me burgim të përjetshëm, 2. Me burgim, dhe 3. Me gjobë¹⁷².

Për personat që *kanë kryer kundërvajtje penale* jepen këto dënime kryesore:

1. Me burgim dhe 2. Me gjobë.

¹⁶⁷ Neni 33, parag. 3, I Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut

¹⁶⁸ Neni 33, parag.4, I Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut

¹⁶⁹ Parag.5, neni 33, I Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut

¹⁷⁰ Parag.1, neni 34, I Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut

¹⁷¹ Parag.2, neni 34, I Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut

¹⁷² Ligji Nr. 7975 “ Kodi Penal , I Republikës së Shqipërisë “ i datës 26.07.1995, azhuruar 2014.

Në nenin 30, të Kodit penal të Republikës së Shqipërisë ,për personat që kanë kryer krime ose kundërvajtje penale, bashkë me dënimin kryesor, mund të jepen edhe një ose disa nga këto *dënime plotësuese*: 1. Ndalimi i të drejtës për të ushtruar funksione publike. 2. Konfiskimi i mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe produkteve të veprës penale.¹⁷³ 3. Ndalimi për të drejtuar automjete. 4. Heqja e dekoratave, titujve të nderit¹⁷⁴. 5. Heqja e së drejtës të ushtrimit të një veprimtarie ose mjeshtërie. 6. Heqja e së drejtës për të ushtruar detyra drejtuese pranë personave juridikë. 7. Ndalimi për të qëndruar në një ose disa njësi administrative¹⁷⁵. 8. Nxjerrja jashtë territorit. 9. Detyrimi për publikimin e vendimit gjyqësor. 10. Humbja e përgjegjësisë prindërore. Gjykata, në raste të veçanta, kur dhënia e dënimeve kryesore çmohet e papërshtatshme dhe kur ligji parashikon dënim me burgim deri në 3 vjet ose dënime të tjera më të lehta për veprën e kryer,¹⁷⁶ mund të mjaftohet vetëm me caktimin e dënimin plotësues.

Më parë kur Republika e Maqedonisë se Veriut dhe Repblika e Kosovës, kanë qenë pjesë konstituive e federatës Jugosllave, ka ekzistuar dënimi maksimal deri në 25 vite dhe dënimi me vdekje për vepra të rënda penale (Ligji Penal i vitit 1974). Me supremimin e autonomisë së Kosovës nga ana e Sërbisë më vitin 1989, tani zbatoheshin ligjet e Sërbisë, e jo të Kosovës. Pas luftës së vitit 1999, në Kosovë kishim administrimin ndërkombëtar UMNIK, sipas Rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1244, dhe zbatoheshin ligjet e aplikueshme në Kosovë, të periudhës së Autonomisë së Kosovës, si dhe disa ligje Jugosllave. Pas aprovimit të Kushtetutës së Kosovës në vitin 2008, u pa e nevojshme dhe e arsyeshme për ndryshimin dhe nxjerrjen e një kodi të ri penal, në të cilin Kod Penal si risi u parashikua dënimi me burgim të përjetshëm, si dhe dënimin me burgim jo më pak se 30 ditë, e jo më shumë se 25 vjet (Kodi Penali Republikës së Kosovës, nr. 04 & L-82).

Sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, llojet e dënimeve janë: 1) *dënimet kryesore*; 2) *dënimet alternative*; dhe 3) *dënimet plotësuese*.¹⁷⁷

¹⁷³

¹⁷⁴ Pika 1,2, Neni 30, Ligji Nr. 7975 “ Kodi Penal , I Republikës së Shqipërisë “ i datës 26.07.1995, azhuruar 2014.

¹⁷⁵ Pika 3,4 Neni 30, Ligji Nr. 7975 “ Kodi Penal , I Republikës së Shqipërisë “ i datës 26.07.1995, azhuruar 2014.

¹⁷⁶ Ligji Nr. 7975 “ Kodi Penal , I Republikës së Shqipërisë “ i datës 26.07.1995, azhuruar 2014.

¹⁷⁷ NENI 39, KODI NR. 06/L-074 PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 2 / 14 JANAR 2019, PRISHTINË

Ndërsa llojet e dënimeve kryesore janë përcaktuar në nenin 40, si në vijim: a) dënimi me burgim të përjetshëm; b) dënimi me burgim dhe c) dënimi me gjobë¹⁷⁸.

2.7.1. Dënimet me burg

Dënimi me burgim konsiston në marrjen e lirisë së lëvizjes (lirisë së qarkullimit) kryesit të veprës penale për një kohë të caktuar. Ky lloj dënimi në të drejtën penale konsiderohet një ndër dënimet më të rënda ngase me këtë dënim kryerësit të veprës penale i merret një e drejtë themelore, çfarë është e drejta e lëvizjes¹⁷⁹, qarkullimit të lire. Dënimi me heqje të lirisë apo siç emërohet në ligj, dënimi me burgim, për here të pare është paraparë në Kodin Penal të Francës në vitin 1971. Më pas këtë lloj dënimi e parapanë të gjitha kodet penale të Evropës dhe të gjithë botës¹⁸⁰. Ky lloj dënimi paraqitet nën ndikimin e shkollës klasike, veçmas të përfaqësuesit të tij më të denjë Cezaro Bekarios. Dënimi me burg paraqitet si zavendësim I dënimit me vdekje dhe të dënimeve të tjera fizike, të cilat në përmasa të gjëra me shekuj të tërë u zbatuan gjatë mesjetës¹⁸¹. Në krahasim me dënimet fizike të vrazhda, që u zbatuan gjatë mesjetës dhe më parë, dënime këto të cilat konsistonin në tortura të ndryshme fizike dhe prerjen e gjymtyrëve të trupit, të cilat shkaktonin dhembje të mëdha dhe invaliditet, paraqitja e dënimeve me heqje të lirisë, me të drejtë konsiderohet përparim i madh në drejtim të humanizmit¹⁸² të represionit penal. Parashikimi i dënimit me burg në vend të dënimeve fizike, nga mbarë njerëzimi është konsideruar si fitore ndaj errësirës, arbitraritetit dhe barbarizmit të mesjetës.¹⁸³

Në legjislacionet e shteteve bashkëkohore, njihet një numër i vogël i dënimit me burg, që ka për tendencë edhe zvoglimin e mëtejshëm. Lloji i dënimit me burgim, nuk është i njëjtë në të gjitha legjislacionet e shteteve bashkëkohore dhe dallon edhe mënyra e ekzekutimit të tyre. Në ishJugosllavi në Kodin penal të vitit 1951 dhe vitit 1977, kur u aprovua Ligji Penal i federatës

¹⁷⁸ KODI NR. 06/L-074 PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 2 / 14 JANAR 2019, PRISHTINË

¹⁷⁹ Saliu, Ismet." E drejta penale –pjesa e përgjithsme ", Prishtinë, 2008, fq. 452

¹⁸⁰ Kodi penal Francesë I vitit 1971

¹⁸¹ Zanaj, Fatmir. " *Sociologjia e së Drejtës*", Tiranë,2009, fq. 242

¹⁸² Saliu, Ismet." E drejta penale –pjesa e përgjithsme ", Prishtinë, 2008, fq. 452-453

¹⁸³ Saliu, Ismet." E drejta penale –pjesa e përgjithsme ", Prishtinë, 2008, fq. 452-453

Jugosllave dhe ligjet penale të republikave të saj, kanë ekzistuar dy lloje të dënimit me heqje të lirisë: *dënimi me burgim dhe dënimi me burgim të rëndë*.

Në të drejtën positive, ligjvënësi në nenin 35, të Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ka parëcaktuar 7 paragrafe për burgimin.

Në parag. 1, të nenit 35, thuhet : burgimi nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë, as më i gjatë se¹⁸⁴ 15 vjet. Për veprat penale për të cilat është paraparë dënim me burgim të përjetshëm, munt ë shqiptohet dënimi me burg prej 20 vjet. Parag. 2, nëse për veprën penale e kryer me dashje është paraparë dënimi me bur me kohëzgjatje prej 15 vjetësh, për forma të rënda të asaj vepre mund të caktohet edhe burgim i përjetshëm¹⁸⁵. Dënimi me burgim të përjetshëm nuk mund të caktohet si dënim i vetëm kryesor (parag.3, n.35).

Në paragrafin e 4, të po këtij neni, për kryerësi e veprës penale të cilët nuk kanë mbushur moshën 21 vjeçare, kur e kanë kryer veprën penale, nuk mund ti shqiptohet dënimi me burg të¹⁸⁶ përjetshëm. Paragrafi i 5, burgimi shqiptohet në muaj dhe vite të plotë, kurse dënimi në 6 muaj edhe në ditë të plota¹⁸⁷. Kur për veprën penale është paraparë burgim pa theksuar masën më të vogël, kurse masa më e madhe nuk është më shumë se 3 vjet, përpos atij dënimi detyrimisht përcaktohet edhe dënimi me të holla(parag.6).

Për sa i përket vendit për ekzekutimin e dënimit, në paragrafin e 7, të po lëtij neni thuhet: *burgimi vuhet në institucione për vuajtjen e dënimit të parëcaktuar me ligj*.

Në Kodin Penal të Republikës së Shqipëris, në nenin 32, dënimi me burgim për krimet jepet për një kohë nga pesë ditë deri në tridhjetë e pesë vjet. Për kundërvajtje penale dënimi me burgim jepet për një kohë nga pesë ditë deri në dy vjet.¹⁸⁸

Në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, në nenin 42, për dënimin me burgim është paraparë si në vijim:

¹⁸⁴ Parag.1, neni 35, I Kodit Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut

¹⁸⁵ Parag.2, neni 35, I Kodit Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut

¹⁸⁶ Parag.4, neni 35, I Kodit Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut

¹⁸⁷ Parag.5, neni 35, I Kodit Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut

¹⁸⁸ Ligji Nr. 7975 “ Kodi Penal , I Republikës së Shqipërisë “ i datës 26.07.1995, azhuruar 2014.

1. Dënimi me burgim nuk mund të shqiptohet në kohëzgjatje më pak se tridhjetë (30) ditë e as më tepër se njëzet e pesë (25) vjet.
2. Për vepra penale për të cilat ligji parasheh dënim me burgim të përjetshëm, gjykata mund të shqiptoj dënim me burgim deri në tridhjetë e pesë (35) vjet.
3. Dënimi me burgim shqiptohet në vite dhe në muaj të plotë, e në rastet kur dënimi është deri në gjashtë (6) muaj, dënimi shqiptohet në ditë të plota.¹⁸⁹

2.7.2. Anët e mira dhe të këqija të dënimit me burg

Dënimet me burg e zëvendësuan frikën nga torturat dhe gjymtimet fizike, dhe kryesisht kishin për qëllim edukimin dhe arsyetimin e atyre personave të cilët jetonin në varfëri dhe shkallë shumë të ulët të dijes dhe arsimit, gjendje kjo e cila më së teprëmi kontribuon që¹⁹⁰ të kryhen veprat penale. Përkudër mangësive dhe dobësive që u shprehën gjatë të ekzekutimit të dënimeve me burg dhe zhgënimet e idealistëve që pritnin se me këtë lloj të dënimit do të duket kriminaliteti, dënimet me burg u treguan shumë efektive në krahasim me të gjitha llojet e dënimeve fizike që u zbatuan në mesjetë.¹⁹¹

Dënimet penale kanë pasoja të shumta juridike, ekonomike, sociale dhe morale.

Në aspektin social tangon qëndrimet e rrethit social, sjelljet e tij me të dënuarin e më parshëm. Mbi qëndrimet negative sociale dhe paragjykimeve mund të ndikohet vetëm në ndikimin e zhvillimit të shpirtit tolerant dhe ndihmesën, përkundër hakmarrjes, hakmarrje dhe ekskomunikim (për problemet e pranimit të personave të dënuar në rrethin social, posaçërisht me sigurimin e supozimeve materiale elementare për riintegrim. Në *aspektin juridik* ka të bëjë me pengesat e ndryshme juridike për riintegrim të përfshira me dënimet sekondare të shqiptuara të ndslimeve të cilët zgjasin edhe pas vuajtjes së dënimit (ndalesa për të kryer profesion, veprimtari

¹⁸⁹ KODI NR. 06/L-074 PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 2 / 14 JANAR 2019, PRISHTINË

¹⁹⁰ Saliu, Ismet. "E drejta penale – pjesa e përgjithsme", Prishtinë, 2008, fq. 453

¹⁹¹ Saliu, Ismet. "E drejta penale – pjesa e përgjithsme", Prishtinë, 2008, fq. 453

ose detyrë ose ndalesë për të drejtuar automjete) dhe pasojat juridike prej dënimit si dhe regjistrimi, gjegjësisht regjistrimi i dënimit në evidencë penale.¹⁹²

Pasojat juridike nga dënimi paraqiten në formë të humbjes të disa të drejtave që i dënuari i ka pasur para dënimit të parapara me ligj ose në formë të ndalesave të arritjes së disa të drejtave të parapara me ligj për shkak të dënimit të shqiptuar. Dënimi që përbëhet në kufizimin e të drejtave të të dënuarit gjatë kohës së vuajtje së tij ose pas vuajtjes së tij (dënimet e ndalesave) paraqet poashtu pasojë juridike të dënimit, ose mbikqyrja mbrojtëse e dënimit me kusht, trajtimi i masave të¹⁹³ sigurisë institucionale etj. Për këtë duhet prej rrethit të pasojave juridike të përjashtohen ato efekte të dënimit që e bëjnë vet përmbajtjen e dënimit ose të sanksionit tjetër të shqiptuar që ka të bëjë vet dënimi. Po ashtu, pasojë juridike nuk paraqet trajtimi i posaçëm i kryerësit të veprës së re penale i nxitur me faktin e dënueshmërisë së mëhershme (recidiviteti si rrethanë rënduese). Edhe pse është në kuptim të gjerë, pasojat juridike të dënimit të shqiptuar, vënia e të njëjtës në evidencën penale dhe dhënia e të dhënave për dënueshmëri të më parshme paraqet institut të veçantë penalo- juridik. Ligji parashe se pasojat juridike mund të parashihen vetëm dhe me fuqi të ligjit. Pasoja nga dënimi sipas kësaj janë të drejta të kufizuara me ligj që përbëhen me humbjen e disa të drejtave ose ndalesave për të arritur disa të drejta që janë paraqitur me fuqinë e ligjit gjatë dënimit të kryesit dënim me burg.¹⁹⁴

2.7.3.Burgim i përjetshëm

Burgimi i përjetshëm është dënim i veçantë që mund të përshkruhet për forma të rënda të veprave penale të paramenduara për të cilat është përshkruar dënim i burgim deri në 15 vjet.

Në paragrafin 2, të nenit 35, përmbante autorizimin kur në një pjesë të veçantë ose në një dispozitë të veçantë penale juridike në një ligj tjetër, për veprën penale të kryer me dashje, është

¹⁹² Kambovski, Vllado. "E drejta penale – pjesa e përgjithshme ",(përkthim) Përkthyen Ismail Zejneli, AfrimOsmani ; Shkup , 2010, fq.611

¹⁹³ Kambovski, Vllado. "E drejta penale – pjesa e përgjithshme ",(përkthim) Përkthyen Ismail Zejneli, AfrimOsmani ; Shkup , 2010, fq.612-613

¹⁹⁴ Kambovski, Vllado. "E drejta penale – pjesa e përgjithshme ",(përkthim) Përkthyen Ismail Zejneli, AfrimOsmani ; Shkup , 2010, fq.612-613

paraparë një burg prej 15 vjetësh, për format e rënda të asaj vepre penale që të përcaktohet në mënyrë alternative të përcaktohet dënimi me burg të¹⁹⁵ përjetshëm.

Dënimi me burg të përjetshëm për herë të parë është përcaktuar në legjisalcionin maqedonas dhe ajo paraqet privim të përhershëm nga liria, që si institut dhe nocion është e panjohur për Kushtetutën dhe rendit juridik. Veprimtaria e këtij dënimi prej natyrës fikse është zbutur me paragr.4 të kësaj dispozite, duke pasur parasysh ndalesën e shqiptimit të burgut të përjetshëm kryerësit i cili në kohën e kryerjes së veprës penale nuk i ka mbushur 21 vjet¹⁹⁶ të jetës. Tjetër bazë juridike për kufizimin e këtij dënimi, është instituti i lirimimit me kusht, në nenin 36, paragrafi 4, i dënuari me burg të përjetshëm, mund të lirohet me kusht pasi të ketë vuajtur së paku 15 vjet të dënimit me burg. Përkrah, këtyre përjashtimeve ky dënim mbetet si dënim i privimit të përjetshëm nga liria.¹⁹⁷

Neni 41, dënimi me burgim të përjetshëm, në kodin Penal të Republikës së Kosovës në mënyrë koncize ka paraparë:

1. Ligji mund të parasheh dënimin me burgim të përjetshëm për veprat më të rënda penale të kryera në rrethana veçanërisht rënduese ose për vepra penale që kanë shkaktuar pasoja shumë¹⁹⁸ të rënda.
2. Ligji nuk mund të parasheh dënimin me burgim të përjetshëm si të vetmin dënim kryesor për një vepër të veçantë penale¹⁹⁹.
3. Dënimi me burgim të përjetshëm nuk mund t'i shqiptohet personit i cili në kohën e kryerjes së veprës penale nuk i ka mbushur njëzetën (21) vjet ose personit i cili në kohën e kryerjes së veprës penale ka pasur aftësi esencialisht të zvogëluar mendore.²⁰⁰

¹⁹⁵ Neni 35, I Kodit Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut

¹⁹⁶ Пројевски, Јован., Кривичен Законик“, објаснувања, коментари, судска практика, Агенција Академик-Скопје, Скопје, 1998, ст. 169

¹⁹⁷ Пројевски, Јован., Кривичен Законик“, објаснувања, коментари, судска практика, Агенција Академик-Скопје, Скопје, 1998, ст. 169

¹⁹⁸ KODI NR. 06/L-074 PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 2 / 14 JANAR 2019, PRISHTINË

¹⁹⁹ KODI NR. 06/L-074 PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 2 / 14 JANAR 2019, PRISHTINË

Në Kodin penal të Republikës së Shqipërisë , në neni 31 për dënimin me burgim të përjetshëm jepet me vendim të gjykatës për kryerjen e një krimi të rëndë. Dënimi me burgim të përjetshëm nuk jepet ndaj personave që në kohën e kryerjes së krimit nuk kanë mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, si dhe për gratë.²⁰¹

Duke vazhduar më tutje në neni 33, të po këtij kodi të shqipërisë thuhet se :

Dënimi me burgim të përjetshëm dhe dënimi me burgim vuhen në institucione të caktuara posaçërisht për këtë qëllim. Rregullat mbi mënyrën e vuajtjes së dënimeve, të drejtat dhe detyrat e të dënuarve caktohen me ligj. Të miturit e kryejnë dënimin me burgim në vende të veçanta nga të rriturit. Gratë e kryejnë dënimin me burgim në institucione të veçanta nga burrat.²⁰²

2.7.4.Dënimi me të holla

Në zhvillimin historik të dënitit, dënimi me gjobë është më i vjetër se dënimi i të privuarit nga liria. Në Romën e vjetër dënimi me gjobë ka qënë dënim i rregullt edhe për veprat më të rënda, kurse burgu ka shërbyer për mbajtjen e shkurtë të kriminelëve.²⁰³

Dënimi me gjobë bën pjesë në llojet e dënimeve pasurore. Me anë të këtij dënimi, kryerësi i veprës penale detyrohet që brenda afatit të caktuar të paguajë një shumë të hollash në dobi të shtetit. Dënimi me gjobë është veçanërisht i përshtatshëm për rastet e veprave penale të lehta, mirëpo në mënyrë restriktive mund të zbatohet edhe në lëmin e kriminalitetit të mesëm²⁰⁴. Veçmas përparësia e këtij lloj dënimi konsiston se shpesh është mjet adekuat për të mos u

²⁰⁰ KODI NR. 06/L-074 PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 2 / 14 JANAR 2019, PRISHTINË

²⁰¹ Ligji Nr. 7975 “ Kodi Penal , I Republikës së Shqipërisë “ i datës 26.07.1995, azhuruar 2014.

²⁰² Ligji Nr. 7975 “ Kodi Penal , I Republikës së Shqipërisë “ i datës 26.07.1995, azhuruar 2014

²⁰³ Kambovski Vllado.” E drejta penale pjesa e përgjithshme”, Shkup,2006, fq.512

²⁰⁴ Salju, Ismet.” E drejta penale –pjesa e përgjithshme “, Prishtinë, 2008, fq. 455

shqiptuar dënimi me burgim afatshkurtër. Pra, me anë të këtij dënimi, e drejta penale bashkëkohore aspiron që kryerësit e veprave penale të lehta, madje edhe të mesme, të mos e mbajnë vulën e të burgosurit, të mos stigmatizohen pa nevojë.²⁰⁵

Dënimi m gjobë konsiston në obligimin e personit të gjykuar që në afatin e caktuar është i obliguar të paguaj shumën e caktuar të shqiptuar²⁰⁶ si dënim në aktgjykim në dobi të shtetit. Me shqiptimin e dënimit me të holla në mes të kryesit të veprës shtetit krijohet raporti obligativ kur shteti paraqitet si kreditor e kryesi si debitor.²⁰⁷

Shqiptimi i dënimit me gjobë, na le të kuptojmë se me pagesën e gjobës zvoglehët pasuria e kryerësit të veprës penale dhe pasojë afatëgjate në pakësimin e mundësisë për plotësimin e nevojave të tij që kanë ekuivalencë të hollash.

Dënime plotësese quhen llojet e dënimeve që, me përjashtime të veçanta, nuk zbatohen në mënyrë të pavarur, por jepen bashkë me dënimin kryesor. Dënimet plotësuse jepen për një kohë të përcaktuar, në mënyrë të përhershme ose me ekzekutim të menjëhershëm²⁰⁸

Me ndryshimet e kodit në v.2004 të gjitha sanksionet me karakter punitiv janë të sistematuara si dënime, numri i të cilave është rritur në 5: dy kryesore, burgu dhe dënimi me para; dhe tre ndihmëse: ndalesa për kryerjen e profesionit veprimari apo detyrë, ndalesë për të drejtuar automjetin dhe largimi²⁰⁹ të huajit nga vendi. Është zgjeruar repertuari i masave alternative të gjashtë sanksioneve: dënimi me kusht, dënimi me kusht me mbikqyrës, ndërprerja me kusht e procedurës dënuese, puna në dobi shoqërore, vërejtje gjyqësore dhe burgu shtëpiak.

Karakteristikë tjetër në sistemin e ri të sanksioneve është fleksibiliteti: repertuari i gjerë i dënimeve është kornizë e qëlluar në të cilën mund të realizohet përcaktimi për zbatim restriktiv të burgut dhe dënimit në përgjithësi për rastet më të rënda dhe për zbatimin më të madh të masave alternative për rastet më të lehta të veprave penale.²¹⁰

²⁰⁵ Saliu, Ismet." E drejta penale –pjesa e përgjithsme ", Prishtinë, 2008, fq. 455

²⁰⁶ Petroviq, Borisllav."E drejta penale", Sarajevë/Prishtinë,2006, fq.117

²⁰⁷ Petroviq, Borisllav."E drejta penale", Sarajevë/Prishtinë,2006, fq.117

²⁰⁸ Muçi, Shfaqet." E drejta penale pjesa e përgjithshme", Tiranë, 2007, fq.250-251

²⁰⁹ Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut në vitin 2004

²¹⁰ Kambovski Vllado." E drejta penale pjesa e përgjithshme", Shkup,2006, fq.252-253

Në nenin 38, të Kodit Penal të shtetit tonë për sa i përket dënimit me të holla, janë pëcaktuar 6 paragrafe:

- 1) Dënimi me gjobë shqiptohet në gjoba ditore, me çka numri i gjobave ditore, nuk mund të jetë më i vogël se pesë, e as më i madh se 360 gjoba ditore.
- 2) Gjykata bën matjen e numrit të gjobave ditore sipas rregullave të përgjithshme për matjen e dënimit
- 3) Lartësinë e gjobës ditore gjykata e cakton duke i marrë parasysh mundësitë pasurore dhe personale të kryesit, duke nisur nga rregulla e të ardhurave të pastra ditore, që kryesi i realizon ose mund ti realizojë, si dhe nga obligimet e tjera familjare të kryerësit dhe të gjendjes së tij pasurore në kohën e ²¹¹sjelljes së aktgjykimit. Vlera më e vogël e gjobës ditore është një euro në kundërvlerë të denarit, kurse më e madhe 5000 euro në kundërvlerë të denarit
- 4) Vendimi gjyqësor e përfshin shumën e dënimit me të holla që fitohet me shumëzimin e numrit të gjobave ditore me vlerën e caktuar të gjobave ditore
- 5) Për shkak të përcaktimit të vlerës së gjobës ditore gjykata mund të kërkojë njoftim nga bankat, institucionet e tjera financiare, organet shtetërore dhe personat juridik, që janë të obliguar që ti dërgojnë njoftimet e kërkuara dhe nuk mund të thirren në mbrojtjen ²¹² e sekretit afarist
- 6) Kur dënimi me gjobë shqiptohet si dënim dytësor përkaj dënimit me burg, gjykata e përcakton në shumë në të hollash , duke mos zbatuar dispozitat e paragrafit 1 dhe 5. Dënimi me gjobë si dënim dytësor nuk mund të jetë më i vogël se 20 euro në kundërvlerë të denarit, e as më i madh se 5000 euro në kundërvlerë të denarit ²¹³

Ligdhënësi në kodin penal të R.Maqedonisë në nenin 38-a paragrafi i 1 e ka paraparë edhe intervalin kohorë për pagimin gjobës. Kështu që gjykatësinë aktgjykim përcakton afatin për pagesë të dënimit me gjobë, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 ditë, as më i gjatë se 3

²¹¹ Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut

²¹² Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut

²¹³ Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut

muaj, por në raste të arsyeshme gjykata mund të lejojë që i dënuari të paguaj dënimin me gjobë edhe me këste, ashtu që afati i pagesës nuk²¹⁴ mund të jetë më i gjatë se dy vjet.

Në po të njëjtin nen është paraparë nëse kryerësi është i huaj, atëherë gjykata do të vendos që dënimi me gjobë ta paguaj duke mos e shtyrë, ose do të siguron pagesën e tij në mënyrë tjetër.

Në paragrafin e 2 tëpo këtij neni është paraparë nëse i dënuari nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar, atëherë gjykata do të caktoj afat të ri ose nëse vleron se i dënuari nuk dëshiron që ta paguaj, atëherë mund të urdhëroj realizim të saj me dhunë në procedurë të përcaktuar me²¹⁵ ligj. Nëse dhënia e afatit të ri, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se tre muaj ose realizimi i dhunshëm mbet pa sukses, atëherë gjykata do ta realizoj ashtu që për çdo gjobë ditore do të përcaktoj një ditë burg, ose kur dënimi me burgim është shqiptuar si dënim dytësor, për çdo 20 euro të filluara në kundërvler të denarit, atëherë do të përcaktoj një ditë burg, me çka burgun nuk mund të jetë më i gjatë se gjashtë muaj. Në paragrafin e 3 thuhet nëse i dënuari paguan vetëm një pjesë të dënimit me gjobë, atëherë pjesa e lënë proporcionalisht do të shëndrohet në burg, e nëse i dënuari e paguan pjesën tjetër të dënimit me gjobë,²¹⁶ atëherë ekzekutimi i burgmit do të ndërpritet..

Kodi Penal aktual i Shqipërisë, dënimin me gjobë nuk e ka përcaktuar shprehimisht si sanksion penal në kuadër të alternativave të dënimit me burgim. Mirëpo, vënien e këtij dënimi në kuadër të dënimeve alternative, e ka imponuar vet ligjdhënësi aktual penal shqiptar, ngase dënimi me gjobë është përcaktuar si dënim alternativ me dënimin me burgim dhe dënimin për kundërvajtje penale në më tepër se 53% të të gjitha dënimeve të parapara në Pjesën e Posaçme të këtij kodi.²¹⁷ Si rezultat i kësaj të dhëne, dënimi me gjobë e kemi sistemuar edhe si sanksion penal në kuadër të dënimeve alternative.²¹⁸

Shuma e gjobës së dënimit që paguhet nga kryesi i veprës penale shkon në buxhetë të shtetit.

²¹⁴ Neni 38 a, parag.1, Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut

²¹⁵ Neni 38 a, parag.2, Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut

²¹⁶ Kambovski Vllado. "E drejta penale pjesa e përgjithshme", Shkup, 2006, , fq.928-929.

²¹⁷ Ukaj Bajram. "Dënimet në të drejtën penale të Shqipërisë", Prishtinë, 2006, fq 321

²¹⁸ Ukaj Bajram. "Dënimet në të drejtën penale të Shqipërisë", Prishtinë, 2006, fq 321

2.7.4.1. Anët e mira dhe të këqija të dënimit me të holla

Këtij sistemi i jepen vërejtje se çon kah vendime të porealizueshme në raport me dënimin jo të njëjtë të kryerësit me potencialin pasuror të ndryshueshëm, por i hedhet për diçka tjetër se e shkatron tërësinë logjike të vendimit për dënimin dhe se për këtë përcaktimi i numrit të gjobave ditore është arbitrare, e nxjerrë nga impresioni që ka gjykatësi në raport me peshën e dënimit që²¹⁹ e meriton kryerësi. Në zbatim praktik të këtij sistemi, logjika e tillë e çon gjyqin në radh të parë të vërtetojë një sasi të aplikueshme të paramenduar të dënimit e pasaj në mënyrë plotëse të konstruktojë numrin e gjobave ditore dhe çmimin e dënimit ditor. Kundërshtimi për këtë vendim reverzibil të gjyqit mund të mënjanohet nëse gjyqi rregullon në mënyrë precize përcaktimin e shumës së gjobës ditore, në mënyrë që të mundësojë kontroll të vendimit gjyqësor në procedurën me ankesë²²⁰

2.7.4.2. Regjimi i dënimit me të holla

Dënimi me gjobë mund të shqiptohet si dënim kryesor dhe si sekondar së bashku me dënimin me burgim. Për dënimin me gjobë si dënim kryesor, me ndryshimin e KPM të vitit 2004 është i pranuar sistemi i gjobës ditore, ku numri i gjobës ditore nuk mund të jetë më i vogël se 5 dhe as më i²²¹ madh 360 gjoba ditore. Vlera më e vogël e gjobës ditore është një euro, dhe jo më e madhe se 5000 euro në kundërvlerë të denarit. Gjyqi, shumën e dënimit me të holla e caktohet ashtu që, së pari matet numri i gjobave ditore dhe në fund numri i gjobave ditore shumëhet me vlerën e caktuar të gjobës ditore. Mirë po, gjatë kësaj gjyqi duhet të marrë parasysh rrethanat lehtëse ose rënduese që ndikojnë në numrin e gjobave ditore.²²²

²¹⁹ Kambovski, Vllado. "E drejta penale – pjesa e përgjithshme ",(përkthim) Përkthyen Ismail Zejneli, AfrimOsmani ; Shkup , 2010, fq.515

²²⁰ Kambovski, Vllado. "E drejta penale – pjesa e përgjithshme ",(përkthim) Përkthyen Ismail Zejneli, AfrimOsmani ; Shkup , 2010, fq.515

²²¹ Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut i vitit 2004

²²² Kambovski, Vllado. "E drejta penale – pjesa e përgjithshme ",(përkthim) Përkthyen Ismail Zejneli, AfrimOsmani ; Shkup , 2010, fq.515

Dënimi me gjobë është dënim i cili shqiptohet dhe ekzekutohet më së shpeshti pas dënimit me burgim në praktikën gjyqësore të shteteve të ndryshme të botës. Lidhur me ekzekutimin e tij në praktikën gjyqësore nuk ka probleme të veçanta kur personi i dënar në mënyrë vullnetare e zbaton këtë dënim, gjegjësisht e paguan gjobën me të cilën është dënuar nga gjykata kompetente.²²³

Nga njëra anë dënimi me gjobë do të thotë zvoglim i pasurisë së kryerësit, por nga analetër që është e rëndësishme, zvoglimi i këtillë i pasurisë duhet të ketë pasoja më afat gjatë në pakësimin e mundësisë së kryerësit për harxhime dhe për plotësimin e nevojave të tij që kanë²²⁴ ekuivalencë të të hollave.

²²³ Halili Ragip. "Penologjia shkenca mbiekzekutimin e sanksioneve penale", Prishtinë, 2005, fq. 251

²²⁴ Osmani Afrim, "Komentari i ligjit për ekzekutimin e sanksioneve", Shkup, 2013, fq. 238-239

KAPITULLI III

2. Dënimet e parapara në kodin penal për veprën penale Prodhimi i paautorizuar dhe lëshimi në përdorim i substancave narkotike, psikotropike dhe prekuzorëve 215(KPM) 215

Si vepër penale sipas dispozitës janë veprimet si prodhimi i paautorizuar prodhon, lëshon në qarkullim substanca narkotike, psikotropike dhe prekuzorë. Ato janë veprime me të cilat mundësohet marrja e drogës dhe substancave të tjera psikotrope, me qëllim të përhapjes së narkomanisë. Për mbrojtje repressive dhe preventive nga kjo e keqe janë sjellur disa dokumente ndërkombëtare, konventa ndërkombëtare të cilat i ka ratifikuar edhe shteti ynë. Substancë narkotike dhe prekuzore janë substancat me preardhje natyrore ose sintetike, me përdorimin e të cilave mund të krijohet varësi, të cilat si pasojë sjellin dëmtimet shëndetësore, ose në anën tjetër e rrezkojnë integritetin e njeriut në kuptim fizik, psiqik ose social.

Prodhimi i paautorizuar, përpunimi, shitja ose ndërmjetësim në shitje të substancave narkotike dhe ngjajshëm, janë format se si vihet deri te droga dehëse, prodhimi, përpunimi dhe lëshimi në shitje. Prodhimi dhe tregëtimi si objekt verpimi e kësaj dispozite është çdo prodhim, dhe trafikim të substancave narkotike, të cilat prodhohen nga personi fizik apo personi juridik, që nuk miratim nga organet kompetente.

Me trafikim nënkuptohet eksport, inport, transit, shitje dhe çdo formë e lëshimit në qarkullim të drogave të ndryshme.

Për veprën penale të nenit **215**, përcaktohen disa forma të rënda, për të cilat parashikohen sanksione të rënda penale. Në parag.1 të nenit 215, konkretisht, për prodhimin përpunimin, posedimin, blerjen, shitjen, transportimin dhe tregtimin pa autorizim të substancave narkotike dhe psikotrope apo të prekursorëve, autori dënohet me burgim nga tre²²⁵ deri në dhjetë vjet. Kjo veprë penale konsiderohet e kryer, kur personi e bën vetëm me dashje.

Paragrafi 2 i nenit 215 parashikon : kur vepra penale e përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni, është kryer me substancë narkotike, substancë psikotrope apo prekursorë në sasi të vogël dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri tre vjet.

Në paragrafin 3 të nenit 215 përcaktohet : kur veprën penale nga paragrafi 1 e kanë kryerë disa persona, ose në qoftë se autori i kësaj vepre organizon një rrjet të ri shitësve apo të ndërmjetësuesve, autori do të dënohet me burgim më së paku 5 vjet²²⁶.

Në paragrafin 4 inkriminohen veprimet e kundërligjshme që ndërlidhen me pajisjen apo material ose substanca për të cilat ai e di se ato janë të destinuara për prodhimin e drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve. Figurën e këtij krimi e përbëjnë prodhimi, prokurimi, ndërmjetësimi dhe dhënia në përdorim e sendeve të përmendura me lartë.²²⁷

Kodi penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut parashikon përjashtimin nga dënimi të autorëve të vepres penale në sasi të vogël të përcaktuar në paragrafin 2, të cilët zbulojnë krimin ose do të ndihmojnë në zbulimin e tij, por jo të organizatorit (neni 215, par 5).²²⁸

Ndërsa në nenin 216, paragrafi 1, parashikohet: personi që nxit tjetrin të konsumojë narkotikë apo prekursorë, ose ofron narkotik, substance psikotrope dhe prekursorë t'i konsumojë ai vetë apo t'ia jap për konsum ndonjë personi tjetër, ose do të vërehen në dispozicion hapësirën për konsumim të narkotikëve apo prekursorëve, ose ndonjërin nga mënyrat e tjera ua bën të mundur të tjerëve të konsumojnë narkotikë a substanca psikotrope dhe prekursorë²²⁹, do të dënohet me burgim prej një deri në pesë vjet. Në bazë të kësaj dispozite, kjo veprë penale konsiderohet e kryer, kur bëhet vetëm me dashje.

²²⁵ Parag.1, neni 215, i Kodit Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut

²²⁶ Parag.3, neni 215, Kodi penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut

²²⁷ Kodi penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut

²²⁸ Kodi penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut

²²⁹ Parag.1, neni 216, Kodi penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Në paragrafin 3 të nenit 216 parashikohet: “ Nëse krimi referuar në këtë nen është kryer nga personi juridik, personi juridik do t’i nënshtrohet një gjobe”. Kurse në paragrafin 4 të këtij neni përcaktohet : “ Droga narkotike, si dhe pasuritë e luajtshme ose pasuritë e paluajtshme të përdorura në prodhimin e tyre, transferimin dhe shpërndarjen, apo posaçërisht vënien në përdorim të tyre,duhet të konfiskohet”.

R.V.M. ka aprovuar edhe disa ligje që lidhen me luftimin dhe parandalimin e narkokriminalitetit. Njëri ndër ta është ligji nr. 07 – 33399/1, datë 01.08.2008, mbi kontrollin e narkotikve dhe substancave psikotrope.

Ndryshimet e vitit 2009 në KP parashikojnë një formë të re të privilegjuar në rast se ilaçi është në sasi më të vogla, me një dënim prej gjashtë muaj deri në tre vjet burg. Duhet të theksohet se problemet paraqiten në praktikën gjyqësore, pasi ky nocion i "sasisë së vogël të drogës" është një term i pasaktë, i paqartë dhe në kundërshtim që varet nga lloji dhe natyra e drogës. Me qëllim të harmonizimit të praktikës dhe sjelljes së Prokurorëve Publikë sipas parimit të ligjshmërisë dhe Barazia e Qytetarëve Para Ligjit, Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë miratoi Udhëzimin e Detyrueshëm Nr. 16/2010 sipas të cilit sasia e marijuanës konsiderohet të jetë më pak se 5 gram, heroinë deri në 2²³⁰ gram dhe kokainë deri në 2 gram. Në rastin e substancave psikotrope dhe pararendësve, secili rast duhet të analizohet individualisht, në varësi të llojit dhe sasisë që mund të përdoret përsëri.²³¹

Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope edhe për prodhimin e fabrikimin e lëndëve narkotike e psikotrope parashikon rregullat dhe proceduren ligjore se si realizohet. Subjektet që do të kryejnë këto aktivitete duhet të kërkojnë dhe të pajisen nga autoritetet kompetente shtetërore me një licensë te posaçme duke përcaktuar qartë mënyrën e ushtrimit dhe të kontrollit të këtij aktiviteti. Autoriteti kompetent shtetëror për këtë qëllim është Ministri i Shëndetësisë. Neni 284/c i Kodit Penal mbron pikerisht këtë aktivitet të rregullt ligjor duke inkriminuar çdo person që pa autorizim kryen aktivitete të tilla. Objekti i kesaj vepre penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura nga shteti për të siguruar ligjshmërinë e prodhimit, fabrikimit, nxjerrjes,

²³⁰ Miratimi I Udhëzimit të Detyrueshëm Nr. 16/2010 nga Prokurori Publik i Republikës së Maqedonisë

²³¹ Velju, Albulena. “Veptrat penale dhe narkokriminaliteti të rinjtë në Republika e Maqedonisë Veriore me theksë të vaçant Komuna e Gostivarit (aspektet juridike – penale dhe kriminalogjike) ”, Tezë magjistrature, Universiteti Ndërkombëtar në Strugë, 2020, fq.44

rafinimit dhe përgatitjes së lëndëve narkotike dhe psikotrope.²³² Konkretisht kryerjen e këtyre aktiviteteve në pajtim të plotë me ligjin. Veprimet e mësipërme paraqisin një rrezikshmëri të lartë shoqërore të cilës i përgjigjen dhe masat e larta të ndëshkimit me burgim. Kjo vjen për shkak se ky është momenti nga ku me përpunimin fizik e kimik të bimëve narkotike përfitohen lëndët narkotike dhe psikotrope, duke përfshirë dhe ato që janë rreptësisht të ndaluara për prodhim, qoftë dhe me licensë, siç janë substancat e tabelës së parë në veçanti heroina dhe nënproduktet e tjera të opiumit. Këto substanca, të ndaluara dhe për përdorim mjekësor, shpesh kanë pasoja vdekjeprurëse për përdoruesit²³³ e tyre.

Praktika gjyqësore :

Nëse droga është fshehur përfundi karrikes së mjetit motorik udhëtues, ajo mund të merret si objekt I synuar për të kryer veprën penale. Si objekt I veprës penale llogariten edhe paratë e gjatura te I akuzuari, të cilat I janë dhënë si dhuratë dhe si shpezime për udhëtim për kryerjen e veprës penale (VSM. Kvp. Nr.117/92, ZSO- V/1997, fq.70)

Vepra penale nga neni 215, paragrafi 1, të KP të RMV, - pjesa e përgjithsme dhe e veçantë , kryhet edhe kur bartet droga e huaj, nëse kryerësi e ka ditur se droga bartet për tu shitur (VSM,Kvp. Nr.123/92, ZSO-V/1997, fq. 81).²³⁴

2.1. Shqiptimi i denimit per veprën penale Prodhim i paautorizuar dhe lëshimi në përdorim i substancave narkotike, psikotropike dhe prekuzorëve 215(KPM) në rastet me sasi të vogla të mjeteve narkotike²³⁵

Ky ligj është i qartë në seksionin që ndalon kultivimin, prodhimin, tregtimin, mbajtjen dhe përdorimin e substancave dhe bimëve dhe përgatitjet e tyre, përveç në mjekësi ose hulumtime

²³² Ligji Nr. 7975 “ Kodi Penal , I Republikës së Shqipërisë “ i datës 26.07.1995./ ,azhruar 2014

²³³ Elezi, Alketa. “ Droga, një sfidë intelegjence, aspekte penalo-juridike dhe krahasuese të saj”, punim për gradën Doktor Shkence, Universiteti Tiranë, Tiranë, 2012, fq.160

²³⁴ Проевски, Јован., „Кривичен Законик“, објаснувања, коментари, судска практика, Агенција Академик-Скопје, Скопје, 1998, ст. 507

²³⁵ Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut

shkencore ose mjekësi ligjore, qëllime mësimore ose policore, siç përcaktohet me Ligjin për kontrollin e drogave narkotike dhe substancave psikotrope.²³⁶

Në vitin 1998, Qeveria e Republikës së Maqedonisë formoi Komisionin shtetëror mes resoreve për luftë kundër tregtisë së ndaluar me drogë dhe keqpërdorim të drogave me qëllim që të mobilizohen të gjitha resurset dhe kapacitetet e shtetit tonë në luftën kundër drogës. Po ashtu, në fund të vitit 2006 nga ana e Qeverisë është miratuar **Strategjia nacionale** për drogat, kurse në korrik të vitit 2007 është miratuar **Plani Aksional** për prevenim të drogave²³⁷.

Pyetësori i dërguar pranë qendrave ndërkomunale për punë sociale kishte për qëllim të sigurojë të dhëna dhe informata lidhur me veprimet, kushtet për punë dhe pengesat me të cilat²³⁸ ballafaqohen të punësuarit e qendrave për punë sociale në vend, gjatë veprimeve ndaj fëmijëve të cilët përdorin drogë dhe substanca të tjera psikotrope. Të dhënat e dërguara nga qendrat për periudhën prej vitit 2015 dhe 2016 për persona të moshës nën 18 vjet çojnë drejt konstatimit se një numër i vogël i fëmijëve janë evidentuar si fëmijë të cilët përdorin drogë.²³⁹ Kështuqë, gjithsej numri i fëmijëve meshkuj për vitin 2015 dhe 2016 është 10, ndërsa gjithsej numri i fëmijëve të evidentuar të gjinisë femrore është 3.

Tabela 1. Numri i fëmijëve të evidentuar sipas gjinisë të cilët përdorin drogë dhe substanca të tjera psikotrope

Sipas gjinisë	2015	2016
Meshkuj	4	3
Femra	3	3
gjithsej	7	6

Pasi në Maqedoninë e Veriut, shoqëria është heterogjene, në të cilën jetojnë disa etnitete, klasifikimi i konsumatorëve të substancave narkotike dhe prekursorëve bëhet kështu:

²³⁶ 3 <http://www.pravdiko.mk/narkotichni-drogi-i-kaznite-za-nivno-neovlasteno-proizvodstvo-i-pushtan-e-vo-promet>

²³⁷ Strategji nacionale dhe Plani Aksional I Komisionit, të formuar nga Qeveria në vitin 2006,2007 për preventimin të drogave

²³⁸ [www.http://ombudsman.mk](http://ombudsman.mk)

²³⁹ [www.http://ombudsman.mk](http://ombudsman.mk)

Tabela 2. Numri i fëmijëve të evidentuar sipas përkatësisë etnike, të cilët përdorin drogë dhe substancatë tjera psikotrope.

Sipas përkatësisë etnike	2011	2017	Gjithsej
Maqedon	11	63	74
Shqiptar	8	26	34
Turq			
Rom		2	2
Sërb	2	2	4
Vlleh			
Boshnjak			
Të tjerë			
GJITHSEJ	21	93	114

Sipas të dhënave të siguruar nga sektorët e Ministrisë së Punëve të Brendshme, përdorimi i substancave narkotike fillonë që nga mosha minorene 12 vjeçare, pastaj adoleshentët në moshën 15-17 vjeçare, pastaj grupmosha tjetër që është më aktive, mbi 18 vjeç.

Lidhur me çështjen se sa është numri i fëmijëve të cilët përdorin drogë dhe substanca të tjera psikotrope, një numër i madh i qendrave njoftojnë se nuk kanë evidencë të fëmijëve. Gjegjesisht, 26 qendra për punë sociale janë përgjigjur se nuk kanë evidentuar fëmijë të cilët përdorin drogë dhe substanca të tjera psikotrope. Nga ana tjetër, IP Qendra ndërkomunale për punë sociale e qytetit të Shkupit njofton se gjatë periudhës prej vitit 2015 dhe 2016 ka evidentuar 14 fëmijë të cilët përdorin drogë dhe substanca të tjera psikotrope,²⁴⁰ Qendra për punë sociale në Manastir ka evidentuar 2 fëmijë dhe Qendra për punë sociale – Dellçevë ka evidentuar 1 fëmijë. IP Qendra

²⁴⁰ [www.http://ombudsman.mk](http://ombudsman.mk)

ndërkomunale për punë sociale – Ohër njofton se disponon me supozime dhe informata të paverifikuara se disa fëmijë përdorin materje narkotike.²⁴¹

Çfarë lloj të shërbimeve dhe serviseve kanë për fëmijë të cilët përdorin drogë dhe substanca të tjera psikotrope?

13 qendra për punë sociale janë përgjigjur se nuk sigurojnë shërbime dhe servise të veçanta për këta fëmijë. Nga ana tjetër, 7 qendra për punë sociale (Shkup, Vinicë, Kavadar Gostivar, Koçan, Sveti Nikollë dhe Manastir) janë përgjigjur se gjatë veprimeve zbatojnë teknikat dhe metodat standarde për punë me fëmijët në rrezik dhe familjet, dhe në këtë kontekst përdorin punën këshillëdhënëse, duke këshilluar prindërit dhe fëmijët, përmes punës ekipore interdisiplinore, japin ndihmë dhe përkrahje profesionale ndaj fëmijës përdorues, ndërkaq zbatojnë edhe komunikim aktiv me familjen dhe ngjashëm. 10 nuk janë përgjigjur fare.

Shkup, Ohër, Radovish, Gostivar, Koçan, Dellçevë dhe Manastir, në pyetjen e parashtruar se cilat droga përdoren më shumë prej fëmijëve, u përgjigjën: e më së shpeshti është evidentuar shfrytëzimi i ngjitëseve, marihuanës, hashishit dhe tabletave.

Qendrat për punë sociale njoftojnë se familjeve të fëmijëve të cilët përdorin drogë dhe substanca të tjera psikotrope u sigurohet ndihmë materiale dhe mbështetje, si dhe përdoruesve të tjerë, përmes informimit dhe udhëzimit për procedurat për realizimin e të drejtave nga mbrojtja sociale, konform kriterëve të përcaktuara dhe gjendjes së familjes. Po ashtu, njoftuan se nuk kanë ndërmarrë veprime për rehabilitim dhe ri-socializim të fëmijëve të cilët shfrytëzojnë droga dhe substanca të tjera psikotrope. Nga ana tjetër, IP Qendra ndërkomunale për punë sociale e qytetit të Shkupit, në lidhje me nevojën për rehabilitim dhe ri-socializim u përgjegj se, për aktivitete të llojit të tillë duhet të ketë Qendër ditore për fëmijë shfrytëzues të drogave, ndërsa për Qendrat ndërkomunale për punë sociale në Gostivar, Manastir, dhe Dellçevë veprimet²⁴² të cilat ndërmerren për rehabilitim dhe ri-socializim janë: hartimi i planit individual për punë, mbështetja sociale, të udhëzuarit për shërbime këshillëdhënëse me familjen etj

Si lloj më i shpeshtë i drogës dhe substancave të tjera psikotrope të cilat i kanë përdorur fëmijët, ndërkaq të njëjtat janë evidentuar në institucionin shëndetësor përmenden marihuana,

²⁴¹ [www.http://ombudsman.mk](http://ombudsman.mk)

²⁴² [www.http://ombudsman.mk](http://ombudsman.mk)

ekstazat dhe psikostimuluesit. Sipas përgjigjeve të marra, mënyrës së trajtimit të shërimit të cilin Klinika për psikiatri e përdor ndaj fëmijës i cili përdor drogë dhe substanca të tjera psikotrope është edhe hospitalizimi i fëmijës, në pajtueshmëri me familjen, hartimi i planit për trajtim të gjendjes komorbide dhe sindromës bihejviolare.²⁴³

Tabela nr.3 Numri i fëmijëve të cilët përdorin drogë dhe substanca të tjera psikotrope, të evidentuar nga ana e Ministrisë për punë të brendshme

Sipas moshës	2015	2016	Gjithsej
12-14 vjeç		4	4
15-17	20	62	82
18 vjet	2	30	32
gjithsej	22	96	118

Sa i përket të dhënave të cilat i përkasin identifikimit të përdoruesit, identifikimi më i shpeshtë është përmes pranisë në rrugë, pastaj pas paraqitjes së pranuar nga ndonjë burim, përmes aksionit policor etj., ndërsa sipas evidencës, lloji më i shpeshtë i drogave të cilat i përdorin fëmijët është marihuana, ndërsa më i rrallë amfetamini dhe heroini.²⁴⁴

3.2. Shqiptmi i dënimit për veprën penale Prodhim i paautorizuar dhe lëshimi në përdorim i substancave narkotike, psikotropike dhe prekuzorëve 215(KPM) në rastet me sasi të mëdha të mjeteve narkotike²⁴⁵

Sipas të dhënave në table Gjykata Themelore Shkupi I është gjykata ku më tepër është shqiptuar dënimi me gjobë, për periudhën kohore 9 vjeçare ajo e ka shqiptuar dënimin me gjobë 7.178 herë, që dallon dukshëm prej gjykatave tjera, sepse kjo gjykatë nën kompetencë dhe juridiksion të saj ka territor dhe numër të banorëve më²⁴⁶ të madh.

²⁴³ [www.http://ombudsman.mk](http://ombudsman.mk)

²⁴⁴ [www.http://ombudsman.mk](http://ombudsman.mk)

²⁴⁵ Neni 215, Kodi penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut

²⁴⁶ Të dhëna sipas evidencave të Entit Statistikor të R.së Maqedonisë

Pas Gjykatës Themelore Shkupi I vlen të theksohen edhe dy gjykatat themelore që pasojnë këtë gjykatë, për nga kompetenca dhe numri banorëve, ato janë Gjykata Themelore e Tetovës dhe Prilepi, që kanë numër shumë më të vogël të shqiptimit të dënimeve me gjobë në krahasim me atë të Shkupit I, por midis veti kanë pothuajse numër të barabartë të dënimeve me gjobë sipas numrit ²⁴⁷të banorëve dhe territorit.

Sipas të dhënave të disponueshme të entit statistikor ,për vepra penale për periudhën e viteve 2005-2013 në Gostivar dënimi me gjobë është shqiptuar 176 herë, në Negotinë 76 herë dhe në Tetovë 1719.

Tabela nr 4. E të dhënave sipas evidencave të Entit Statitikor të R.së Maqedonisë për shqiptimin e dënimit me gjobë.

Gjykata	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	Gjithsej
Shkup 1	482	538	1044	1223	995	839	757	737	563	7178
Tetovë	15	42	75	50	86	229	229	422	571	1719
Prilep	88	84	97	81	137	135	151	115	135	1023
Ohër	54	115	92	62	181	154	141	113	97	1009
Shkup 2	350	356	49							775
Strugë	65	50	105	111	81	98	91	55	70	726
Manastir	58	63	66	71	75	53	44	53	49	532
Kërcove	37	37	14	30	52	85	89	80	88	512
Kumanov	-	40	74	47	23	49	38	30	13	314
Dibër	28	9	23	14	28	21	33	11	40	207
Gostivar	4	5	9	35	21	22	37	18	25	176
Negotinë	2	6	8	9	4	7	6	9	25	76
Resnjë	2	-	3	8	2	3	3	14	14	49

²⁴⁷ Të dhëna sipas evidencave të Entit Statitikor të R.së Maqedonisë

3.3. Dallimi ne shqiptimin e dënimeve për veprën penale Prodhim i paaautorizuar dhe lëshimi në përdorim i substancave narkotike, psikotropike dhe prekuzorëve 215(KPM) në rastet kur objekt²⁴⁸ i veprës është kokaina

Kokaina si drogë stimuluese, e veçmas disa prodhime sintetike në bazë të saj, në botën bashkëkohore përdoren shumë nga një kategori e personave të rinj. Përdorimi i saj është veçmas i pranishëm në disa qarqe kulturore artistike, në qarqet e rok dhe pop muzikës. Kjo përdoret për *inspirime* si stimulim për punë “ krijuese”, për shtimin e aftësisë dhe mundësisë së marrjes me profesione dhe mjeshtrri të caktuara. Flitet se këto droga dehëse, përveç të rinjëve e përdorin edhe shumë individ të cilët merren me shkrime, me hulumtime shkencore, artist dhe këngëtarë të ndryshëm, me qëllim të forcimit dhe të arritjes së rezultateve me të mira në fushën me të cilat merren.²⁴⁹ Nga kjo pije, prodhohen edhe mjete të ashtuquajtura **doping**, për sportistë të njohur, për arritjen e rezultateve kulminative. Mirëpo, në jetën e përditshme, ky stimulim është i përkohshëm, i rrejshëm dhe paraqet njëfarë iluzion, sepse po sa të bjerë efekti i drogës dehëse, individ i pa marrë parasysh me çfarë pune dhe aktiviteti merret, kthehet në një gjendje të dëshpërimit, në një gjendje pasive. E kaplon anemia dhe mungesa për punë dhe jetë.²⁵⁰

Kokaina është në vendin e tretë, me tregun e shitjes me pakicë që mbart rreth 5.7 miliardë euro. Grupet kriminale kolumbiane dhe italiane janë shpërndarësit kryesorë në Evropë. Tregu i drogës është shumë dinamik, duke pasur parasysh se rrugët e përdorura nga grupe të organizuara kriminale përdoren gjithashtu për të kontrabanduar produkte të tjerë si mallrat e akcizës, si trafikantët e drogës nga Ballkani dihet se kontrabandojnë kokainë nga vendet²⁵¹ e Amerikës së Jugut. Ky trend tashmë është identifikuar, por modus operandi është ndryshuar duke përdorur teknologji të përparuar. Veçanërisht interesante është tendenca me "rrjetën e thellë" përmes së cilës mund të porosisni ilaçe të caktuara. Interneti i errët është pjesë e një rrjeti në të gjithë botën që kërkon një program të veçantë për qasje. Pasi të jeni regjistruar, funksionon si internet i zakonshëm.garen, alkoolin ose ndryshe. dhe trafikimi i qenieve njerëzore dhe kontrabanda e

²⁴⁸ Neni 215 i Kodit penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut

²⁴⁹ Vranica, S. “ Narkomania”, Prishtinë, 1998, fq .25

²⁵⁰ Halili, Ragip “Kriminologjia” Prishtinë, 2008, fq. 288

²⁵¹ Raport i përbashkët nga Europol, Agjencia Evropiane e Policisë dhe Qendra Evropiane e Monitorimit të Drogës dhe varësia (EMCDDA).

migrantëve. Sidoqoftë, në këtë hapësirë misterioze, ka site të fshehura që nuk do të shfaqen në rezultatet e kërkimit,²⁵² por mund të arrihen vetëm nëse e dini adresën e saktë.

3.3.1. Dallmi në shqiptimin e dënimeve për veprën penale Prodhim i paautorizuar dhe lëshimi në përdorim i substancave narkotike, psikotropike dhe prekuzorëve 215(KPM) në rastet kur objekt i veprës është heroina

Morfina, është pije narkotike që aplikohet në shëndetësi dhe mjekësi dhe në shumë raste ndodh që të keqpërdoret. Morfina, në gjendje të pastër, duket si një pluhur i bardhë dhe fitohet nga opiumi. Konsumi i tij nxit e shkakton një disponim eufori tet individët të cilët e përdorin.

Përdorimin e morfines mjekët e aplikojnë të pacientë me sëmundje të rënda, që kanë dhimbje të padurueshme fizike. Po ashtu, morfienë e përdorin edhe persona të cilët nuk vuajnë nga sëmundjetë rënda, por e përdorin që për disa çaste dhe kohë të caktuar ti harrojnë brengat dhe të gjenden në një botë “pa probleme”.

Heroina është derivat i morfiumit dhe bën pjesë në drogat helmuese ose toksikomane, ose në toksikomani të rëndë. Është konstatim i përgjithshëm se heroina është pija narkotike më e përhapur në botën bashkëkohore. Ajo është një drogë e fortë përkahe efektet dhe për këtë arsye e ka merrë edhe emrin simbolik **heroina**.²⁵³

Heroina quhet ndryshe maja e drogave. Është drogë e rëndë dhe përfaqëson stadin e fundit të tyre. U prodhua në rrugë eksperimentale nga shkencëtari gjerman Dreser, si derivat i morfines për efekte mjekësore. Kishte një veprim shume të fuqishëm në qetësimin e dhembjeve të sëmundjeve deri atëherë të pakurueshme. Për këtë arsye substanca e re u quajt heroinë, pasi efekshmeria e saj mund të krahasohej me një²⁵⁴ hero. Për shkak të këtyre vetive, shpejt u fut në trafikun ilegal të narkotikëve. Në fillim u prodhua fshehtas në Marsejë të Francës dhe më pas në

²⁵² Raport i përbashkët nga Europol, Agjencia Evropiane e Policisë dhe Qendra Evropiane e Monitorimit të Drogës dhe varësia (EMCDDA).

²⁵³ Halili, Ragip “Kriminologjia” Prishtinë, 2008, fq. 288

²⁵⁴ Elezi, Alketa. “ Droga, një sfidë intelegjence, aspekte penalo-juridike dhe krahasuese të saj”, punim për gradën Doktor Shkence, Universiteti Tiranës, Tiranë, 2012, fq.18

Itali. E lehtë për trafikim, sepse është e reduktuar në peshë dhe ka çmim shumë të lartë. Vendet kryesore prodhuese të heroinës janë trekëndeshi i artë: Tajlandë-Laos-Birmani; Azia e Vogël-Pakistani dhe Afganistani-Irani-Turqia. Kohët e fundit heroina prodhohet dhe në vendet e Amerikës Latine.²⁵⁵

Në librin me titull: "Droga" e Lekë Sokolit, për pijen narkotike heroinën thuhet, "është një drogë e rëndë", ajo në shkallëzimin e drogave përfaqëson stadin fundor. Më saktësisht, heroina përfaqëson fundin e një udhëimi pa kthim. Zakonisht kur merret për të parën herë heroina, shkakton ankth, dridhje, të përziera e të vjella. Suksesi i saj lidhet me faktin se ajo të qetëson, të zhyt në një botë të qetë, të rrit besimin e përdoruesit ndaj vetes, madje krijon një gjendje euforie totale, pra jep humor.

Heroina për nga shija është e hidhur, është pluhur me ngjyrë të bardhë në të zeshkët, e tretshme në ujë dhe në eter. Efektet i ka të ngjajshme me të morfinës, por është 2-3 herë më forte. Përdorimi i saj bëhet me ineksion, duke e shkrirë me pak ujë në lugë dhe para se të futet në shiringë për injektim ngrohet në flakën e një shkrepeje ose qiri. Mundet të përdoret edhe në pije. Zë vendin e dytë në botë,²⁵⁶ për fitimet që sjell në vlerë prej 6.8 miliardë euro në vit.

Heroina është shkaku i vdekjes për shumë përdorues. Opiumi prodhohet kryesisht në Afganistan, dhe rruga e Ballkanit mbetet një korridor kryesor për hyrjen e heroinës në BE, megjithëse rrugët e reja po dalin nga Afrika, Kaukazi Jugor, Siria dhe Iraku.²⁵⁷

3.3.2. Dallimi në shqiptimin e dënimeve për veprën penale Prodhim i paautorizuar dhe lëshimi në përdorim i substancave narkotike, psikotropike dhe prekuzorëve 215(KPM) në rastet kur objekt i veprës është kanabisi

²⁵⁵ Elezi, Alketa. " Droga, një sfidë intelektuale, aspekte penalo-juridike dhe krahasuese të saj", punim për gradën Doktor Shkence, Universiteti Tiranës, Tiranë, 2012, fq.18

²⁵⁶ Raport i përbashkët nga Europol, Agjencia Evropiane e Policisë dhe Qendra Evropiane e Monitorimit të Drogës dhe varësia (EMCDDA).

²⁵⁷ Raport i përbashkët nga Europol, Agjencia Evropiane e Policisë dhe Qendra Evropiane e Monitorimit të Drogës dhe varësia (EMCDDA).

Në fillim po trajtojmë cilësitë e kanabisit, i cili kultivohet ne vendin tonë. **Kanabisi** nxirret prej bimës **caanabis sativa**. Bima është në formën e shkures me lartësi 1,5 - 2 metr²⁵⁸a. Shpesh kanabisi mund të ndeshet në formën e *rezinës*, që përgatitet në trajtën e kallëpeve. Produkti sigurohet prej perpunimit të gjetheve të kanabisit, të cilat më pas presohen ne formë blloqesh. Ngjyra mund të luhatet nga e verdha e hapur, ose gri në kafe, deri në kafe shumë të errët dhe nuancat e të zezës. Kur është e thatë bima është shumë e lehtë dhe e thërmueshme, ndërsa ne formen e vet vajore, tepër e rendë. Perveç formës së *rezinës*, kanabisin mund ta ndeshim edhe në formën *e barit*, që janë gjethet e kanabisit të thara dhe gati per t'u prerë në formën e cigareve. Ngjyra dhe struktura e gjetheve ndryshon në varësi të tipit të bimës dhe të vendit²⁵⁹ ku është kultivuar ajo. Pamja ndryshon aq shumë sa që edhe përdoruesit me mjaft eksperiencë janë gjendur përpara të papriturave, duke blerë barishte, apo bimë të përditshme në vend të kanabisit. Së fundi, mund ta ndeshim në formën e vajit të kanabisit. Ky ekstrat i *rezinës* është forma më e fuqishme dhe më e koncentruar e kanabisit. Ka pamje të errët dhe duket si shurup i trashë.²⁶⁰

Është një drejtim i parëndësishëm i trafikimit të drogës. Nga rastet e kapura nuk mund të flitet për një trafik të rregullt. Maqedonia ndodhet në rrugën e trafikimit të heroinës për në Shqipëri, kështu që drogat e rënda nuk kanë pse të rikthehen përsëri aty. Megjithatë, vërehen raste të trafikimit të drogës së lehtë vendase, **caanabis sativa**. Për këtë shfrytëzohet afërsia kufitare nga kultivuesit shqiptarë. Konstatohet se marihuana e trafikuar nga Shqipëria në Maqedoni eshte destinuar kryesisht per konsumatorët vendas. Kështu, ne prill te vitit 2003, u kapën 4.65 kg marijuane në Qafë Thanë nga policia maqedonase. Marihuana ishte fshehur poshtë kabinës së shoferit me qëse dhe shoferi M.R u arrestua. Rezultoi se droga destinohej për në tregun vendas. Ka patur edhe raste të trafikimit tranzit nga Shqipëria në Greqi, nëpërmjet

²⁵⁸ https://en.wikipedia.org/wiki/Cannabis_sativa

²⁵⁹ Elezi, Alketa. " Droga, një sfidë intelegjence, aspekte penalo-juridike dhe krahasuese të saj", punim për gradën Doktor Shkence, Universiteti Tiranës, Tiranë, 2012, fq.19

²⁶⁰ Elezi, Alketa. " Droga, një sfidë intelegjence, aspekte penalo-juridike dhe krahasuese të saj", punim për gradën Doktor Shkence, Universiteti Tiranës, Tiranë, 2012, fq.19

Maqedonisë²⁶¹. Kështu doganieret maqedonas kapen në kufirin me Greqinë në një automjet me më shumë se 1 tonë marihuanë, që ishte sjellë nga Shqipëria, me destinacion Greqinë.²⁶²

Kanabisi është ilaçi më i përhapur në Evropë, që përbën 38% të shitjeve me pakicë, duke gjeneruar më shumë se 9.3 miliardë euro në vit. Sipas këtij raporti, rreth 22 milion evropianë përdorin kanabis.

3.4.Zbutja e dënimit në raste të caktuara

Rrethanat lehtësuese dhe rënduese mund të kenë ndikim në matjen e dënimit vetëm brenda minimumit dhe maksimumit të dënimit të përcaktuar me ligj për atë veprë penale. Mirëpo, në jetën e përditshme mund të kryhen vepra penale me aso rrethana, të cilat veprën e bëjnë veçanërisht të lehtë. Në raste të tilla, matja e dënimit brenda kufijëve të minimumit dhe maksimumit të posaçëm nuk do të ishte në pajtim me parimin e drejtësisë, nuk do të përgjigjej qëllimit të dënimit – dënimi do të ishte i rreptë. Për këtë arsye, për rastet e këtylla të kodit penal, parasheh rregulla të posaçme për zbutjen e dënimit.²⁶³

Të penduarit autorë të veprimtarisë kriminale të kryera nga organizata kriminale dhe pjestarë të tyre, të cilët vendosin vullnetarisht të bashkëpunojnë me organet e procedimit, të penduarit përfitojnë uljen e dënimit deri dhe përjashtimin nga përgjegjësia penale.

Që i arrestuari ose i dënuari të përfitojë ulje ose përjashtimin nga dënimi duhet që i penduari duhet të jetë person i arrestuar ose dënuar për vepra penale të trafikut të narkotikëve ose të kryera nga organizata kriminale ku ai bën pjesë si dhe ky person duhet të japë ndihmë aktive në luftën për zbulimin e aktivitetit të saj ose në zbulimin e personave të tjerë që kryejnë këto krime dhe

²⁶¹ Elezi, Alketa. “ Droga, një sfidë inteligjence, aspekte penalo-juridike dhe krahasuese të saj”, punim për gradën Doktor Shkence, Universiteti Tiranës, Tiranë, 2012, fq.40

²⁶² Elezi, Alketa. “ Droga, një sfidë inteligjence, aspekte penalo-juridike dhe krahasuese të saj”, punim për gradën Doktor Shkence, Universiteti Tiranës, Tiranë, 2012, fq. 40

²⁶³

kur dëshmia²⁶⁴ e tij është kyçe për ushtrimin e ndjekjes penale. Nëse ai aktivizohet plotësisht dhe jo vetëm me një bashkëpunim të thjeshtë, të cunguar, informativ, si dhe kur kontributi i tij të ndihmojë në shkeputjen e zinxhirit kriminal, të godasë mjetet e veprimitarisë kriminale, duke ndaluar pasojat jo vetëm të krimeve tashmë të kryera, por dhe kryerjen në të ardhmen të krimeve ai mund të²⁶⁵ përfitojë nga masat lehtësuese. Ai duhet të evitohet që veprimtaria kriminale të mos sjelle pasoja të tjera dhe të ndihmojë konkretisht autoritetet hetimore në nxjerrjen e burimeve të vlefshme²⁶⁶ për kryerjen e veprave penale.

Në nenin 40, të Kodit Penal të shtetit tone janë përcaktuar taksativisht kështu:

Gjykata mund tia caktojë kryerësit dënimin nën kufirin e caktuar me ligj ose të aplikojë lloj më të butë të dënimit kur:

- 1) ligji parasheh se kryerësi mund të dënohet më butë dhe
- 2) do të vërtetohet se ekzistojnë rrethana posaçërisht lehtësuese të cilat dëshmojnë se edhe me dënimin e zbutur mund të arrihet qëllimi i ndëshkimit

Ndërsa, në nenin 41, kufijtë e zbutjes së dënimit janë:

(1) Kur ekzistojnë kushtet për zbutjen e dënimit nga neni 40, gjyqi do të zbusë dënimin në këto kufij, nëse:

1. për veprën penale si masë më e vogël e dënimit është caktuar burgimi në kohëzgjatje prej dhjetë apo më shumë vjetësh, dënimi mund të zbutet deri në pesë vjetë burgim²⁶⁷,
2. për veprën penale si masë më e vogël e dënimit është caktuar burgimi në kohëzgjatje prej tetë apo më shumë vjetësh, dënimi mund të zbutet deri në katër vjetë burgim²⁶⁸,
3. për veprën penale si masë më e vogël e dënimit është caktuar burgimi me kohëzgjatje prej pesë vjetësh, dënimi mund të zbutet deri në tre muaj burgim,

²⁶⁴ Saliu, Ismet "E drejta penale për të mitur", Prishtinë 2005, fq.507-508

²⁶⁵ Saliu, Ismet "E drejta penale për të mitur", Prishtinë 2005, fq.507-508

²⁶⁶ Saliu, Ismet "E drejta penale për të mitur", Prishtinë 2005, fq.507-508

²⁶⁷ Neni 41, Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut

²⁶⁸ Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut

4. për vepër penale si masa më e vogël e dënimit është caktuar burgimi me kohëzgjatje prej katër vjetësh, dënimi mund të zbutet deri në dy vjet burgim²⁶⁹.
 5. për veprën penale është caktuar masa më e vogël e dënimit me burgim me kohëzgjatje prej tre vjetësh, dënimi mund të zbutet deri në një vjetë burgim²⁷⁰,
 6. për vepër penale është caktuar masë më e vogël e dënimit me burgim me kohëzgjatje prej një vjet, dënimi mund të zbutet deri në tre muaj burgim²⁷¹,
 7. për vepër penale është caktuar masa më e vogël e burgimit nën një vjet, dënimi do të zbutet deri në 30 ditë burgim²⁷².,
 8. për vepër penale është paraparë burgim deri në tre vjet me shënim të masës më të vogël, në vend të burgimit mund të shënohet dënimi me gjob²⁷³ë, dhe
 9. për veprën penale është paraparë dënim me të holla me shënimin e masës më të vogël, dënimi mund të zbutet deri në minimumin e përgjithshëm ligjor.
- (2) Gjatë vendosjes se në çfarë mase do ta zbusë dënimin sipas dispozitave të paragrafit të 1, gjykata veçmas do të ketë parasysh masën më të vogël dhe më të madhe të dënimit të caktuar për veprën penale .²⁷⁴

3.5.Lirimi nga dënimi në rast të zbulimit të grupit dhe parandalimit të kryerjes së veprës penale

²⁶⁹ Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut

²⁷⁰ Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut

²⁷¹ Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut

²⁷² Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut

²⁷³ Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut

²⁷⁴ Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Një ndër parimet e rëndësishme të së drejtës penale është se kryerësi i veprës penale që është penalisht i përgjegjshëm do të dënohet për veprimin e kryer. Klauzula e këtij parimi është se, edhe pse është kryer vepra penale, gjykata konstaton se kryerësi është i përgjegjshëm por, nuk do ti shqiptojë dënim pasi inteziteti apo shkalla e veprës penale është aq e ulët sa që, shqiptimi i dënimit nuk do ishte i arsyeshëm. Kështu që, gjykata e shpallë kryesin fajtor për veprën penale të kryer, por edhe e liron nga dënimi.

Ligji i ka paraparë taksativisht kur nuk do të ekzekutohet dënim ndaj kryesit të veprës penale, siç janë mbrojtja e nevojshme, nevoja ekstreme, në rastet e heqjes dorë vullnetarisht nga kryerja e veprës penale.

Lirimi nga dënimi është përcaktuar në nenin 42, në parag.1, konstatohet se: gjykata mund të lirojë nga dënimi kryesin e veprës penale vetëm atëherë kur këtë shprehimisht e parashikon ligji. Kur gjykata është e autorizuar ta lirojë nga dënimi kryerësin e veprës penale, mund tja zbusë dënimin pa kufizime të parapara për zbutjen e dënimit ose mund të shqiptojë dënim dytësor – ndalesë për të drejtuar automjetin apo debim i të huajt nga vendi(parag.2)

Shkaku u veçantë i përcaktuar për lirimin nga dënimi, është kur gjykata mund ta lirojë nga dënimi kryerësin e veprës penale e kryer nga pakujdesi kur pasojat e veprës e godasin kryerësin aq rëndë sa që shqiptimi i dënimit me këtë rast nuk do ti përgjigjej²⁷⁵ qëllimit të ndëshkimit.

3.6. Hulumtim Shkencorë Empirik Në Këndvështrimin Hulumtues Të Veprave Penale Në Gjykatën Themelore Të Gostivarit Prodhim i paautorizuar dhe lëshimi në përdorim i substancave narkotike, psikotropike dhe prekuzorëve (215 KPM) në Rajonin E Gostivarit Për Periudhën 2012 - 2017

²⁷⁵ Neni 43, i Kodit Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Në qytetin e Gostivarit, në bazë të dhënave statistikore, në regjistrimin e fundit të popullsisë në vitin 2002, qyteti bashkë me rrethin ka një popullatë prej 35.847. Për sa i përket përkatësisë etnike, në qytetin e Gostivarit numri më i madh i banorëve janë shqiptar, poashtu, ndërsa pjesën tjetër e përbejnë etniteti maqedon, turk, romë, vlleh, sërb, etj.

Standardet jetësore në të gjithë Maqedonin e Veriut si dhe në qytetin tonë, janë të ulta duke marrë për bazë rrogën mesatare, papunësinë e lartë dhe ndikimin e pandemisë së Covid -19. Rritja e numrit të papunësisë si pasojë e virusit Covid-19 ka ndikuar që pjesa e varfër e popullatës e përfshirë nëpër kriza ekonomike, lufta për të mbijetuar, sigurimi i mirëqenies sociale, ka ndikuar që ata të bëhen kriminel, disa të jenë edhe recidivist duke kryer vepra penale të ndryshme si dhe rritjen e numrit të viktimave të dhunës në familje. Poashtu, ka ndikuar edhe prodhimin e paautorizuar dhe përdorimin e substancave të ²⁷⁶ndryshme narkotike.

Në pajtim me Ligjin për qasje të lirë në informacionet e karakterit publik²⁷⁷, nga Prokuroria e Përgjithshme Publike në Gostivar kam siguruar të dhëna për periudhën hulumtuese 2012-2017, të cilave do tu bëjmë analizë pasi do ti paraqesim në tabelën e më poshtme.

	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Kallzime penale	809	1184	1447	1001	965	752
Aktivitet për hedhje poshtë (pa bazë juridike)	268	326	409	342	217	137
Ndërprejre hetimesh	56	50	54	24	14	11
Veprime kompetente	12	18	162	97	141	40
Aktakuza	238	205	179	96	92	42
Propozim akuza	356	298	409	338	191	199

Tabela Nr 5. Të dhëna statistikore, nga Prokuroria e Përgjithshme Publike në Gostivar

Siç mund të shihet nga tabela e më sipërme në Prokurorinë e Gostivarit për të llojet e veprave penale të kryera nga persona të rritur dhe të mitur, shifrat janë të larta.

²⁷⁶ ance.gov.mk/2021/06/08/zaev-dhe-besimi-ekonomia-eshte-e-qendrueshme-dhe-do-te-rritet-me-rebalancin-ne-mbeshtesim-investimet-kapitale-dhe-ne-siguruam-pensione-subvencione-per-fermeret-dhe-mbeshtetje-per-kategorite-e-prek/?lang=sq

²⁷⁷ Gazeta Zyrtare e R.Maqedonisë, "Ligji për qasje të lirë në informacionet e karakterit publik" nr.13/06, 86/08 dhe 6/10.

Në analizën e periudhës hulumtuese, viti që ka pasur më së shumti kallzime penale është 2014, ndërsa viti me më pak kallzime penale është vitit 2017. Aktvendim për hedhje poshtë të kallzimit për shkak të mungesës së bazës juridike, më së shumti ka pasur në vitin 2014, dhe më pak në vitin 2017. Në vitin 2012 janë bërë 56 ndërpreje hetimesh, ndërsa më pak në vitin 2017.

Prokuroria ka ngritur më shumë aktakuza gjatë vitit 2012 (238), ndërsa 42 në vitin 2017.

Ka ngritur 409 propozim akuza në vitin 2014 që është një numër mjaftë i lartë dhe me pak gjatë vitit 2016, që ka ngrit 191 propozim akuza.

Sipas të dhënave në tabel mund të konstatojmë se kriminaliteti gjatë periudhës 5 vjeçare të hulumtimit, nga viti 2012-2017, rritje maja më e lartë e krimit është në vitin 2014, ndërsa ulje apo kryerja e më pak veprave penale është bërë gjatë vitit 2017.

Sipas të dhënave në nivel shtetëror, për punën e prokurorisë publike themelore, në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut ²⁷⁸ nga kallzimet penale për pryerësit e veprave penale, nga numri i përgjithshëm prej 31.486 në vitin 2015, ndaj delikuentëve të mitur janë bërë 1.358 kallzime. Në vitin 2016, nga gjithsej 29.093 kallzime, 1.186 janë për delikuent të mitur. Nga 28.753 kallzime penale të bëra ndaj kryerësve të veprave penale në vitin 2017, për delikuentët e mitur janë bërë 1.074. Në këtë periudh tre vjeçare, kryerës së veprave penale ka pasur më shumë në vitin 2014 dhe kemi më pak në vitin 2017.

Tabela nr. 6 të dhëna në nivel shtetëror,për punën e prokurorisë publike themelore

Kallzime penale ndaj kryersve të v.p.	2015	2016	2017
Delikuent të mitur	1.358	1.186	1.074
gjithsej	31.486	29.093	28.753

Tabela nr. 7 Të dhëna statistikore nga Gjykata themelore në Gostivar, ku kryerës janë delikunet të mitur.

Viti	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Lëndë të filluara	21	26	12	31	24	22

²⁷⁸ Годишен-извештај-за-работата-на-јавните-обвинителства-за-2017-година.pdf

Lëndë të përfunduara	21	23	23	37	19	24
Aktgjykime liruese	2	1	0	2	0	1
Aktgjykime dënuese	19	20	22	34	18	18
Aktgjykime refuzuese	1	2	1	1	1	5

Në vitin 2013, prej 26 lëndëve të filluara, 23 çështje janë zbardhur, prej të cilëve 11 delikuent të mitur janë dënuar me burg dhe 12 janë dënuar me kusht.

Në vitin 2014, delikuentët e mitur janë sanksionuar kështu: 13 të dënuar me burg, 11 të dënuar me kusht, të liruar me kusht 11

Tabela nr. 8 Të dhëna statistikore nga Gjykata themelore në Gostivar, për veprnë penale sipas nenit 215, të Kodit Penal.

Viti	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Dënim me burg	/	12	8	16	9	10
Dënim me kusht	19	6	11	18	7	8
Lirim me kusht	2	1	12	/	/	/
Vërejtje gjyqësore	/	/	/	/	1	/
Dënim me të holla	/	/	/	/	1	/
Ndërprerje procedure	/	/	/	1	/	2
Të liruar nga akuza	1	2	/	1	/	1
Nuk është provuar se është kryerës i v.p.	/	/	13	/	/	3

KAPITULLI IV

4. Anketa për ndikimin e substancave narkotike, psikotropike dhe prekuzorëve në shoqëri

Për qëllimet kësaj teme të magjistraturës, gjithashtu bëra hulumtime empirike përmes pyetësorëve të anketës, ku anketova 100 nxënës nga gjymnazet e qytetit të Gostivarit, të cilët u përkasin të dy gjinive. Për sa i përketet kufirit të moshës, të anketuarit varion nga mosha 14-19 vjeçare(viti i I, II, III dhe IV).


Nëpërmet të anketës do mundohemi të japim një pasqyrë më të qartë se sa kanë informacion fëmijët nëpër institucionet arsimore, për cigaren, alkoolin dhe drogën, fëmijë që kalojnë nga mosha e adoleshencës në moshën e pjekurisë dhe maturisë. Periudh jetësore mjaftë delikate sepse në të krijohen dhe fitohen veset dhe virtyte pozitive dhe negative.

Në këtë pjesë të temës jepen edhe rezultatet nga qytetarët e anketuar.

Në anketë u parashtuan këto pyetje:

1. Në shoqërin tuaj a flitet për cigaren, alkoolin dhe drogën?

- Në të shumtën e rasteve për cigaren- 23 të anketuar
- Në të shumtën e rasteve për alkoolin- 9 të anketuar
- Në të shumtën e rasteve për drogën- 6 të anketuar
- Për asnjërën- 2 të anketuar
- Për të gjitha- 60 të anketuar



Nga rezultatet e arritura mund të arrijmë në përfundim se numri më i madh i të anketuarve janë përgjigjur se bisedohet për të gjitha dhe një numër shumë i vogël, 2 të anketuar janë përgjigjur se nuk diskutojnë për cigaren, alkoolin apo drogën.

2. Prindërit dhe profesorët, a ju këshillojnë për efektet negative të drogës, alkoolit dhe të cigares?


- Po
- Jo

100 të anketuarit janë përgjigjur se prindërit dhe profesorët i këshillojnë për efektet negative që mund të kenë nga duhani, alkooli dhe droga.

3. Në familjen tuaj a ka konsumues të cigares, alkoolit apo drogës?

- Prindërit, vllai/zërit, motra/at cigaren-40
- Prindërit, vllai/zërit, motra/at- cigaren dhe alkoolin-10
- Prindërit, vllai/zërit, motra/at-cigaren,alkoolin dhe drogën-5
- Prindërit, vllai/zërit, motra/at, nuk konsumojnë, 37


- Prindërit, vllai/zërit, motra/at, nuk konsumojnë, por unë po-8



Nga analiza e përgjigjeve mund të vijmë në përfundim se, konsumues së cigares janë më shumë përgjigjet do me thënë 40 % të të anketuarëve kanë dhënë përgjigje pozitive, ndërsa fakti më shqetësues është se prindërit, vëllezërit dhe motrat nuk konsumojnë por, këta adoleshentë janë konsumues 8 % .

4. A jeni konsumues të cigares, drogës apo alkoolit?

- Shkurt kohë që kam filluar
- Përdorues me vite
- Nuk konsumoj



5. Nga cila keni krijuar varësi?

- Nga cigarja- 20
- Nga alkooli- 7
- Nga droga- 6
- Nga të gjitha - 3
- Nuk konsumoj- 64

Nga ajo që mund të shihet në grafikun e më sipërme mund të konsiderohet se 64 të anketuarëve kanë deklaruar se nuk konsumator, ndërsa varshmëria më e madhe tek adoleshencia është nga cigarja , 7 të anketuar u përgjigjën se kanë varësi nga akooli, 6 nga droga dhe shifra më e vogël prej 3 % janë të rinjtë që kanë varësi nga²⁷⁹ të gjitha.

Me komnet kanë shkruar: Kanabis ose Marihuan dhe ekstaza.

6. Gjatë përdorimit a ndodhin ndryshime në sjelljen tuaj?

²⁷⁹ Rezultatet e arritura nga Anketa për ndikimin e substancave narkotike, psikotropike dhe prekuzorëve në shoqëri

- Po gjithmonë
- Ndonjëherë
- Jo, nuk kam ndryshime
- Nuk konsumoj

Të anketuarit në pyetjen se a kanë ndryshime në sjelljen e tyre gjatë konsumit, 15 janë përgjigjgur se kanë gjithmonë, 12 janë përgjigjgur se kanë ndonjëherë, dhe që nuk kanë ndryshime janë përgjigjgur 9 persona.

7. Kush ka qenë arsya e fillimit të konsumimit?

- Si ngushllim për problemet
- Nga kureshtja
- Vetëm për të qenë në trend me shoqërin
- Nuk konsumoj



8. A keni bërë përpjekje të ndërrisni konsumimin?

- Disa here
- Asnjëherë

- Nuk konsumoj

Në pyetjen se a janë përpjekur konsumuesit e cigars, alkoolit apo drogës që të ndërpresin konsumin, disa here janë përgjigjur 26 të anketuar, ndërsa 10 të anketuar që janë konsumues nuk kanë tentuar asnjëherë. Përgjigja se nuk konsumoj vazhdon të ngelet e njëjtë 64 të anketuar.

9. A përpiqeni të shmangni shoqërinë dhe vendet që konsumohet droga?

- Po- 65
- Jo- 20
- Përpiqem por është e pamundur- 15

Për sa i përket shoqërisë dhe ambienteve ku konsumohet droga, pjesa më e madhe e të anketuarve pohojnë, ndërsa 15 janë përgjigjur që përpiqen por është e pamundur dhe 20 të tjerë janë përgjigjur se jo.

Po ashtu, kanë lënë koment : nuk largohemi nga shokët tanë që janë konsumues, ne i këshillojmë që mos konsumojnë sepse dëmtojnë shëndetin e vet, e mërzhisin familjen dhe dëmtojnë ekonomin. Kështu kemi ndikuar që një shok i yni është larguar nga droga.

10. Cila metodë do ishte më e mirë për ta luftuar këtë dukuri devijante në shoqëri?

- Këshillim më shumë nga prindërit- 10
- Trajtim i temave të tilla në shkolla- 7
- Trajtim i temave të tilla në media -5
- Shoqatat dhe mediat tu japin hapësirë të flasin ata që janë rehabilituar nga alkooli dhe droga-4
- Apeli i prindërve që u kanë vdek femijët nga droga nëpërmjet mediave dhe rrjeteve sociale- 4
- Te gjitha format e lartpërmenduar- 70

Në pyetjen e fundit të anketës, se cila metodë do të ishte e duhura për të luftuar këtë dukuri devijante në shoqërin tonë, në opsionet e ofruara për tu përgjigjur, pjesa më e madhe e gjymnazistëve , 70 % prej tyre e kanë rrethuar se të gjitha opsionet e ofruara bashkarisht do të japin rezultate më të mira, për të ndaluar konsumin e drogës në rrugë ilegale. Pra, do të ndikonte në vëditësimin e brezave të²⁸⁰ ri.

Nga anketa e realizuar me gjymnazistët e qytetit të Gostivarit, për ndikimin e substancave narkotike, psikotropike dhe prekuzorëve në shoqëri, rezultoi që të anketuarit kanë pasur kontakt me substance narkotike, gjegjësisht përdorimi më i madh është i lëndës narkotike Kanabis.

PËRFUNDIMI

Pijet narkotike dhe drogat dehëse, për shkak të cilësive të veta kimike dhe fizike, ndikojnë në shkatërimin e shëndetit psikik dhe fizik të përdoruesit. Te disa persona, mund ta shkatërron sistemin nervor, çrregullim të qendrave vitale dhe organeve kryesore të njeriut, si dobësimi i zemrës, sëmundjet e veshkëve, shkatërimi i mëllçisë, etj. Prandaj, konsumuesit kronik të drogave dehëse, ngelin invalidë të përhershëm ose vdesin me mundime të mëdha.

Përdoruesit e drogave dehëse, në familje dhe në shoqëri e humbin autoritetin. Familjet e konsumuesve shkapërderdhen, dezorganizohen, kanë trauma të mëdha, braktisje, shkurozime e kështu me radhë.

Përdoruesit e substancave narkotike, psikotrope dhe prekuzorëve merren edhe me prodhim të paautorizuar, shitblerjen, shpërndarjen e tyre, si dhe nxitjen e të rinjëve dhe të miturve për konsumin e drogave dehëse. Po ashtu, këta individ jepen edhe pas veprave të tjera penale siç

²⁸⁰ Rezultatet e arritura nga Anketa për ndikimin e substancave narkotike, psikotropike dhe prekuzorëve në shoqëri

janë: trafikimi me armë, prostitucioni, thyerjes së dyqaneve e tjera, me qëllim të vetëm që të sigurojnë paratë për blerjen e drogave dehëse.

Prodhuesit e kundërligjshëm apo të paautprizuar të substancave narkotike, psikotrope dhe prekuzorëve, dënohen me kodin penal të shtetit tonë, dënime që fillojnë nga një vjet deri në dhjetë vjet.

Shkenctari i njohur Levin, flet për drogat dehëse “*euforika*”, të cilat kanë efekte të qetësimit dhe shkaktojnë kënaqësi të shpirtit dhe trupit, droga e tillë sipas tij janë opiumi dhe alkooloidët e tij, kokaini, etj. *Hipnotika* të cilat kanë efekte të atilla që individët i vejnë në gjumë, siç janë barbituratet e ndryshme. *Inebriantia* të cilat kanë efekte të depresionit, të tilla janë kloroformi, eteri, etj. *Fantastika* të cilat sipas tij shkaktojnë halucinacione dhe iluzione te personat që i përdorin drogat e tilla. Si droga të tilla janë: meskalini, LSD, Hashashi, mrihuana, etj. Grupin e fundit sipas tij e përbëjnë të ashtuquajturata *ekstancija* të cilat nxisin dhe dhe stimulojnë personat e caktuar në aktivitete të ndryshme, siç janë: kofeina, amfitamina, fenotrazina, netoamfimina, etj.²⁸¹

Ligjvënësi i në Kodin Penal të Maqedonisë së Veriut, për dënimin me burgim, ka përcaktuar minimumin dhe maksimumin ligjor të dënimit me burgim, duke u afruar kështu orientimit humanitar të heqjes afatgjatë nga liria si dhe dënimin e shkurtë që është e papërshtatshme për risocializimin dhe riedukimin e kryerësit të veprës penale²⁸². Po ashtu, ligjvënësi ka paraparë se në vend të dënimit me burg të përjetshëm, ndaj kryerësit të veprës penale mund të shqiptohet dënimi me 15 vjet ose 20 vjet burg. Mirë po, nëse personit të cilit i është shqiptuar dënimi me burg të përjetshëm, gjatë qëndrimit në entet edukuese korektuese, është sjellur mirë, mund të ndodh që me amnisti ose faljes, ose mund të zëvendësohet dënimi i tillë, me dënim tjetër, por mundësia që i dënuari me burgim të përjetshëm të lirohet me kusht por para se ti vuaj më së paku 15 vjet burg²⁸³.

Shteti duhet ta luftojë krimialitetin e prodhimit në mënyrë ilegale të drogave të ndryshme, pra mbjelles, trafikimit, shpërndarjes, ndërmjetësimit për shitje e kështu me radhë, të substancave narkotike dhe prekuzorëve . Përderisa kryerësit e krimit prodhojnë dhe e lëshojnë në qarkullim

²⁸¹ Halili, Ragip “Kriminologjia” Prishtinë, 2008, fq. 287

²⁸² Kodi penali I Republikës së Maqedonisë së Veriut

²⁸³ Kodi penali I Republikës së Maqedonisë së Veriut

dihet se do ketë kërkesa, prandaj, detyra kryesore e shtetit dhe institucioneve dhe organeve zbatuese është që të minimizojnë kërkesat e përdoruesve dhe në anën tjetër ti dënojnë kriminelët.

Pasi mosha që është më e rrizikuar për tju futur rrugës për konsumin të drogave dehëse, janë adoleshentët, duhet që nëpërmjet programeve të edukimit, tu shpjegohen pasojat që vijnë nga përdorimi i drogës.

BIBLIOGRAFIA

1. Dragan, Krstic. “Psiholoshki rechnik, Savremena administracija”, Beograd, 1991
2. Elezi, Ismet; E drejta penale – pjesa e posaçme; Tiran , 1995
3. Elezi, Alketa. “ Droga, një sfidë intelegjence, aspekte penalo-juridike dhe krahasuese të saj”, punim për gradën Doktor Shkence, Universiteti Tiranës, Tiranë, 2012,
4. Zana, Fatmir. “ Sociologjia e së drejtës”, Tiranë, 2009,
5. Glick, Leonard; Kriminologji; Boston – London –Toronto –Sydney –Sigapore, 1995
6. Gruda Zejnalla, Mbrotja Ndërkombëtare e të drejtave të Njeriut ,Botimi I katërt Shkup 2007
7. Halili, Ragip “Kriminologjia” Prishtinë, 2008
8. Halili Ragip. “Penologjia shkenca mbiekzekutimin e sanksioneve penale”, Prishtinë, 2005,
9. Hysi, Vasilika. “Kriminologjia”, Tiranë, 2005
10. H. Bano “Ekzekutimi i Vendimeve Penale me Burgim” Tribune Juridike, 2004

11. Herring, Jonathan. “ E drejta penale – Teori, kazuse dhe materiale”, Botimi V/Volimi I, (shqipëroi:Spartak Ngjela, Alkeda Reçi, Edlira Stavre), Tiranë, 2013
12. Sijeriçiq-Çoliq, Hajrija& Haliloviq, Haris. “ E drejta e procedurës penale me vështtrim të posaçëm në procedurën penale të Kosovës” Prishtinë, 2007
13. Instituti i shëndetit Publik, Drogat dhe pasojate e përdorimit të saj te të rinjtë,2011, brochure_droga. Pdf
14. J.Siegel , Larry; Criminology – Third Edition, Neë York, 1989
15. Kambovski ,Vllado. “ E drejta penale – pjesa e përgjithshme “,(përkthim) Përkthyen Ismail Zejneli, AfrimOsmani ; Shkup , 2010
16. Kambovski ,Vllado;Kaznopravo – poseben del; Skopje, 1997
17. K,Luli. “Mbrojtja e Dëshmitarëve dhe e Bashkëpunëtorit të Drejtësisë”,Tribunë Juridike,viti 2005, nr.55
18. Latifi, Vesel.”Kriminalistika” Prishtinë, 2009
19. Muçi, Shefqet.” E drejta penale pjesa e përgjithshme”, Tiranë, 2007,
20. Nushi, S. “Mbrojtja me Avokat e Personit gjatë Kohës së Shoqërimit, Ndalimit ose Arrestimit në Flagrancë”, Tribunë Juridike, 2004, nr. 46, fq.51.
21. Osmani, Afrim. “Kodi penal i Republikës së Maqedonisë”, Teksti integral, i përpunuar në gjuhën shqipe me udhëzime dhe sqarime, treguesi alfabetik, Furkan ISM, Shkup, 2010
22. Osmani Afrim, ”Komentari i ligjit për ekzekutimin e sanksioneve”,Shkup,2013,
23. Proevski, Vanço :KrivichnoPravo, opsht del”Shkup, 1986.
24. Petroviq, Borisllav. “ E drejta penale”,Sarajevë/Prishtinë, 2006
25. Проєвски, Јован., Кривичен Законик“, објаснувања, коментари, судска практика, Агенција Академик-Скопје, Скопје, 1998,
26. Saliu, Ismet “E drejta penale për të mitur”, Prishtinë 2005
27. Singer, Mlladen ; Kriminologija – drugo izdanje, Zagreb, 1996
28. Ukaj Bajram. "Dënimet në të drejtën penale të Shqipërisë”,Prishtinë, 2006
29. Zejneli, Ismail. “E drejta penale – pjesa e posaçme”; Tetovë, 2007

Ligje dhe konventa

30. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë,
31. Ligji penal I Republikës së Maqedonisë,
32. Ligji I procedurës penale I Republikë Maqedonisë.
33. Ligji mbi ekzekutimin e sanksionve penale për të mitur I Republikë se Maqedonisë,
34. Ligji mbi drejtësi për të mitur
35. Ligji për kontrollin e drogave narkotike dhe substancave psikotropike, Gz. Zyrtare e R.M. 103/08;2010;ndryshaur dhe plotësuar në vitin. 2013;2015;2016;2017
36. Gazeta zyrtare e R.Maqedonisë, Ligji për caktimin dhe matjen e lartësisë së dënimit,Shkup, 2014
37. Ligji Nr. 7975 “ Kodi Penal , I Republikës së Shqipërisë “ i datës 26.07.1995./ ,azhuruar 2014
38. KODI NR. 06/L-074 PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS / Nr. 2 / 14 JANAR 2019, PRISHTINË
39. Vendime nga gjykata themelore Gostivar
40. Aktet Ndërkombëtare për të drejtat e Njeriut
41. DEKLARAT PER TË DREJTAT E NJERIUT E TË QYTETARIT 26 VIII 1789
42. DEKLARAT AMERIKANE PËR TË DREJTAT E DETYRAT E NJERIUT 2.05.1948, KAPITULLI I PARË TË DREJTAT
43. KONVENTA AMERIKANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT “ PAKTI I SAN HOZESE 22 NËNTOR 1969 E DREJTA NË PRONË NENI 21.
44. Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore
45. KONFERENCA NDËRKOMBËTARE PËR NARKOTIKË, GJENEV 1997
RREGULLAT MINIMALE TË KOMBËVE TË BASHKUAR NË LIDHJE ME
DHENIEN E DREJTËSISË PËR TË MITUR, 1985
46. Raport i përbashkët nga Europol, Agjencia Evropiane e Policisë dhe Qendra Evropiane e Monitorimit të Drogës dhe varësia (EMCDDA).

Burimesekondare:

47. Hulumtimedheintervista

48. Publikime shkencore

Shfrytëzimi I internetit:

49. www.stat.gov.mk

50. www.google.com

51. www.library.seeu.edu.mk

52. www.ombudsman.mk

53. <http://ëëë.mtsp.gov.mk/>

54. <https://ëëë.ëikipedia.org/>

55. <http://sos.mk/preventivna-programa.nsp><http://ëëë.zpd.org.mk/>

56. <https://juristat.files.wordpress.com/2012/02/e-drejta-penale.pdf>

57. <https://shtetiweb.org/2014/11/19/teorite-sociologjike-mbi-pushtetin-politik/>